



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria –Vlada–Government*

**PROGRAMI I KOSOVËS PËR REFORMA EKONOMIKE (PRE) 2018 – 2020**  
**PRIORITETET E REFORMAVE STRUKTURE**

**Dhjetor 2017**

## Përmbajtja


<b>4. PRIORITETET E REFORMAVE STRUKTURE PËR PERIUDHËN 2018-2020 .....</b>	<b>3</b>
<b>4.1. IDENTIFIKIMI I PENGESAVE KRYESORE NË KONKURRUESHMËRI DHE RRITJE GJITHËPËRFSHIRËSE .....</b>	<b>3</b>
<b>4.2. PËRMBLEDHJE E PRIORITETEVE TË REFORMËS.....</b>	<b>5</b>
<b>4.3. ANALIZA SIPAS FUSHËS DHE PRIORITETET E REFORMAVE STRUKTURE.....</b>	<b>8</b>
<b>4.3.1. MENAXHIMI I FINANCAVE PUBLIKE.....</b>	<b>8</b>
<b>4.3.1. REFORMAT NË TREGUN E ENERGJISË DHE TRANSPORTIT.....</b>	<b>10</b>
<b>4.3.3. ZHVILLIMET SEKTORIALE (BUJQËSIA, INDUSTRIA DHE SHËRBIMET) .....</b>	<b>16</b>
<b>4.3.4. MJEDISI BIZNESOR DHE ULJA E EKONOMISË JO-FORMALE .....</b>	<b>27</b>
<b>4.3.5. HULUMTIMI DHE ZHVILLIMI, INOVACIONI (RDI) DHE EKONOMIA DIGJITALE.....</b>	<b>37</b>
<b>4.3.6. REFORMAT LIDHUR ME TREGTINË.....</b>	<b>43</b>
<b>4.3.7. ARSIMI DHE SHKATHTËSITË.....</b>	<b>49</b>
<b>4.3.8 PUNËSIMI DHE TREGU I PUNËS.....</b>	<b>56</b>
<b>4.3.9. PËRFSHIRJA SOCIALE, ULJA E VARFËRISË DHE MUNDËSITË E MUNDËSITË E BARABARTA.....</b>	<b>61</b>

## 4. PRIORITETET E REFORMAVE STRUKTURE PËR PERIUDHËN 2018-2020

### 4.1. IDENTIFIKIMI I PENGESAVE KRYESORE NË KONKURRUESHMËRI DHE RITJE GJITHËPËRFSHIRËSE

Kjo pjesë raporton mbi zhvillimet në lidhje me pengesat e identifikuara të rritjes që nga PRE i fundit. Në këtë pjesë është dhënë përditësimi i analizës me të dhëna dhe studime të reja, duke përfshirë një Analizë të re të Pengesave të publikuara në 2017.<sup>1</sup> Krahasuar me PRE të fundit, qasja në financa nuk konsiderohet më një pengesë detyruese dhe mjedisi rregullator është përmirësuar. Kjo do të thotë se pengesat e tjera tani janë bërë relativisht më të rëndësishme për t'u adresuar.

Figura XX: Pengesat ndaj rritjes në Kosovë \*



\* **Pengesat me ngjyrë të zezë** konsiderohen të jenë të **detyrueshme**, ndërsa të tjerat janë të rëndësishme dhe mund të bëhen të detyrueshme në të ardhmen. **Pengesat në kllapa** konsiderohen të dobëta.

**Qasja në financa nuk është më një pengesë e detyrueshme.** Që nga viti 2014 kur u është bërë edhe analiza e parë e pengesave për PRE, normat nominale të interesit për kreditë tregtare kanë rënë nga rreth 10% në 6% në shtator 2017 dhe rritja vjetore e kredive për korporatat jo-financiare shkoi nga 3% në 9.3% në të njëjtën periudhë. Përqendrimi i sektorit bankar, i matur nga pjesa e asetëve të 3 bankave më të mëdha, ka rënë nga 67% sa ishte më 2014 në 61.4% në tetor të vitit 2017. Këto zhvillime të favorshme, të mbështetura nga Fondi i Kosovës për Garantimin e Kredive, tani plotësisht funksional, na lejojnë që të konkludojmë se qasja në financa nuk është më një pengesë e detyrueshme.

**Mjedisi i të bërit biznes është përmirësuar fuqishëm, por sfidat mbeten.** Raporti i Bankës Botërore i të bërit biznes për vitin 2017 e vlerësoi Kosovën si një nga 10 ekonomitë me përmirësim më të dukshëm në mbarë botën. Që nga viti 2014, renditja e përgjithshme e Kosovës është përmirësuar nga pozita e 86 në atë 40. Progresi më i madh është arritur në fushat e nisjes së një biznesi, marrjes së kredive dhe tregtimit përtej kufijve. Përmirësime të rëndësishme janë

<sup>1</sup> Analiza e Pengesave të Kosovës, Zyra e MCC për Kosovë (në Zyrën e Kryeministrit), 2017.

arritur në zbatimin e kontratave dhe zgjidhjen e paaftësisë paguese (josolvencës), por ende ekziston një hendek i madh në krahasim me vendet që kanë performancën më të mirë. Progres i vogël është shënuar sa i përket lejeve të ndërtimit, regjistrimit të pronës, furnizimit me energji elektrike, pagimit të taksave dhe mbrojtjes së investitorëve.

***Ekonomia joformale vlerësohet të jetë zvogëluar, por ende mbetet një pengesë e madhe dhe e rëndësishme.*** Një studim i kohëve të fundit vlerësoi se madhësia e ekonomisë joformale (e hirtë dhe e zezë) në vitin 2015 ishte në 32% të BPV-së, e cila është dukshëm më e ulët se 43% e BPV-së e vlerësuar për vitin 2013 në një metodologji të krahasueshme.<sup>2</sup> Vlera e taksave të pambledhura vlerësohet në 107 milionë euro ose 1.8% të BPV-së. Sektorët më të prekur nga informaliteti ishin ndërtimi, tregtia, pasuria e patundshme, shërbimet profesionale dhe akomodimi, dhe bujqësia.

***Zbatimi i dobët i kontratave dhe sundimi i ligjit mbeten një pengesë e detyrueshme.*** Numri i lëndëve të pazgjidhura në të gjitha gjykatat u zvogëlua për 9,4% gjatë vitit 2016, por me devijime të mëdha sipas llojeve të lëndëve dhe gjykatave individuale. Për mosmarrëveshjet ekonomike në gjykatat themelore, numri i lëndëve të pazgjidhura u zvogëlua nga 1159 në fund të vitit 2015 në 1143 në fund të tremujorit të tretë të vitit 2017 (-1.4%). Kohëzgjatja mesatare e procedurës për kontestet ekonomike u reduktua nga 1188 në 658 ditë në të njëjtën periudhë. Përmirësime marginale janë shënuar edhe nga treguesit ndërkombëtarë; për shembull, në Treguesit e Bankës Botërore për Qeverisjen, të cilat normalizohen në rangun prej -2,5 në +2,5, rezultatet e Kosovës për sundimin e ligjit dhe kontrollin e korrupsionit janë përmirësuar nga -0,5 në -0,4. Ngjashëm, treguesi i perceptimit të korrupsionit të Transparency International është përmirësuar nga 33 në 36 pikë. Përkundër këtyre përmirësimeve inkrementale dhe indikacioneve që perceptimet negative mund të jenë të ekzagjeruara (shih Analizën e Pengesave të MCC), zbatimi i dobët i kontratave dhe sundimi i ligjit në përgjithësi mbeten një pengesë e detyrueshme.

***Në infrastrukturë, furnizimi i pamjaftueshëm dhe i paqëndrueshëm i energjisë elektrike është ende një pengesë e detyrueshme.*** Linja e re e transmissioinit të energjisë me Shqipërinë, e ndërtuar në vitin 2016, ka përmirësuar sigurinë e furnizimit dhe ka lidhur vendin me tregjet rajonale të energjisë elektrike, por do të hyjë në fuqi vetëm pasi Kosova të jetë pranuar në Rrjetin Evropian të Operatorëve të Sistemit të Transmissioinit. Prandaj treguesit e qëndrueshmërisë së furnizimit me energji nuk tregojnë ende për përmirësim.<sup>3</sup> Në sondazhin e fundit të Odës Ekonomike të Kosovës<sup>4</sup>, pothuajse 90% e kompanive theksuan se përmirësimet në rrjetin e KEDS nuk kanë ndihmuar konkurrueshmërinë e tyre dhe dy të tretat e tyre nënvizuan se kostoja e energjisë elektrike dhe sistemi tarifor si një problem madhor për biznesin e tyre.

Investimet ***në rrjetin rrugor dhe hekurudhor***, të rëndësishme për lehtësimin e qarkullimit tregtar dhe mobilitetit të punës, vazhduan edhe gjatë vitit 2017. Krahasuar me furnizimin me energji elektrike, lidhjet e pazhvilluara të transportit konsiderohen si një pengesë më pak e detyrueshme.

***Shërbimet mjedisore janë konsideruar si një pengesë në shfaqje e sipër.*** Analiza e Pengesave të MCC propozoi që të përfshihen edhe “shërbimet mjedisore” në mesin e pengesave të

<sup>2</sup> Anketa mbi Shtrirjen dhe Parandalimin e Ekonomisë Ilegale dhe Pastrimit të Parave në Kosovë, raport i projektit të financuar nga BE-ja ‘Forcimi i kapacitetit të Kosovës për të luftuar pastrimin e parave dhe korrupsionin’, 2014.

<sup>3</sup> Sipas Raportit të të Bërit Biznes për 2018, indeksi i kohëzgjatjes mesatare të ndërprerjeve të sistemit (SAIDI) është 62.1 dhe indeksi i frekuencës mesatare të ndërprerjes së sistemit (SAIFI) është 34.7, i cili është i ngjashëm me vlerat në raportin e vitit 2016

<sup>4</sup> Sektori i Energjisë në Kosovë – "Barrierat në Miliona Euro – Energjia Elektrike", Oda Ekonomike e Kosovës, 2017.

detyrueshme. Kosova përballet me nivele të larta të ndotjes së mjedisit nga një sërë burimesh, duke përfshirë prodhimin e energjisë elektrike, minierat dhe industrinë, automjetet që përdorin gazin me plumb dhe nga largimi i paligjshëm ose i parregulluar i mbeturinave të ngurta. Të gjithë lumenjtë në Kosovë janë klasifikuar si tepër të ndotur dhe ka shumë pak impiante komunale për trajtimin e ujërave të ndotura.

Sipas studimit, disa firma raportojnë se ato vetë bëjnë trajtimin e ujërave të zeza (ndotura), por ndotja e mjedisit nuk duket të prekë fermerët dhe firmat nuk u ankuan për çështjet shëndetësore që të kenë penguar njerëzit në punë. Çështjet mjedisore sigurisht ndikojnë në shëndetin dhe cilësinë e jetës së njerëzve, ndërkohë që ndikimi i tyre negativ në konkurrueshmëri mund të bëhet më i theksuar në të ardhmen.

**Hendeku i shkathtësive ndërmjet arsimit / trajnimit dhe nevojave të tregut të punës mbetet një pengesë e detyrueshme për rritjen dhe punësimin.** Një sondazh i kryer në fund të vitit 2015 konfirmoi gjetjet e mëparshme të Raportit BEEPS të vitit 2013.<sup>5</sup> Faktorët që ndërlidhen me punën, duke përfshirë arsimin profesional dhe teknik dhe arsimin e përgjithshëm të punëtorëve, janë raportuar të jenë një pengesë e madhe ose e rëndë nga 27% e firmave. Firmat që u ballafaquan me probleme gjatë punësimit të punëtorëve të rinj përmendën mungesën e përvojës së punës dhe mungesën e shkathtësive adekuate si faktorë më të rëndësishëm. Analiza e Pengesave e MCC vlerësoi shkallët e kthimit në arsim në Kosovë dhe arriti në përfundimin se ato janë në përputhje me hipotezën se **cilësia e ulët e arsimit** është një pengesë e detyrueshme e rritjes, gjë që u konfirmua edhe nga rezultatet e studimit PISA 2015. Kjo tregon që problemi i hendekut të shkathtësive është i lidhur me nivelet e pjesëmarrjes në arsim, me kompetencat dhe shkathtësitë specifike siç janë gjuhët e huaja, aftësitë kompjuterike ose të ashtuquajturat shkathtësi të buta dhe me cilësinë e përgjithshme të arsimit.

Ekzistojnë edhe **pengesa të tjera të rëndësishme për punësimin**. Struktura e tanishme ekonomike, kryesisht e bazuar në produkte dhe shërbime jo të sofistikuar dhe më të ulëta të vlerës së shtuar, nuk është në gjendje të krijojë një numër të mjaftueshëm të vendeve të punës me shkathtësi të larta. Përdorimi mbizotërues i kanaleve joformale nga ana e firmave në rastin kur kërkojnë punëtorë zvogëlon hapësirën për vendosjen (shpalljen) e vendeve të punës nga shërbimet e punësimit. Remitencat rrisin nivelin e pagës rezervë dhe informaliteti i përhapur zvogëlon numrin e vendeve formale të punës. Mungesa e institucioneve për kujdesin e fëmijëve dhe kujdesi institucional për të moshuarit, të kombinuara me mungesën e aranzhimeve fleksibile të punës, dekurajojnë pjesëmarrjen e femrave në fuqinë punëtore.

## 4.2. PËRMBLEDHJE E PRIORITETEVE TË REFORMËS

### I. Menaxhimi i Financave Publike

**Masa #1: Përmirësimi i prokurimit publik nëpërmjet aplikimit të prokurimit elektronik –** Adreson zhvillimin dhe promovimin e përdorimit të gjerë të prokurimit publik elektronik, nga autoritetet qendrore dhe lokale përmes një sistemi adekuat të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit me qëllim të rritjes së efikasitetit dhe transparencës.

### II. Reforma e tregut të energjisë dhe transportit

**Masa #2: Ulja e konsumit të energjisë nëpërmjet masave të efikasitetit të energjisë –** kjo masë synon të kontribuoj në arritjen e caktimit të kursimit të energjisë për 9% deri më 2018,

<sup>5</sup> Raportuar nga A. Cojocar: Diagnostikimi i vendeve të punës në Kosovë, Seritë e BB për Vendet e Punës botimi 5, 2017.

nëpërmjet zbatimit të masave të EE dhe burimeve të ripërtërishme të energjisë në ndërtesa publike të nivelit qendror dhe lokal.

**Masa #3: Zhvillimi i mëtejshëm i kapaciteteve prodhuese të energjisë** - objektivë kryesorë e masës është adresimi i sigurisë së energjisë përmes zhvillimit të kapaciteteve të reja gjeneruese, rehabilitimit të TC Kosova B dhe investimeve në BRE.

### III. Zhvillimet sektoriale – bujqësia, industria dhe shërbimet

**Masa #4: Investimet në infrastrukturën bujqësore dhe për agro-përpunim** - adreson sfidat lidhur me infrastrukturën bujqësore, diversifikimin e produkteve, mbulueshmërinë e sistemit të ujitjes, me fokus në përkrahjen e projekteve investuese në sektorët prioritarë.

**Masa #5: Zgjerimi i fermave përmes konsolidimit dhe rregullimit të tokave bujqësore** - përmes zbatimit të rregullimit të tokës bujqësore dhe projekteve të konsolidimit vullnetar synohet të arrihet rritja e madhësisë mesatare të fermave, lehtësimin e qasjes në ngastra kadastrale, dhe shfrytëzimin me racional të tokës bujqësore në përgjithësi.

**Masa #6: Zhvillimi i konkureshmerisë së sektorit privat përmes zhvillimit industrial për NVM-të** - kjo masë synon përmirësimin e konkureshmerisë së NVM-ve duke vendosur një theks të veçantë tek mekanizma që: përmirësojnë bashkëpunimin mes NVM-ve, e rrisin rrjetëzimin me kompani të tjera rajonale dhe të BE-se, përmirësojnë dialogun mes sektorit publik dhe privat, identifikohen potenciale për përmirësim të zinxhirit të vlerës.

**Masa #7: Zhvillimi i produkteve turistike në rajonet turistike të Kosovës** - synon rritjen e ofertës turistike nëpërmjet identifikimit të produkteve turistike, nxitjes për zhvillimin e produkteve me qëllim të futjes në treg, bashkëpunimit mes aktoreve relevant, përdorimit të standardeve turistike dhe përmirësim të infrastrukturës ligjore sipas praktikave evropiane.

### IV. Mjedisi i të bërit biznes dhe ulja e ekonomisë jo-formale

**Masa #8: Zhvillimi i politikave bazuar në të dhëna** - Qëllimi i masës është thjeshtëzimi i legjislacionit dhe sistemit rregullativ, duke përfshirë edhe vendosjen e qasjes për uljen e ngarkesave administrative për bizneset.

**Masa #9: Sigurimi i të drejtave pronësore duke adresuar informalitetin në sektorin e pronës së paluajtshme** - objektivë kryesorë është fuqizimi i sistemit të të drejtave pronësore për pronat e paluajtshme, në mënyrë që qytetarëve t'u sigurohet qasja në procese administrative efikase dhe financiarisht të përballueshme lidhur me themelimin dhe transferimin e titullarëve të pronës.

**Masa #10: Rritja e efikasitetit në gjyqësor në zgjidhjen e rasteve** - kjo masë synon përmirësimin e efikasitetit të gjyqësorit në trajtimin e kontesteve ekonomike duke reduktuar rastet e grumbulluara dhe duke përmirësuar sistemin e menaxhimit të rasteve.

**Masa #11: Reforma e përgjithshme e inspektimeve** – kjo masë synon reformimin e përgjithshëm të sistemit të inspektimeve me qëllim të përmirësimit të efikasitetit dhe koordinimit të sistemit të inspektimeve shtetërore.

### V. Inovacioni, zhvillimi dhe hulumtimet dhe ekonomi digjitale

**Masa #12: Përmirësimi i mjedisit për inovacion** - synon krijimin e kornizës së politikave dhe bazës ligjore, ngritjen e kapaciteteve të brendshme për kërkimet shkencore dhe inovacion, rritjen e nivelit të bashkëpunimit të komunitetit akademik dhe atij industrial, si dhe pjesëmarrjes së institucioneve shkencore të vendit në programet dhe projektet evropiane dhe rajonale.

**Masa #13: Shtrirja e infrastrukturës përkatëse të rrjetave dhe shërbimeve të TIK-ut për**

**zhvillim socio-ekonomik** - kjo reformë synon zgjerimin e qasjes dhe përdorimit të TIK-ut përmes shtrirjes së infrastrukturës brezëgjere në viset e pambuluara, forcimit të kapitalit njerëzor dhe mbështetjes së bizneseve dixhitale, si dhe dixhitalizimit të bizneseve tjera.

## **VI. Reformat lidhur me tregtinë**

**Masa #14: Rritja e efikasitetit për kosto të transaksioneve ndërkombëtare tregtare** – synon të rrisë efektivitetin e kostonë së transaksioneve të tregtisë ndërkombëtare nëpërmjet thjeshtimit dhe standardizimit të të gjitha formaliteteve dhe procedurave në kufi, me synim harmonizimin e praktikave në përputhje me marrëveshjet shumëpalëshe.

**Masa #15: Zhvillimi i mëtutjeshëm i infrastrukturës së cilësisë dhe fuqizimi i rolit të autoriteteve për mbikëqyrjen e tregut me fokus produktet e ndërtimit** – rritjes së sigurisë dhe cilësisë së produkteve të ndërtimit dhe të shërbimeve të ofruara në tregun vendor si dhe integritimit në tregun e BE-së dhe vendeve tjera; eliminimit të barrierave teknike në tregti, mbikëqyrjes efektive të tregut nga autoritetet e mbikëqyrjes së tregut.

## **VII. Arsimi dhe shkathtësitë**

**Masa #16: Harmonizimi i ofertës dhe kërkesës së tregut të punës përmes hartimit të standardeve të profesionit dhe rishikimit të kurrikulave** - Masa synon harmonizimin e programeve të arsimit me kërkesat e tregut të punës nëpërmjet zhvillimit të shkathtësive, standardeve të profesionit, rishikimit të kurrikulave ekzistuese dhe hartimi i kurrikulave të reja, bazuar në fushat prioritare, si dhe trajnimin e mësimdhënësve.

**Masa #17: Reforma në Arsimin Parauniversitar nëpërmjet zhvillimit dhe zbatimit të kurrikulave, ZHPM dhe sigurimi i cilësisë nëpërmjet monitorimit dhe vlerësimit dhe gjithëpërfshirja** - Objektivi kryesor i kësaj mase është zhvillimi dhe zbatimi i Kurrikulës së bazuar në kompetenca, përmirësimi i sistemit për zhvillim profesional të mësimdhënësve dhe vlerësim të performancës së mësimdhënësve, përmes sistemit të licencimit në të gjitha shkollat.

**Masa #18: Ngritja e cilësisë dhe konkurrueshmërisë në Arsimin e Lartë** – objektivi i masës është nxitja e konkurrueshmëria ndërmjet IAL, duke avancuar dhe zhvilluar mekanizmat për sigurimin e cilësisë në arsimin e lartë, rankimin, zhvillimin dhe implementimin e politikave të arsimit të lartë përfshirë financimin e bazuar në cilësi, përmirësimin e informatave në AL, si dhe ndërlidhjen e programeve të studimit të arsimit të lartë me kërkesat e tregut të punës dhe shërbimet për orientim në karrierë .

## **VIII. Tregu i punës dhe punësimi**

**Masa #19: Rritja e qasjes së të rinjve dhe grave në tregun e punës përmes ofrimit të shërbimeve cilësore të punësimit, masave aktive të punësimit dhe ndërmarrësisë** – masa synon përmirësimin e kapaciteteve të shërbimeve publike të punësimit për punëkërkuesit, te papunët dhe punëdhënësit nëpërmjet funksionalizimit të plotë të Agjencisë së Punësimit të Republikës së Kosovës, si dhe ofrimi i shërbimeve cilësore për ndërmjetësim në punësim dhe aftësim profesional si dhe zgjerimin e masave aktive në tregun e punës si: punë publike, subvencionim i pagave, vetëpunësim, promovim i ndërmarrësisë, praktika në punë apo trajnimi në punë. Masa kontribuon në zbatimin e rekomandimit të politikave #6.

## **XI. Përfshirja sociale, ulja e varfërisë dhe mundësitë e barabarta**

**Masa #20: Përmirësimi i shërbimeve sociale dhe shëndetësore** - synon fuqizimin e sistemit të mbrojtjes sociale dhe shërbimeve shëndetësore nëpërmjet përcaktimit të sistemit të qëndrueshëm për financimin e shërbimeve sociale, si dhe krijimin e fondit të sigurimeve shëndetësore.



### 4.3. ANALIZA SIPAS FUSHËS DHE PRIORITETET E REFORMAVE STRUKTURE

#### 4.3.1. MENAXHIMI I FINANCAVE PUBLIKE

##### a. Analiza e pengesave kryesore

**Gjendja aktuale:** Sistemi i menaxhimit të Financave Publike vazhdon të përmirësohet gradualisht. Sa i përket legjislacionit, konsiderohet se korniza ligjore për prokurim publike në masë të madhe është e harmonizuar me acquis të BE-së, duke përfshirë dispozita të Direktivës së BE-së lidhur me prokurimin publik.<sup>6</sup> Qëllimet themelore të prokurimit publik janë të përfshira në legjislacion, duke përfshirë transparencën, trajtimin e barabartë, dhe konkurrencë të lirë dhe të papenguar, duke përfshirë edhe hapjen e prokurimit publik për operatorë të jashtëm ekonomik.<sup>7</sup> Gjithashtu, edhe korniza institucionale është e vendosur, me ndarje të qartë të përgjegjësiave edhe pse kapacitetet financiare dhe njerëzore të institucioneve kufizojnë mundësinë e tyre për të ushtruar të gjitha funksionet dhe detyrat.

Pjesëmarrja e prokurimit publik në BPV është 13.48% në vitin 2015 dhe 13.7% në vitin 2016. Bazuar në Raportin e Auditimit (2016), gjatë vitit 2016 janë dhënë 10,015 kontrata me vlerë totale prej afër 425 milion, apo rreth ¼ e Buxhetit. Nga këto kontrata, 84,55% janë dhënë përmes procedurave të hapura, një 7% rritje nga viti 2015. Kontratat me vlera të larta përfshijnë rreth 61% të të gjitha kontratave, numri mesatar i ofertuesve që kanë konkurruar në një tender apo prokurim është në 5.4 në vitin 2015. Kontratat një burimore ose me procedurë të negociuar me publikim paraprak të një njoftimi mund të aplikohen vetëm në rastet e përcaktuara me ligj. Në vitin 2016, kontratat me procedurë të negociuar pa publikim paraprak kanë përfaqësuar 11.76% të vlerës totale të kontratave të dhëna. Ky proporcion ka qenë 16.1% në vitin 2015, dhe 12.8% në vitin 2014. Numri i përgjithshëm i pjesëmarrësve në procedurat konkurruese të prokurimit mbetet mjaft i lartë. Mesatarja e ofertuesve në një tender ka qenë 6.1 në vitin 2014, 5.8 në vitin 2015 dhe 5.4 në vitin 2016.

Reformat në zbatimin e prokurimit elektronik dhe promovimin e prokurimit të centralizuar tashmë kanë filluar, por nevojiten përpjekje të mëtejshme në këto fusha. Aplikimi i sistemit të prokurimit elektronik është një zhvillim pozitiv, megjithatë ky proces është ballafaquar me disa vështirësi, sikurse mungesa e vetëdijes dhe ngritjes së kapaciteteve për institucionet qeveritare dhe operatorëve ekonomik. Gjithashtu, sistemi nuk ka funksionuar pa probleme dhe avari të papritura shpesh kane penguar rrjedhën e procedurave të prokurimit.<sup>8</sup>

Sa i përket kontrollit të brendshëm korniza e përgjithshme është e vendosur dhe me qëllim të adresimit të mangësive është miratuar një Strategji për Kontrollin e Brendshëm të Financave Publike për periudhën 2015-2019. Elementet kryesore për një kornizë solide të kontrollit të brendshëm janë të vendosura, duke përfshirë legjislacionin, udhëzimet, certifikimin dhe sigurimin e cilësisë. Në përgjithësi zbatimi i rregullave dhe procedurave për kontrollin e brendshëm në organizatat buxhetore mbetet prapa zhvillimit të kornizës së përgjithshme. Për më tepër, aspektet thelbësore të kontrollit të brendshëm, sikurse menaxhimi i riskut dhe procedurat për raportimin e parregullsive, nuk janë akoma të vendosura në praktikë.

Në lidhje me kontrollin e jashtëm, ligji për zyrën e auditorit kombëtar rregullon pavarësinë dhe organizimin e ZAK-së, në harmoni me standardet ndërkombëtare. ZAK ka përmbushur plotësisht mandatin e auditimit në vitin 2016, duke kompletuar auditim të rregullaritetit të të

<sup>6</sup> SIGMA - Raporti i monitorimit të parimeve të administratës publike 2017.

<sup>7</sup> OECD SME Policy Index 2016.

<sup>8</sup> Informata të dhëna nga përfaqësuesit e autoriteteve kontraktuese dhe bizneseve për raportimin e Monitorimit të SIGMA për parimet e administratës publike 2017.



gjitha organizatave buxhetore dhe pasqyrat e konsoliduara financiare. Manualët e aplikueshme të auditimit and kontrolli i brendshëm i cilësisë dhe aranzhimet e sigurisë janë pajtueshmëri të gjerë me ISSAI. Megjithatë, nuk është kryer ndonjë kontroll i cilësisë për të vlerësuar efikasitetin e funksionit të kontrollit të jashtëm, edhe pse një vlerësim i lehtë i ZAK është kryer nga Zyra Kombëtare e Auditimit të Suedisë në pjesën e parë të vitit 2017. Parlamenti shfrytëzon raportin vjetor të ZAK-së për mbikëqyrjen e ekzekutivit, megjithatë niveli i zbatimit të rekomandimeve mbetet i ulët.

**Pengesat strukturore:** Duke u bazuar në analizën e mësipërme pengesat kryesore strukturore në lidhje me menaxhimin e financave publike mbasin kryesisht në fushën e prokurimit publik. Këto pengesa kanë të bëjnë me: rritjen e efikasitetit, integritetit, llogaridhënies, kontrollit për zbatimin e politikave dhe legjislacionit në prokurim publik, zhvillimin e kuadrove profesionale në prokurim publik, veçanërisht zbatimin e prokurimit elektronik, rritja e transparencës dhe besimit publik në procedurat e prokurimit publik. Për më tepër, konsiderohet se ka mungesë të kapaciteteve të organeve përgjegjëse të prokurimit publik, që pamundësojnë efikasitetin dhe transparencën. Disa sfida mbasin, duke qenë se procesi i tenderimit nuk kryhet plotësisht në formë elektronike dhe legjislacioni duhet të harmonizohet më tutje me Direktivën e BE-së të vitit 2014 për prokurimin publik. Kapacitetet e organeve përgjegjëse qeveritare për prokurim publik duhet të fuqizohen dhe korrupsioni duhet të adresohet në mënyrë me efektive.

**Ndikimi i pengesave strukturore:** Mungesa e transparencës dhe aplikimit të procedurave të avancuara të prokurimit publik, rrit keqpërdorimet dhe shkakton përjashtim të bizneseve të vogla nga konkurrenca për kontrata publike. Humbjet pasuese në infrastrukturë dhe shërbime, qoftë për nga cilësia apo shtrirja, zakonisht kanë ndikimin më të madh tek pjesa e pa favorizuar e shoqërisë, të cilët në masë të madhe varen nga shërbimet publike. Keqpërdorimet në prokurim publik mund të dobësojnë besimin e publikut në proceset konkurruese, dhe minojnë përfitimet nga konkurrenca e tregut. Gjithashtu, shtrembërimet e procesit të prokurimit publik pengojnë investimet dhe zhvillimin ekonomik të vendit.

## **b. Planet e reformave prioritare**

### **Masa e reformës #1: Përmirësimi i prokurimit publik nëpërmjet aplikimit elektronik të prokurimit**

#### **1. Përshkrimi i masës**

Si vazhdimësi e reformave nga ERP 2016/2017, fokusi kryesor i masës është rritja e efikasitetit dhe transparencës së procedurave të prokurimit publik, për të siguruar përdorim më të mirë të fondeve publike dhe të zvogëlojë shpenzimet procedurale si dhe të inkurajojë operatorët ekonomik të marrin pjesë në procedurat e prokurimit publik. Kjo masë është në përputhje me Strategjinë Kombëtare për Zhvillim (Masa 12. Prokurimi Publik), dhe Strategjinë e Reformës së Menaxhimit të Financave Publike të 2016-2020 (Prioriteti 7. Prokurimi Publik) dhe Strategjinë Kombëtare për Prokurim Publik. Gjatë vitit 2017, krahas formimit dhe zbatimit të detyrueshëm të sistemit të e-prokurimit për të gjitha organizata buxhetore, është hartuar dhe miratuar legjislacioni sekondar për zbatimin e tij, duke përfshirë udhëzues dhe manuale për përdorues të publikuara në faqen zyrtare të KRPP-së dhe platformën e prokurimit elektronik. KRPP ka ngritura kapacitetet e saja të brendshme si dhe ka mbajtur trajnime të vazhdueshme në bashkëpunim me IKAP-in për zyrtarët e prokurimit.

#### **a. Aktivitetet e planifikuara për 2018:**

- 1) Zbatimi i plotë i prokurimit elektronik në të gjitha organizatat buxhetor;

- 2) Ngritja e kapaciteteve të zyrtarëve për prokurim publik dhe operatorëve ekonomik për shfrytëzimin prokurimit elektronik
- 3) Zhvillimi (avancimi) dhe mirëmbajtja e sistemit të prokurimit AX+elektronik

**b. Aktivitetet e planifikuara për 2019:**

- 1) Vazhdimi i zbatimit të detyrueshëm e-prokurimit në të gjitha organizatat buxhetore;
- 2) Mirëmbajtja e sistemit të prokurimit elektronik
- 3) Ofrimi i trajnimeve të vazhdueshme për prokurim publik

**c. Aktivitetet e planifikuara për 2020:**

- 1) Vazhdimi i zbatimit të detyrueshëm të e-prokurimit në të gjitha organizatat buxhetore;
- 2) Mirëmbajtja e sistemit të prokurimit elektronik
- 3) Ofrimi i trajnimeve të vazhdueshme për prokurim publik

**2. Ndikimi i pritshëm në konkurrueshmëri/arsyetimi i masës**

Rritja e transparencës në procesin e prokurimit publik shërben për informim më të mirë të publikut apo palëve të interesuar për një proces transparent dhe të hapur, thjeshtimin e procedurave administrative, njëkohësisht rritet efikasiteti dhe efektiviteti i organeve gjegjëse dhe në përdorimin më efikas të fondeve publike duke e rritur konkurrueshmërinë që është një nga parimet bazë të Ligjit të Prokurimit Publik.

**3. Kostoja e vlerësuar e aktiviteteve dhe ndikimi buxhetor**

Kostoja e zbatimit për periudhën dy vjeçare (2018-19) siç është llogaritur nga Strategjia për Reformën e MFP-së është rreth 800,000€, përkatësisht përfshinë 431,583€ për vitin 2018, dhe 434,669€ për vitin 2019. Kjo përfshinë mirëmbajtjen e sistemit dhe ngritjen e kapaciteteve. Buxheti prezantuar ndër vite është buxheti i planifikuar për 2018-2019 në Buxhetin e vitit 2017. Sa i përket, koston së zbatimit të aktivitetit lidhur me mirëmbajtjen e sistemit të prokurimit publik, është bërë adresimi në KASH (2018-2020) për tri vitet e ardhshme.

**4. Ndikimi pritshëm në punësim dhe çështje gjinore**

Ndikimi në rezultate sociale do të jetë indirekt. Qasje më e lehtë e NVM-ve në kontrata të prokurimit mund të rezultojë me rritje të punësimit nga NVM-të. Rritja e efikasitetit të koston nga prokurimi do të rrit sasinë dhe cilësinë e të mirave dhe shërbimeve, të i ofrohen qytetarëve përmes kontratave të prokurimit publik.

**5. Rreziqet e mundshme**

Rreziku kryesor është i lidhur me nevojën për mbështetje të mëtjshme në nivel politik dhe të ekspertëve për të vazhduar me zbatimin e reformave të prokurimit publik, duke përfshirë edhe në prezantimin e praktikave të prokurimit elektronik. E fundit por jo më pak, një rrezik tjetër lidhur me këto reforma është nevoja për të krijuar sisteme të besueshme të teknologjisë informative që do të mundësojnë kryerjen e procedurave të prokurimit elektronik.

**4.3.1. REFORMAT NË TREGUN E ENERGJISË DHE TRANSPORTIT**

**a. Analiza e pengesave kryesore**

**Gjendja aktuale:** Me gjithë përmirësimin e ndjeshëm të të gjithë treguesve të performancës së sektorit të energjisë elektrike dhe asaj termike në 2016 në krahasim me 2015, jemi ende larg sigurisë së furnizimit të qëndrueshëm me energji për bizneset, shërbimet dhe ekonominë

familjare. Prodhimi në 2016 është rritur në krahasim me 2015 për 6%, humbjet në rrjetin e shpërndarjes janë ulur nga 31.8 në 2015 në 29.6 në 2016, kemi përmirësim të ndjeshëm të furnizimit si në sasi ashtu edhe në cilësi me ngrohje për qytetarët e Prishtinës. Mirëpo, fakti që burimet e furnizimit janë mjaft të pakta, si dhe kapacitete prodhuese mjaft të vjetruara, në njërin anë dhe mos fillimi i investimeve në projektet e mëdha të kapaciteteve të reja prodhuese energjetike dhe rehabilitimin e atyre ekzistuese, e bënë gjendjen e sigurisë jo të qëndrueshme.

Kur kësaj i shtohet fakti se pothuaj të gjitha vendet e rajonit janë neto importuese të energjisë elektrike bëhet emergjente nevoja për ndërmarrjen e masave sa më shpejt për të krijuar stabilitet të qëndrueshëm të furnizimit me energji elektrike dhe diversifikim të burimeve duke pasur në konsideratë futjen e gazsjellësit dhe sistemeve të energjisë së ngrohjes kudo ku ka potencial konsumi me kosto efektiv.

Lidhur me TC Kosova e re, sa i përket fazës së e parë të Projektit të Termocentralit Kosova e Re, janë arritur marrëveshje për çështje teknike si dhe çështjet të pazgjidhura për finalizimin e afarizmit komercial - (nënshkrimin të tetë marrëveshjeve tregtare). Në të njëjtën kohë, po punohet në përgatitje për finalizimin e fazës së dytë të mbylljes financiare dhe kontraktimit (Inxhinierin, Prokurim dhe Ndërtim). Gjithashtu, sipas projektit, Qeveria e Kosovës, në bashkëpunim dhe financim nga USAID, po punon për të finalizuar studimet përkatëse për Inxhinierin, Prokurim dhe Ndërtim.

Me gjithë ndërmarrjen e masave të shumta ligjore dhe rregulltave për liberalizimin e plotë të tregut, efektet e tyre vazhdojnë të jenë shumë të kufizuara për shkak se Operatori i Sistemit të Transmetimit nuk ka kontroll në rrjedhat ndërkufitare të energjisë elektrike si pasojë e moszbatimit të Marrëveshjes për Energji në mes Kosovës dhe Serbisë. Në këto kushte Kosova nuk po ka mundësi të gëzojë të mirat e integritetit të tregut rajonal.

Tek eficientia e energjisë megjithëse është identifikuar një potencial shumë i lartë i kursimit të energjisë, kryesisht në sektorin e banesave, me masat e deritashme të eficientës së energjisë nuk është arritur plani i paraparë për periudhën 2013-2015, por duke pasur parasysh projektet që janë duke u zhvilluar në fushën e eficientës së energjisë (implementimi i masave të Eficientës së energjisë në ndërtesat e sektorit publik) si dhe ato që do të zhvillohen deri në vitin 2018, besojmë se plani i përgjithshëm për kursim të energjisë i paraparë deri në vitin 2018 që është 92ktoe, të arrihet.

Qeveria e Kosovës në prill 2017 ka miratuar Strategjinë e Energjisë e cila parasheh masa konkrete për arritjen e stabilitetit të qëndrueshëm me energji elektrike, energji termike dhe gaz natyror për periudhën e ardhshme dhjetëvjeçare. Ky dokument duhet të dërgohet për miratim në Kuvendin e Republikës së Kosovës.

**Sa i përket transportit**, pozita gjeografike e Kosovës nënvizon rëndësinë e zhvillimit të një rrjeti efikas rrugor, duke e integruar plotësisht me atë të vendeve fqinje dhe rajonin. Rrugët përfaqësojnë më shumë se 90% të infrastrukturës së transportit për nga gjatësia, dhe 98% ajo e ofrimit të shërbimeve (BB, PFR, 2014). Kosova ka një “dendësi të lartë të transportit rrugor”, por kur matet si “gjatësi mesatare e rrugës për mijëra persona”, dendësia rrugëve të Kosovës është mesatare (BB, PFR, 2014).

**Në sektorin hekurudhor**, SEETO ka përcaktuar korridoret kryesore hekurudhore për Evropën juglindore, ku pjesë e këtyre korridoreve është edhe Kosova me linjën 10 hekurudhore (Leshak-Hani i Elezit) e cila i përket rrjetit gjithëpërfshirës të SEETO-s dhe e lidhë Kosovën me Serbinë dhe Maqedoninë. Për më tepër gjatë vitit 2016 ka filluar realizimi i projektit CONNECTA, ku ndër të tjera është paraparë që Linja e 10 Hekurudhore (Railway Route 10) të jetë pjesë e

Korridoreve Evropiane të Transportit Hekurudhor të Mallrave. Hekurudhat e Kosovës shtrihen në tërë territorin e Kosovës, me gjatësi prej 335 km linjë e hapur hekurudhore, me gjatësi prej 105 km në stacione dhe 103 km vija industriale, por kryesisht linjat hekurudhore duhet të modernizohen për të mundësuar shërbime më të mira të transportit. Kosova ka ligjin mbi hekurudhat i cili është në pajtim me legjislacionin e BE-së dhe i cili mundëson hapjen e tregut hekurudhor për ofrimin e shërbimeve të transportit të udhëtarëve dhe mallrave.

**Në sektorin e transportit ajror,** Kosova nuk ka ligj të veçantë për transportim të mallrave, por ky transport realizohet së bashku me atë të udhëtarëve dhe gjatë vitit 2016, duke u bazuar në statistikat e Cargos, janë bartë 1,157,785 kg. Zhvillimi i transportit ajror bëhet në bazë të marrëveshjes për shfrytëzimin e hapësirës së përbashkët Evropiane. Kosova ende nuk ka kompani ajrore. Legjislacioni i cili e rregullon fushën e transportit ajror është i harmonizuar me atë të BE-së, andaj ky legjislacion mundëson konkurrueshmërinë dhe liberalizimin e tregut pa pengesa.

**Pengesat strukturore:** Edhe pse ka pasur përmirësim të gjendjes aktuale prej vitit të kaluar Paqëndrueshmëria e furnizimit me energji elektrike ende vjen si pasojë e: (i) kapaciteteve prodhuese të energjisë elektrike të pamjaftueshme dhe të vjetërsuara; (ii) rrjetit të shpërndarjes së energjisë elektrike të vjetërsuar dhe me kapacitet të kufizuar (iii) diversitetit të ultë të burimeve të energjisë që ndikon në rëndimin e barrës për energjinë elektrike për plotësimin e nevojave për ngrohje të hapësirave dhe nevojave tjera; (iv) shfrytëzimit joracional të energjisë dhe mungesën e masave stimuluese për shfrytëzim eficient të energjisë elektrike nga ana e bizneseve dhe ekonomive familjare; (v) mos funksionalizimit të tregut të hapur të energjisë dhe ndër subvencionimet tarifore që bëhen në dëm të sektorit të bizneseve, me gjithë se jo në masën e viteve të kaluara.

Pengesat kryesore në sektorin e transportit janë: (i) kapacitetet e pamjaftueshme të shumicës së rrugëve sa i përket lidhjeve kryesore tregtare dhe të qarkullimit; (ii) mirëmbajtje jo duhur e rrugëve ekzistuese; (iii) gjendje jo e mirë e linjave të hekurudhës; (iv) mungesa e mjeteve lëvizëse hekurudhore; (v) mungesa e një hekurudhës funksionale në veri ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, për shkak të barrierave politike.

**Ndikimi i pengesave strukturore:** Furnizimi i paqëndrueshëm me energji ndikon negativisht në konkurrueshmëri, rritë koston dhe ndikon negativisht tek bizneset. Qëndrueshmëria e furnizimit me energji elektrike, paraqet faktor të rëndësishëm në procesin e vendimmarrjeve, qoftë për themelimin e bizneseve të reja apo investimin për zgjerimin e atyre ekzistuese. Çmimi i energjisë është faktor tjetër i rëndësishëm ndikues në konkurrueshmëri. Aktualisht çmimet e energjisë elektrike në

Kosovë, për sektorin e industrisë, janë më të larta në krahasim me shumicën e vendeve të rajonit. Mos siguria e furnizimit me energji, shfrytëzim joefikas i energjisë dhe mungesa e rrjeteve të ngrohjes ulë mirëqenien e popullatës dhe shton kostot. Mundësit e kufizuara për investime në sektorin e energjisë, ndikojnë në zhvillimin e përgjithshëm ekonomik dhe social të vendit. Një tjetër pengese është edhe vazhdimi i obstrukcioneve nga Serbia në sektorin e energjisë. Në fushën e transportit lidhjet jo adekuate ndërkombëtare shtojnë kohën dhe koston e transportit dhe udhëtimit, në këtë mënyrë zvogëlojnë qarkullimin tregtar dhe mobilitetin e fuqisë punëtore me ndikim negativ në punësim. Lidhjet jo adekuate ndërkombëtare të hekurudhës ulin nivelin e transportit të udhëtarëve dhe mallrave dhe kanë ndikimin negativë në zhvillimin e konkurrencës në transportin hekurudhor. Mungesa e rrjetit hekurudhor ka shkakuar ngarkesë të rrjetit rrugor, duke e shfrytëzuar atë për transport të mallrave.

## b. Planet e reformave prioritare

### Masa e reformës #2: Ulja e konsumit të energjisë me anë të masave të efijencës së energjisë

#### 1. Përshkrimi i masës

Si vazhdimësi e PRE 2017-2019, qëllimi i masës është zbatimi i masave të efijencës së energjisë në sektorin publik dhe amvisëri me qëllim të uljes së konsumit të energjisë, duke synuar arritjen e caqeve të kursimit të energjisë prej 92ktoe apo 9% të konsumit final të energjisë, masë e cila bazohet në Planit Kombëtar të Veprimit të Efijencës së Energjisë 2010-2018. Masa për efijencën e energjisë është gjithashtu e ndërlidhur me kuadrin e gjerë strategjik të Kosovës, duke përfshirë SKZH-në dhe Strategjinë për Sektorin e Energjisë.

Sa i përket zbatimit të masës të PRE gjatë vitit 2017 janë ndërmarr këto veprime: a) Auditimi i Energjisë në Ndërtesat e Shërbimit Publik- instalimi i sistemeve të ngrohjes qendrore në 4 objekte shkollore, financuar nga BRK; b) Është hartuar Mostra për Planet Komunale të veprimit për Efijencë të Energjisë për 6 Komuna; c) Është hartuar, formulari për hartimin e Planeve Komunale të EE për 18 komuna; d) Është përzgjedh kompania për dizajnin e projekteve për sektorin e Arsimit në 5 Komuna, që do të zbatohen masat e EE në 30 objekte. e) Është përfunduar projekti në zbatimin e masave të EE në 5 Objekte në nivelin qendror.

#### a. Aktivitetet e planifikuara për 2018

- 1) Miratimi i Ligjit për Efijencë të Energjisë;
- 2) Vlerësimi dhe marrja e vendimeve për modalitetet e mekanizmit të financimit për të mbështetur investimet në Efijencën e Energjisë në kuadër të Ligjit për EE.
- 3) Zbatimi i masave të efijencës së energjisë në 60 ndërtesa publike (këto masa përfshijnë: termoizolim të jashtëm të ndërtesës; ndërrimin e dymve të jashtëme dhe dritareve, rregullimin e çatisë dhe termoizolim të saj, vendosja e poqëve efijent, instalimin e sistemit të ngrohjes qendrore, etj.), *13 objekte të financuar nga BRK, 32 objekte nga të financuara nga BB dhe 15 objekte të financuar nga Qeveria Gjermane;*
- 4) Studimi i fizibilitetit për ndërtimin e sistemeve të ngrohjes qendrore për qytetet Drenas, Kastriot, Prizren, Pejë, Ferizaj, Gjilan, Mitrovicë dhe Zveçan, financuar nga Donator;
- 5) Zgjerimi i rrjetit të kogjenerimit për komunën e Prishtinën;
- 6) Ndërtimi i ngrohtores qendrore në Gjakovë me burim të energjisë me biomasë;
- 7) Instalimi i Softuerit për menaxhimin e energjisë në 6 komuna për të gjitha objektet që menaxhohen nga Komuna, ( Prishtinë, Podujeve, Mitrovicë, Gjakove, Drenas, Prizren);

#### b. Aktivitetet e planifikuara për 2019

- 1) Zbatimi i masave të efijencës së energjisë në 61 ndërtesa publike (këto masa përfshijnë: termoizolim të jashtëm të ndërtesës; ndërrimin e dymve të jashtëme dhe dritareve, rregullimin e çatisë dhe termoizolim të saj, vendosja e poqëve efijent, instalimin e sistemit të ngrohjes qendrore, etj.), *21 objekte të financuar nga BRK, 25 objekte nga të financuara nga BB dhe 15 objekte të financuar nga Qeveria Gjermane;*
- 2) Hartimi i dizajnit teknik për implementimin e sistemeve të ngrohjes qendrore për qytetet Drenas, Kastriot, Prizren, Pejë, Ferizaj, Gjilan, Mitrovicë dhe Zveçan, financuar nga Donator;

### c. Aktivitetet e planifikuara për 2020

- 1) Zbatimi i masave të efikasitetit të energjisë në 52 ndërtesa publike (këto masa përfshijnë: termoizolim të jashtëm të ndërtesës; ndërrimin e dyerve të jashtme dhe dritareve, rregullimin e çatisë dhe termoizolim të saj, vendosja e poqëve eficient, instalimin e sistemit të ngrohjes qendrore, etj), 27 objekte të financuara nga BRK dhe 25 objekte nga të financuara nga BB;
- 2) Fillimi i implementimit të sistemeve të ngrohjes qendrore për qytetet Drenas, Kastriot, Prizren, Pejë, Ferizaj, Gjilan, Mitrovicë dhe Zveçan, financuar nga Donator.

### 2. Ndikimi i pritur në konkurrueshmëri /arsyetimi i masës

Zbatimi i masës për efikasitetin e energjisë do të kontribuojë në zvogëlimin e konsumit të brendshëm. Ulja e konsumit të energjisë do të shërbejë për të ulur koston e energjisë dhe si rezultat do të ndihmojë bizneset dhe rritjen e investimeve në sektorin privat.

Efikasiteti i energjisë mund të ndihmojë në adresimin e sigurisë së energjisë (deficitet aktual dhe importet e reduktuara), duke zvogëluar shpenzimet publike për energji dhe ndikimet mjedisore nga përdorimi i energjisë.

### 3. Kostoja e vlerësuar e aktiviteteve dhe ndikimi buxhetor

Viti 2018 - BRK - 2 715 818 €; Huamarrje -6 800 000 €; Donator -5 433 333 €.

Viti 2019 - BRK - 2 750 000 €; Huamarrje -7 330 000 €; Donator -5 083 333 €.

Viti 2020 - BRK - 4 950 000 €; Huamarrje -6 000 000 €; Donator -3 833 334 €.

### 4. Ndikimi i pritur në punësim dhe çështje gjinore

Zbatimi i masave të EE ndikon në reduktimin e koston të energjisë në përgjithësi, në veçanti reduktimin e koston të energjisë elektrike, përmirësimin e kualitetit të jetës, përmirësimin e kushteve mjedisore dhe rritjen e mundësive për menaxhim më efektiv të energjisë, mirëqenie sociale dhe orientim të energjisë elektrike për zhvillim ekonomik (veçanërisht asaj të shpenzuar për ngrohje). Zbatimi i projekteve të EE krijon mundësi për hapje të vendeve të punës përmes ndërmarrjeve prodhuese dhe ndërtimore. Në bazë të indikatorëve të projektit të Bankës Botërore për vitin 2018 pritet që pas zbatimit të masave të EE në 32 ndërtesa në kuadër të Projektit në total do të kemi kursim në vlerë monetare rreth 1,24 mil € përmes reduktimit të faturave për energji, kursimi në energji do të jetë 1215.6 MWh apo 1.22 ktoe dhe numri i përfituesve do të jetë 7494 persona si shfrytëzues të ndërtesave, ku minimum 33% e tyre janë të gjinisë femërore.

### 5. Rreziqet potenciale

Mungesa dhe zvarritja e themelimit dhe operacionalizimit të Fondit të EE apo ndonjë mekanizmi tjetër financiar për mbështetjen e projekteve për EE paraqet mangësi për nxitjen e investitorëve, zhvillimin dhe zbatimin e programeve/projekteve në fushë të EE-s, rrezik për arritjen e caqeve të planifikuara të kursimit, ndikim negativ në shfrytëzimin racional të energjisë (asaj elektrike në veçanti), në të gjithë sektorët. Zvarritja e transpozimit të direktivës së re të Bashkimit Evropian EED në ligj të EE dhe ligjet tjera të energjisë mund të shkaktojë hezitim dhe prolongim të investimeve nga investitorët dhe institucionet ndërkombëtare financiare.

## Masa e reformës #3: Zhvillimi i mëtejshëm i kapaciteteve prodhuese të energjisë

### 1. Përshkrimi i masës

Me qëllim të sigurimit të furnizimit të qëndrueshëm me energji elektrike si faktor shumë të rëndësishëm për zhvillimin ekonomik, ndërtimi i kapaciteteve të reja prodhuese të energjisë elektrike mbetet prioritet në zhvillimin e reformave ekonomike të vendit. Kjo masë është në përputhshmëri me prioritetet strategjike të vendit të shprehura përmes SKZH-së dhe strategjisë për energjinë. Sa i përket zbatimit të masës të PRE gjatë vitit 2017 janë ndërmarr këto veprime: janë arritur marrëveshje për çështje teknike dhe pritet zgjidhja e çështjeve të pazgjidhura për finalizimin e afarizmit komercial (nënshkrimit të tetë marrëveshjeve tregtare) që do të ndodhë në fillim të vitit 2018. Në proces është finalizimi i fazës së dytë të mbylljes financiare dhe kontraktimit (Inxhiniering, Prokurim dhe Ndërtim) si dhe finalizimi i studimeve përkatëse për Inxhiniering, Prokurim dhe Ndërtim. Në lidhje me rehabilitimin e TC Kosova B është finalizuar studimi i fizibilitetit (IPA 2014) për TC Kosova B; njëkohësisht, janë zbatuar aktivitetet në lidhje me burimet e ripërtërishme të energjisë, ku ka filluar operimin i dy hidrocentraleve të reja me kapacitet të instaluar përkatësisht prej 4.38 MË dhe 4 MË.

**a. Aktivitetet e planifikuara për 2018**

- 1) Zhvillimi i Projektit të TC Kosova e Re: a) Mbyllja e fazës së Parë – Mbyllja Komerciale, Nënshkrimi i marrëveshjeve komerciale në mes të Qeverisë së Kosovës dhe investitorit privat Contour Global. b) Inicimi i Procedurës së Kontraktimit të Ndërtuesit të Termocentralit; c) Hartimi i Studimeve sipas kërkesave të projektit;
- 2) Zbatimi i tri projekteve të centraleve solare me kapacitet total prej 9 MW, kostoja e vlerësuar për tri projektet arrin shumën prej 9 milion €, investime private.;
- 3) Zbatimi i pesë projekteve të hidrocentraleve të vogla me kapacitet total të instaluar prej 22.1 MË, kostoja e vlerësuar për pesë projektet arrin shumën prej 28.73 milion €, investime private;

**b. Aktivitetet e planifikuara për 2019**

- 1) Zhvillimi i Projektit të TC Kosova e Re; a) Mbyllja e Fazës së Dytë – Mbyllja Financiare - ku do të bëhet përzgjedhja e kontraktorit për IPN (Inxhinierim, Prokurim dhe Ndërtim), si dhe aktivitete të shtuara me organizata ndërkombëtare financiare për të siguruar mbështetjen financiare të Projektit; b) Fillimi i ndërtimit të Termocentralit “Kosova e Re”
- 2) Zbatimi i katërmëdhjetë projekteve të reja nga hidrocentralet e vogla me kapacitet total të instaluar prej 61.8 MW, kostoja e vlerësuar për katërmëdhjetë projektet arrin shumën prej 80.34 milion €, investime private;
- 3) Zbatimi i dy projekteve të reja nga energjia e erës me kapacitet total të instaluar prej 32.4 MW, kostoja e vlerësuar për dy projektet arrin shumën prej 45.36 milion €, investime private;

**c. Aktivitetet e planifikuara për 2020**

- 1) Vazhdimi i ndërtimit fizik të Termocentralit “Kosova e Re”
- 2) Zbatimi i katërmëdhjetë projekteve të reja nga Hidrocentraleve të vogla me kapacitet total të instaluar prej 37.86 MW, kostoja e vlerësuar e aktiviteteve 49.22 milion €, investime private;
- 3) Zbatimi i tri projekteve të reja nga energjia e erës me kapacitet total të instaluar prej 105 MW, kostoja e vlerësuar e aktiviteteve 147 milion €, investime private;



## **2. Ndikimi i prituri në konkurrueshmëri /arsyetimi i masës**

Furnizimi i pandërprerë, cilësor, i besueshëm dhe me kosto të përballueshme me energji elektrike paraqet një nga kushtet kryesore të zhvillimit të qëndrueshëm të bizneseve dhe rritjen e konkurrueshmërisë së bizneseve. Me zbatimin e masës së zhvillimit të mëtejshëm të kapaciteteve prodhuese të energjisë elektrike do të rritet siguria e furnizimit me energji elektrike si kusht për rritjen e konkurrueshmërisë.

## **3. Kostoja e vlerësuar e aktiviteteve dhe ndikimi buxhetor**

Viti 2018 - BRK – 1.500.000 €; Investime Private – 37.730.000 €; Donator – 5000.000 €.  
Viti 2019 - BRK - 1.500.000 €; Investime Private -125.700.000 €; Donator - 5000.000 €.  
Viti 2020 - BRK - 1.500.000 €; Investime Private -196.220.000 €; Donator - 5000.000 €.

## **4. Ndikimi i prituri në punësim dhe çështje gjinore**

Projekti TC Kosova e Re, vlerësohet se të ndikojë në çështjet sociale dhe në punësim përgjatë periudhës 5-vjeçare të ndërtimit (2018-2022). Projekti TCKR pritet të ndikojë në masën prej 200 milion euro në vit në rritjen e GDP-së (apo 3% vlerë e shtuar e GDP-së vetëm nga ky projekt). Po ashtu, zhvillimi i projekteve të centraleve nga BRE-të do të ketë efekte në rritjen e punësimit dhe rritjen e investimeve vjetore për 70 milion EUR.

## **5. Rreziqet potenciale**

Investimet për zhvillimin e mëtejshëm të kapaciteteve prodhuese të energjisë elektrike parashihen që të bëhen nga investitorë privat. Përsëritja e ndonjë krize ekonomike mund të paraqet rrezik për investime në këto projekte dhe për pasojë do të zvogëlohet mundësia që investitorët privat t'i bëjnë investimet sipas planifikimeve.

### **4.3.3. ZHVILLIMET SEKTORIALE (BUJQËSIA, INDUSTRIA DHE SHËRBIMET)**

#### **a. Analiza e pengesave kryesore**

**Gjendja aktuale:** Në vendin tonë sektori i ushqimit dhe i bujqësisë ka potencial të kontribuojë dukshëm në zhvillimin e përgjithshëm ekonomik, në reduktimin e varfërisë dhe në rritjen e sigurisë së ushqimit ku në vitin 2016 pati pjesëmarrje në BPV me 10.5% në bruto produktin e brendshëm. Llogaritet se në bujqësi janë të punësuar 86,620 persona me orar të plotë, apo 26.7% e të punësuarve janë në fushën e bujqësisë, prej të cilëve rreth 50% janë anëtarë të familjes që angazhohen në fermë. Pjesëmarrja e vlerës së eksportit të produkteve bujqësore në vlerën e përgjithshme të eksportit në vitin 2016, ishte 15%. Vlera totale e prodhimit bujqësorë duke përfshirë edhe shërbimet vlerësohet të jetë 736.8% mil. €, nga ku prodhimet bimore kanë pasur vlerën 412.3 mil. €, me pjesëmarrje prej 56%, prodhimet blegtorale 302.4 mil € ose 41% dhe shërbimet 22.1 mil. €, që kishin pjesëmarrje 3%.

Buxheti i ndarë për mbështetje të sektorit të bujqësisë çdo vit ka shënuar rritje, jo vetëm nga fondet publike përmes pagesave direkte dhe granteve investive, por ky sektori është mbështetur edhe nga donatorë të ndryshëm. Në vitin 2016 niveli i mbështetjes përmes pagesave direkte ka qenë 26.1 mil €, e që në krahasim me vitin paraprak ka shënuar rritje për 22%. Janë mbështetur kulturat bujqësore me pjesëmarrja 61% në totalin e pagesave direkte dhe blegtoria me pjesëmarrje 39%. Në 5 vitet e fundit shuma totale e mbështetjes përmes pagesave direkte ka qenë 83.2 mil €.

Në vitin 2016, në Kosovë ka pasur 185,705 ha tokë të punueshme – ara. Toka e përdorur nga fermat në vendin tonë në vitin në fjalë përbënte rreth 45% të gjithë sipërfaqes së shfrytëzuar të

tokës bujqësore. Shikuar në tërësi mund të themi se sa i përket ekonomive bujqësore në Kosovë ato karakterizohen me tri kategori kryesore të madhësisë së fermave: Afërsisht 94.2% të ekonomive bujqësore apo 102,530 sosh në vitin 2016, bëjnë pjesë në kategoritë e madhësisë së fermave prej më pak se 0,5 deri në më pak se 5 ha; Kur bëhet fjalë për fermat me madhësi më të madhe të sipërfaqes së tokës së punëshme vijmë në përfundim se duke filluar nga fermat me madhësi 5 deri më pak se 10 ha kanë vetëm 4.16%, që bëjnë pjesë 4,531 ekonomi bujqësore; - Vetëm 1.60%, që do të thotë se 1,742 ekonomi bujqësore kishin ferma me madhësi nga 10 deri në 30 e më shumë ha.

Spektori i industrisë së ushqimit në Kosovë ka pësuar ndryshime thelbësore gjatë dekadës së kaluar. Bazuar në të dhënat e ASK-së shohim se duke filluar nga viti 2012 deri në vitin 2014 mesatarja e pjesëmarrjes së aktiviteteve bujqësore të regjistruara në regjistrin e biznesit ndaj aktiviteteve tjera ishte 7.6%. Duke filluar nga viti 2015 kemi një rritje prej 9.6%, pasuar me rritje të pjesëmarrjes në 10.4% në vitin 2016. Të dhënat sa i përket konsumit të ndërmjetëm dhe prodhimit të industrisë bujqësore kanë shënuar rritje në vitin 2016. Krahasuar me vitin 2015, në vitin 2016 prodhimi i industrisë bujqësore është rritur për 11%, ndërsa konsumi i ndërmjetëm është rritur për 7%. Numri më i madh i fuqisë punëtore me afro 5,427 të punësuar, i takojnë kategorisë së përpunimit të produkteve ushqimore.

Niveli i konkurrueshmërisë së sektorit privat ende mbetet relativisht i ulët në krahasim me atë të vendeve të tjera. Një indikator kryesor që e tregon këtë fakt është edhe bilanci negativ tregtar që për vitin 2016 shënoi një vlerë prej 2 miliard e 483 milion euro. Gjithashtu, industria në Kosovë përbëhet kryesisht nga biznese mikro dhe të vogla, të fragmentuara, dhe të orientuara kryesisht në aktivitete me vlerë relativisht të ulët të shtuar. Sektorët e prodhimit industrial gjatë tri viteve të fundit kishin një pjesëmarrje relativisht të ulët (rreth 12%) në BPV-ne e vendit.

Përveç kësaj, edhe në rastin e sektorëve industrial me shkallën dhe potencialin relativisht më të zhvilluar, janë identifikuar zinxhirë të vlerës dhe furnizimit relativisht të pa zhvilluar dhe të pa integruar në nivel vendor, e sidomos në atë rajonal dhe ndërkombëtar. Një nga arsyt kryesore të kësaj mungese të integritetit të bizneseve Kosovare në zinxhirët përkatës të vlerës është e mungesa e cilësisë së produkteve, qasjes në informacion, rrjetëzimit të mirëfilltë, ndjekur nga kapacitetet e ulëta në kuptimin e sasisë së prodhimit dhe fuqisë punëtore të afte për të përballuar kërkesat relativisht të mëdha.

Bashkëpunimi ndërmjet ndërmarrjeve është ende në fazat e hershme të tij dhe ka disa shoqata efektive në vend. Ndërmarrjet në sektorët kanë probleme të përbashkëta, shumë prej të cilave mund të trajtohen nëpërmjet përpjekjeve bashkëpunuese. Pjesa më e madhe e ndërmarrjeve janë shumë të vogla dhe duhet të rangohen lartë për t'u bërë më konkurruese dhe produktive.

Tregtia në shërbime në Kosovë në vitin 2016 ka arritur në total prej 1,498 Miliard Euro. Nga kjo shumë, totali i eksportit përfshinë një shumë prej 1,038 Miliard Euro, ndërsa importi një shumë të përgjithshme prej 460 Milion Euro. Kjo tregon një bilanc tregtar pozitiv prej 579 Milion Euro. Nëse e krahasojmë me vitin 2015, shohim se eksporti i shërbimeve ishte 887 Milion Euro, përderisa importi rezultoi me 467 Milion Euro në tregtimin ndërkombëtar të shërbimeve. Duke u bazuar në këto shifra, shohim se ka një trend pozitiv të rritjes së eksportit të shërbimeve me 151 Milion Euro më shumë të hyra apo kalkuluar në përqindje me 17%. Sektorët kryesorë të cilët kontribuuan drejt një bilanci tregtar pozitiv për periudhën (janar – dhjetor 2016) janë: udhëtimet (turizmi) me eksport në vlerën prej 809 Milionë Euro, e ndjekur nga biznesi dhe shërbime profesionale me 63 Milion Euro, shërbimet e informacionit dhe komunikimit (TIK) me 48.5 Milionë Euro shërbimet e ndërtimit me 13 Milion Euro dhe shërbimet qeveritare me 35.5 milionë

euro. Vlerësohet që rritja në aktivitetin biznesor turistik gjatë dy viteve të fundit ishte rreth 25%, po pritjet për rritje gjatë viteve në vijim janë edhe më të larta mbi 40%.

**Pengesat strukturore:** Pengesat strukturore kryesore që pengojnë zhvillimin e sektorit të bujqësisë janë: madhësia e vogël e fermës (sipas rezultateve të Regjistrimit të Bujqësisë të vitit 2014, sipërfaqja mesatare e tokës për ekonomi bujqësore është 3.2 ha), fragmentimi i tokës (numër shumë i madh i ngastrave), infrastruktura e ujitjes, mosfunksionimi dhe jo efikasiteti i tregut të tokës, lidhjet e dobëta apo jofunksionale në mes të prodhuesit primar dhe përpunuesve, lidhjet në mes të prodhuesve dhe tregut kapacitete të pamjaftueshme për ruajtje, llojllojshmëria e kulturave dhe mungesa e specializimit etj. Sa i përket sigurisë së ushqimit dhe përputhshmërisë me standardet e cilësisë, niveli i zbatimit të standardeve si ato vendore po ashtu edhe ato të BE-së ende mbetet i ulët.

Në mesin e problemeve të rëndësishme që kufizojnë kontributin dhe efektin multiplikues të industrisë në zhvillimin ekonomik të vendit janë importi ende i lartë, nivel i ulët i IHD si dhe ndërlidhja në mes të sektorëve prodhues. Pengesat në zhvillimin e përgjithshëm të sektorit të industrisë, kanë të bëjnë me sfidat që lidhen me shfaqjen e grupimeve industriale. Në veçanti përfshihen bashkëpunimi i dobët ndërmjet kompanive dhe koordinimit të dobët nëpërmjet shoqatave të industrisë që nuk performojnë mirë dhe institucione të dobëta arsimore dhe hulumtuese që do të kishin furnizuar sektorin e NVM-ve me njohuri relevante për biznes.

Një pengesë e ndërlidhur është mungesa e skajeve konkurruese (për shkak të mungesës së fuqisë punëtore të kualifikuar ose mungesës së inovacionit) për integrimin e grupimeve lokale si pjesë e zinxhirit të vlerave rajonale ose globale. Gjithashtu, mungesa e certifikimit të produkteve dhe procesit të prodhimit konsiderohet se pengon përpjekjet për të integruar grupimet lokale në sektorin e NVM-ve në përgjithësi.

Përkundër zhvillimeve pozitive të viteve të fundit, produktet dhe shërbimet turistike në dispozicion mbeten ende të kufizuara. Pengesat kryesore në këtë sektor mbetet mungesa e kornizës ligjore adekuate dhe koordinimi i duhur institucional. Ka shumë pak informata të shtypura dhe elektronike në lidhje me vendet turistike, bukuritë si dhe për produktet dhe shërbimet në dispozicion. Shumë pak oferta turistike me produkte të turizmit malor dhe rural, apo të turizmit ndërkufitar. Mungon zhvillimi i produkteve turistike potenciale në komunitet dhe tour operatorët në zonat rurale dhe malore të cilat mund të ofrohen për shitje.

**Ndikimi i pengesave strukturore:** Madhësia e vogël e fermave së bashku me teknologjinë dhe makinerinë e vjetruar janë faktorë që ndikojnë drejtpërsëdrejti në koston e prodhimit të kulturave bujqësore dhe në nivelin e produktivitetit në bujqësi. Duke qenë se këta dy faktorë ndikojnë që kosto e prodhimit të rritet, fermerët tanë janë në pozitë të disfavorshme në raport me prodhuesit e vendeve tjera dhe prodhimi kosovar nuk mund të jetë konkurrentë në tregun e jashtëm apo edhe në tregun e brendshëm ku shitjet e tyre janë të ndikuara nga prodhimi i jashtëm që importohet dhe plasohet në tregun tonë me çmime më të ulëta sesa ai vendor. Madhësia e vogël e fermave gjithashtu ndikon drejtpërsëdrejti në produktivitet.

Lidhjet e dobëta në mes të prodhuesve primar dhe industrisë përpunuese, si dhe mungesa e marrëveshjeve formale ndikojnë në pasigurinë e fermerit lidhur me atë se ku do e shes prodhimin e tij. Tregu joformal ndikon në zhvillimin e konkurrencës jo të drejtë në mes të prodhuesve por gjithashtu edhe në cilësinë e produkteve që shiten, duke qenë se ato produkte nuk i nënshtrohen asnjë kontrolli. Moszbatimi i tërësishëm i standardeve të sigurisë dhe cilësisë ndikon në mundësinë e qasjes së fermerit në treg andaj arritja e kësaj objektivë është shumë e rëndësishme dhe është pjesë e secilës masë të planit të zhvillimi rural.

Pamjaftueshmëria e kapaciteteve për ruajtjen e prodhimit bujqësorë ndikon në rritje të deficitit të bilancit tregtar të prodhimeve bujqësore duke qenë se më përfundimin e sezonës, prodhimi nuk mund të ruhet dhe fermerët detyrohen ta shesin atë menjëherë, dhe në këtë kohë edhe çmimi është më i ulët.

Të gjitha këto pengesa ndikojnë fillimisht në prodhimin primar e kjo e ndikon edhe zhvillimin e industrisë përpunuese sepse atyre u kufizon mundësinë e të bërit biznes në sasi të mjaftueshme me prodhime primare bujqësore.

Si rezultat i strukturës së ndërmarrjeve dhe pengesave për bashkëpunim dhe pjesëmarrje në zingjirët e vlerës rajonale, prodhimi industrial është i dominuar me prodhimtari me vlerë të ulët, mungon inovacioni dhe mbetet jo-konkurrues në tregjet e eksportit dhe gjithashtu në tregjet e brendshme krahasuar me produkte të importuara me cilësi të mirë.

Ngjashëm, për shkak të vëmendjes së ulët të turizmit dhe zhvillimit të produkteve atraktive turistike, niveli aktual i zhvillimit të sektorit të turizmit është në nivel të largët nga potenciali i tij. Mundësitë për të ardhura dhe punësim mbeten të pashfrytëzuara.

## **b. Planet e reformave prioritare**

### **Masa e reformës#4: Investimet në infrastrukturën bujqësore dhe për agro-përpunim**

#### **1. Përshkrimi i masës:**

Zbatimi i kësaj mase ka për synim zgjerimin e kapaciteteve prodhuese në prodhimtarin primar. Qeveria e Kosovës përmes kësaj mase synon të ketë rritje për 36.6% të numrit të fermave të përkrahura sipas sektorëve të përkrahur: sektori i perimeve dhe serrave me 65%, sektori i mishit me 44%, ai i qumështit me 33.3%, sektori i rrushit me 1.6% dhe sektori i vezëve do të ketë një rritje të moderuar. Në kuadër të investimeve në infrastrukturë për vitet e ardhshme do të fokusohet në zgjerimin e sipërfaqeve nën ujtitje me rreth 5% krahasuar me vitin e kaluar. Investimet në sektorin e agro-përpunimit që përfshinë investimet në deponime dhe magazinim dhe zgjerimin e numrit të laboratorëve testues për verifikimin e cilësisë së prodhimit, synojmë rritje të numrit të ndërmarrjeve agro-përpunuese: përpunim i qumështit 18.2%, përpunim i mishit 50%, përpunimi i pemëve dhe perimeve 16.6% dhe prodhimi i verës me rreth 21.6%). Në përmirësimin/zbatimin e standardeve kombëtare dhe të BE-së në sigurinë e ushqimit/mirëqenien e kafshëve/mjedisit edhe në periudhën planifikuese do të mbështeten mbi 30 ndërmarrje në baza vjetore që t'i arrijnë këto standarde. Numri i ndërmarrjeve të modernizuara, me pajisjeje të reja teknologjike dhe me futjen e linjave të reja të prodhimit dhe produkteve të reja do të jetë rreth 40 ndërmarrje në vit. Gjithashtu, numri i ndërmarrjeve agro-përpunuese që do të trajtojnë mbetjet dhe mbeturinat në menaxhimin adekuat do të jetë mbi 10 ndërmarrje në vit. Si dhe do të rritet numri i ndërmarrjeve që do të investojnë në prodhimin e energjisë së ri-përtrishme. Skenarët bazë për investime dhe analizim të rezultateve dhe arritjeve në këtë masë është marr vlerësimi Ex-ant i PZHRB 2014-2020, i realizuar me mbështetjen e KE në vitin 2013.

#### **a) Aktivitetet e planifikuara për vitin 2018:**

- 1) Investimet në infrastrukturën fizike – shtimi i sipërfaqeve prodhuese në sektorin e hortikulturës: serra, pemë shumë vjeçare, pemë të imëta, vreshta, fidanishte.
- 2) Investimet në infrastrukturën fizike – shtimi i kapaciteteve prodhuese në blegtori dhe shpeztari, shtalla të reja për prodhimin e qumështit, mishit, pulave vojse dhe rritjen e zogjve për mish (brojler).
- 3) Investimet në ndërmarrjet agro-përpunuese, përkatësisht zgjerimin e kapaciteteve përpunuese dhe futjen e linjave të reja të prodhimit, investimet në higjienë dhe

standarde të cilësisë, investimet në marketing në sektorët e: qumështit, mishit, pemëve dhe perimeve, verë dhe pije të forta alkoolike.

- 4) Investimet në sistemin e ujitjes: zgjerimi i kanaleve të reja të sistemit të ujitjes primare, sekondar dhe terciar.
- 5) Investimet në modernizim të sistemeve dhe regjistrave elektronik (FADN, IACS, sLIPS, REF, regjistri i kafshëve, dhe regjistri i statistikave tregtare).

**b) Aktivitetet e planifikuara për vitin 2019:**

- 1) Investimet në infrastrukturën fizike – shtimi i sipërfaqeve prodhuese në sektorin e hortikulturës: serra, pemë shumë vjeçare, pemë të imëta, vreshta, fidanishte.
- 2) Investimet në infrastrukturën fizike – shtimi i kapaciteteve prodhuese në blegtori dhe shpeztari, shtalla të reja për prodhimin e qumështit, mishit, pulave vojse dhe rritjen e zogjve për mish (brojler).
- 3) Investimet në ndërmarrjet agro-përpunuese, përkatësisht zgjerimin e kapaciteteve përpunuese dhe futjen e linjave të reja të prodhimit, investimet në higjienë dhe standarde të cilësisë, investimet në marketing në sektorët e: qumështit, mishit, pemëve dhe perimeve, verë dhe pije të forta alkoolike.
- 4) Investimet në sistemin e ujitjes: zgjerimi i kanaleve të reja të sistemit të ujitjes primare, sekondar dhe terciar.
- 5) Investimet në modernizim të sistemeve dhe regjistrave elektronik (FADN, IACS, sLIPS, REF, regjistri i kafshëve, dhe regjistri i statistikave tregtare).

**c) Aktivitetet e planifikuara për vitin 2020:**

- 1) Investimet në infrastrukturën fizike – shtimi i sipërfaqeve prodhuese në sektorin e hortikulturës: serra, pemë shumë vjeçare, pemë të imëta, vreshta, fidanishte.
- 2) Investimet në infrastrukturën fizike – shtimi i kapaciteteve prodhuese në blegtori dhe shpeztari, shtalla të reja për prodhimin e qumështit, mishit, pulave vojse dhe rritjen e zogjve për mish (brojler).
- 3) Investimet në ndërmarrjet agro përpunuese, përkatësisht zgjerimin e kapaciteteve përpunuese dhe futjen e linjave të reja të prodhimit, investimet në higjienë dhe standarde të cilësisë, investimet në marketing në sektorët e: qumështit, mishit, pemëve dhe perimeve, verë dhe pije të forta alkoolike.
- 4) Investimet në sistemin e ujitjes: zgjerimi i kanaleve të reja të sistemit të ujitjes primare, sekondar dhe terciar.
- 5) Investimet në modernizim të sistemeve dhe regjistrave elektronik (FADN, IACS, sLIPS, REF, regjistri i kafshëve, dhe regjistri i statistikave tregtare)

**2. Ndikimi i pritur në konkurrueshmëri/arsyetimi i masës**

Si rezultat i këtyre masave rritja ekonomike, si shtesë neto e vlerës bruto të shtuar në ndërmarrjet e mbështetura pritet të jetë 15%. Rritja e produktivitetit të punës, si rritje (në %) e të hyrave shtesë, bruto për çdo vend pune, në fermat e përkrahura gjatë kësaj periudhe pritet të jetë 15%, ndërsa rritja e punësimin të fermerët e përkrahur pritet te jete rreth 1.6%, apo rreth 1,400 vende te reja te punës. Për më tutje përmes avancimit të standardeve të kualitetit të ushqimit synohet zëvendësim i shtuar i prodhimeve/produkteve bujqësore të importuara me prodhimet vendore dhe në të njëjtën kohë rritje e eksportit të produkteve bujqësore. Rritja e eksportit për këto

kategori të produkteve të përkrahura pritet të jetë per 10% apo pjesëmarrja ndërsa zëvendësimi dhe ulja e importit për 3%.

### **3. Kostoja e vlerësuar e aktiviteteve dhe ndikimi buxhetor**

Kosto për implementim të kësaj mase është e buxhetuar ne Buxhetin kombëtar dhe është si në vijim: Për vitin 2018 = € 47,500,000.00, për vitin 2019 = € 47,600,000.00, për vitin 2020 = € 48,700,00.00. Gjatë kësaj periudhe pritet që edhe donatorët të përfshihen kryesisht në projekte të ujitjes dhe projekte të ndërlidhura me infrastrukturë të TI-së: Projektet potenciale për IPA 2018 – Skema e Granteve për Bujqësi dhe Zhvillim Rural € 10,000,000.00; Futja e standardeve të bujqësisë dhe fuqizimi i shërbimeve këshillimore për menaxhimin dhe kontabilitet € 2,000,000.00; Konsolidimi i kapaciteteve institucionale të Autoritetit Menaxhues dhe Agjencisë së Pagesave për grantet e zhvillimit rural € 3,000,000.00 €. Projekti i Bankës Botërore investime në vitin 2018: Sistemi i Radoniqit 300,000.00 \$ dhe për vitin 2019 përgatitja e master planit në ujitje 1,000,000.00 \$.

### **4. Ndikimi i pritur në punësim dhe çështjet gjinore**

Zbatimi i kësaj mase do të ndikojë në stimulimin e popullatës në zonat rurale për të mirëmbajtur dhe rritur aktivitetet e fermës dhe të procesimit dhe kultivimin e tokës bujqësore, futja e kulturave të veçanta në prodhim të cilat mund të kenë prioritet dhe aftësi konkurruese. Masa pritet të ketë ndikim të drejtpërdrejt në situatën ekonomike të familjeve që merren me bujqësi përmes rritjes së nivelit të të ardhurave të tyre.

### **5. Rreziqet e mundshme:**

Nuk parashihet ndonjë rrezik i mundshëm përveç ndryshimeve të mundshme klimatike dhe ndonjë katastrofe të karakterit natyror.

## **Masa e reformës #5: Zgjerimi e fermave përmes konsolidimit dhe rregullimit të tokave bujqësore**

### **1. Përshkrimi i masës**

Projekti i komasacionit të pa-përfunduar të tokës bujqësore ka përfunduar në 21 Zona Kadastrale në Komunën e Drenasit me sipërfaqe 4,790.00 ha dhe në 5 Zona Kadastrale në Komunën e Vushtrrisë me sipërfaqe 487.21 ha. Duke pas parasysh rëndësinë e kësaj mase, Qeveria e Kosovës, synon të vazhdojë përpjekjet për zgjerimin e fermave bujqësore përmes konsolidimit dhe inventarizimit të tokës bujqësore. Konsolidimi dhe inventarizimi i tokës bujqësore do të lehtësohet përmes masave ligjore dhe institucionale, krijimin e tokave bujqësore në ngastra me formë të rregullt gjeometrike. Kjo masë bazohet në SKZH, PBRZH dhe Strategjinë për të Drejtat Pronësore.

#### **a) Aktivitetet e planifikuara për vitin 2018:**

- 1) Integrimi i të dhënave të përpunuar në bazën e të dhënave hapësinore
- 2) Lendet nga projekte e realizuar në komunën e Drenasit dhe në komunën e Vushtrrisë të vendosen në Regjistrin e të drejtave të pronës së Paluajtshme-RDPP.
- 3) Diskutimet individuale me fermerët pjesëmarrës në projekt.
- 4) Adresimi i sugjerimit, dhe kërkesave të fermerëve lidhur me mundësin dhe dëshirën e shitblerjes, ndërrimit, ri-lokimit të parcelave të tyre brenda projektit bazuar në Projektin e paraparë për rregullim dhe konsolidim të tokës në sipërfaqe prej 25 ha në Celinë, Komuna e Rahovecit.

#### **b) Aktivitetet e planifikuara për vitin 2019:**

- 1) Krijimi i GRID dhe hartave të terrenit, integrimi në GIS mobile
- 2) Grumbullimi i të dhënave në terren dhe analizimi i mostrave
- 3) Studimi fushor për vlerësimin e përshtatshmërisë së tokës bujqësore për komunën e Rahovecit.
- 4) Studimi fushor për marrjen e mostrave bujqësore për tokën bujqësore, livadhe dhe kullota (18644.5 ha) për komunën e Rahovecit.
- 5) Kryerja e sondimeve, marrja e mostrave të tokës, etiketimi duke përdorur aplikacionin në pajisje mobile.
- 6) Analizimi i mostrave në Laboratorin e Institutit Bujqësor të Kosovës me qëllim vlerësimin e treguesve të pjellorisë së tokave bujqësorë.

**c) Aktivitetet e planifikuara për vitin 2020:**

- 1) Të dhënat e mbledhura në terren nga sondimet e tokës dhe përshkrimi i profileve do të hidhen në bazën e të dhënave.
- 2) Grupi i të dhënave kyç për vlerësimin e përshtatshmërisë së tokës.
- 3) Do të përcaktohet klasa e përshtatshmërisë dhe kufizuesit për çdo pikë.
- 4) Klasifikimi i tokave të komunës së Rahovecit duke kombinuar të dhënat e përshkrimit të tokës dhe tipave të saj në terren si dhe ato fiziko – kimike të analizuar në laborator.
- 5) Bazuar në analizat e mostrave të tokës duhet të bëhet vlerësimi i treguesve të pjellorisë së tokës.
- 6) Bazuar në të dhënat laboratorike duhet të bëhet vlerësimi i niveleve kritike të metaleve të rëndë në tokë dhe faktorët që ndikojnë përmbajtjen e tyre.

**2. Ndikimi i pritur në konkurrueshmëri/arsyetimi i masës**

Projektet e komasacionit vullnetar do të ndikon në rritjen e madhësisë së fermës, qasje më të mirë në pronë, zgjidhjen e çështjes pronësore etj., që paraqesin bazë për uljen e shpenzimeve për njësi, rritjen e produktivitetit bujqësorë, konkurrencës se prodhimeve bujqësore në treg dhe si rrjedhojë rritjen e të ardhurave të fermerëve. Zgjidhja e çështjes se pronës dhe konsolidimi i tyre ndihmon fermerët në ofrimin e sigurisë në zotërimin e pronës, qasje më të mirë në kredi dhe në projektet investues për Zhvillimin Rural. Gjithashtu, do të kontribuoj në shpërndarje më të drejtë të subvencioneve nga buxheti i shtetit për pronaret dhe shfrytëzuesit e këtyre pronave, kontroll më të mirë të këtyre pronave tokësore dhe monitorim më të mirë të këtyre subvencioneve.

**3. Kostoja e vlerësuar e aktiviteteve dhe ndikimi buxhetor**

Kjo kosto për implementim të kësaj mase është e buxhetuar ne Buxhetin kombëtar dhe është si në vijim: për vitin 2018 = € 500,000.00, për vitin 2019 = € 500,000.00, për vitin 2020 = € 500,000.00. Gjatë kësaj periudhe pritet që edhe donatorët të përfshihen në realizimin e këtij aktiviteti: Për vitin 2018 = 60,000.00\$. Projektet potenciale per IPA 2019: Konsolidimi i tokës i përmirësuar, aplikimi i legjislacionit dhe masave mbështetëse € 1,800,000.00; Mbështetje për finalizimin e regjistrit kombëtar të tokave bujqësore € 5,500,000.00 dhe Ngritja e kapaciteteve institucionale për menaxhimin e tokave pyjore € 1,200,000.00

**4. Ndikimi i pritur në punësim dhe çështje gjinore**

Implementimi i kësaj mase pritet të ndikoj në lehtësimin e reformës së tokës përmes zhvillimit të tregut të tokës, (sigurinë e të drejtës pronësore, volume më të lartë të tregtimit, krijimin e kontratave standarde të qiradhënie), duke parandaluar fragmentimin e mëtejshëm të ngastrave,



përmirësimin e kontrollit të ndërtimeve të pa planifikuar në zonat e përfshira me komasacion. Masa do të ndihmojë fermerët të kalojnë nga fermat ekzistenciale të produkte konkurruese dhe krijimin e vendeve të punës në prodhimtari bujqësore, ndërsa pronarët pasivë të tokave që nuk janë aktivë në ferma do të kenë mundësi të kenë të ardhura nga shitja ose dhënia me qira e tokës.

## 5. Rreziku potencial

Mungesa e bashkëpunimit dhe mungesa e shprehjes së vullnetit nga qytetaret për konsolidim vullnetar të tokës. Supozimi kryesor mbi të cilin qëndron konsolidimi vullnetar i tokës është mundësia e Ministrisë për të ofruar asistencë teknike falas dhe përkrahje në lidhje me koston e transaksionit si një stimulim i fuqishëm ndaj të cilit fermerët mund të reagojnë<sup>9</sup>.

### Masa #6: Zhvillimi i konkurrueshmërisë së sektorit privat përmes zhvillimit industrial për NVM-të

#### 1. Përshkrimi i masës

Si vazhdimësi e PRE 2017-2019, kjo masë synon përmirësimin e konkurrueshmërisë së NVM-ve të Kosovës duke vendosur një theks të veçantë tek mekanizma që: përmirësojnë bashkëpunimin mes NVM-ve, e rrisin rrjetëzimin me kompani të tjera rajonale dhe të BE-se, përmirësojnë dialogun mes sektorit publik dhe privat, identifikohen potenciale për përmirësim të zinxhirit të vlerës, si dhe përmirësohet qasja në financa. Një prej arsyeve kryesore të mungesës së integritetit të bizneseve Kosovare në zingjirin përkatës të vlerës është mungesa e cilësisë së produkteve, e përcjellur nga kapaciteti i ulët në kuptimin e sasisë së prodhimit dhe fuqisë punëtore të aftë për tu përballur me kërkesën relativisht të lartë. Studimet kanë identifikuar sektorët në vijim si më prioritar për investim: TIK, përpunimi i ushqimit, minierat dhe përpunimi i metaleve, energjia, tekstili dhe përpunimi i lëkurës, përpunimi i drurit dhe turizmi. Gjithashtu, janë identifikuar sektorë të caktuar si më të gatshëm për zhvillimin e klasterëve industrial.<sup>10</sup> Kjo masë është e ndërlidhur me dokumentet kryesore strategjike, përkatësisht: Strategjinë Kombëtare për Zhvillim (2017 -2021), Programi Kombëtar për Zbatimin e MSA-së dhe Programi i Qeverisë 2017-2021.

Gjatë vitit 2017 është punuar në funksionalizimin e Këshillit/Forumit për Hartim të Politikave Industriale me qëllim stimulimin e konkurrueshmërisë në sektorët e industrisë dhe informimin në lidhje me sfidat dhe barrierat që hasen në këto sektorë në mënyrë që të rekomandohen masa dhe politika më efektive për adresimin e tyre. Gjithashtu gjatë viti 2017 është punuar në hulumtimin e zinxhirit të vlerës për katër sektorë potencial të industrisë.

#### a. Aktivitetet e planifikuara për 2018:

- 1) Hartimi dhe miratimi i Strategjisë për Zhvillimin e Sektorit Privat 2018-2022, që do të përfshijë edhe politikat industriale;
- 2) Ndërmarrja e analizave për mbështetjen e zhvillimit dhe zbatimit të politikave industriale: zhvillimi i potencialeve dhe zingjirit të vlerës në sektorët industrial; kapacitetet e shoqatave të sektorëve industrial; analizimi i skemave ekzistuese dhe propozimeve për të reja me qëllim të përmirësimit të qasjes në financa; raporti vjetor për zhvillim industrial;

<sup>9</sup>[http://www.fao.org/fileadmin/user\\_upload/Europe/documents/Events\\_2007/Land2007/Kosovo.pdf](http://www.fao.org/fileadmin/user_upload/Europe/documents/Events_2007/Land2007/Kosovo.pdf)

<sup>10</sup> Studimet për tetë sektorët industrial, Raporti për Konkurrueshmëri “Grupet Natyrore” (<https://mti.rks-gov.net/desk/inc/media/30DB588C-CD11-4EFA-9044-F74480A3A5EF.pdf>) dhe Studimi mbi perspektivat për përmirësim e Industrisë së Kosovës përmes Iniciativave Grupore. <https://mti.rks-gov.net/page.aspx?id=2,79>

- 3) Zbatimi i rekomandimeve nga Forumi për Zhvillimin e Politikave Industriale dhe përmirësimi i dialogut ndërmjet qeverisjes qendrore dhe lokale dhe akterëve të tjerë;
- 4) Promovimi dhe mbështetje e ndërmarrjeve në 4 parqet industriale, 2 parqe të biznesit, një zonë agro-industriale dhe një parku industrial.
- 5) Zbatimi i programeve mbështetëse për NVM-të dhe ndërmarrësit (certifikimi dhe vaucherët konsultues, praktika në biznes, panairë për gratë në biznes, çmime për plane të biznesit);
- 6) Krijimi dhe promovimi i një databaze për NVM-të si furnizues dhe nën-kontraktorë potencial;
- 7) Ofrimi i mbështetjes dhe rritja e bashkëpunimit me rrjetet e diasporës me qëllim të rritjes së investimeve dhe eksportit.

**b. Aktivitetet e planifikuara për 2019:**

- 1) Kryerja e studimit mbi potencialet e zhvillimit të sektorëve industrial dhe zingjirit të vlerës (një studim për sektorë); si dhe përgatitja e raportit vjetor për zhvillimin e industrisë;
- 2) Zbatimi i rekomandimeve nga Forumi për Zhvillimin e Politikave Industriale dhe përmirësimi i dialogut ndërmjet qeverisjes qendrore dhe lokale dhe akterëve të tjerë;
- 3) Promovimi dhe mbështetje e ndërmarrjeve në 4 parqet industriale, 2 parqe të biznesit, një zonë agro-industriale dhe një parku industrial.
- 4) Zbatimi i programeve mbështetëse për NVM-të dhe ndërmarrësit (certifikimi dhe vaucherët konsultues, praktika në biznes, panairë për gratë në biznes, çmime për plane të biznesit);
- 5) Ofrimi i mbështetjes dhe rritja e bashkëpunimit me rrjetet e diasporës me qëllim të rritjes së investimeve dhe eksportit.

**c. Aktivitetet e planifikuara për vitin 2020:**

- 1) Kryerja e studimit mbi potencialet e zhvillimit të sektorëve industrial dhe zingjirit të vlerës (një studim për sektorë); si dhe përgatitja e raportit vjetor për zhvillimin e industrisë;
- 2) Zbatimi i rekomandimeve nga Forumi për Zhvillimin e Politikave Industriale dhe përmirësimi i dialogut ndërmjet qeverisjes qendrore dhe lokale dhe akterëve të tjerë;
- 3) Promovimi dhe mbështetje e ndërmarrjeve në 4 parqet industriale, 2 parqe të biznesit, një zonë agro-industriale dhe një parku industrial.
- 4) Zbatimi i programeve mbështetëse për NVM-të dhe ndërmarrësit (certifikimi dhe vaucherët konsultues, praktika në biznes, panairë për gratë në biznes, çmime për plane të biznesit);
- 5) Ofrimi i mbështetjes dhe rritja e bashkëpunimit me rrjetet e diasporës me qëllim të rritjes së investimeve dhe eksportit.

**2. Ndikimi i pritur në konkurrueshmëri/arsyetimi i masës**

Zbatimi i kësaj masës do të ketë ndikim në identifikimin e lidhjeve të pazhvilluara brenda zingjirit të vlerës në sektorët me vlerë relativisht të lartë të shtuar. Gjithashtu, do të kontribuoj në

ndërkombëtarizimin e NVM-së dhe integrimin e zingjirëve të vlerës. Adresimi i disa barrierave të zhvillimit industrial dhe krijimi i mundësive të reja. Zhvillimi i politikave industriale do të ketë ndikim në përmirësimin e dialogut ndërmjet sektorit privat dhe publik në procesin e politikëbërjes dhe identifikimin e fushave të reja për përmirësimin e mjedisit biznesor. Identifikimi i nevojave për ngritjen e cilësisë së shërbimeve të shoqatave sektoriale për bizneset dhe identifikimi i nivelit të mundësive për përmirësim të efikasitetit të skemave që lehtësojnë qasjen në financa.

### **3. Kostoja e vlerësuar e aktiviteteve dhe ndikimi buxhetor**

Kostoja e vlerësuar për zbatimin e aktiviteteve për tri vitet e ardhshme është si në vijim: 2018 - 85,000.00 €; 2019 - 67,500.00 € and 2020 - 67,500.00 €.

### **4. Ndikimi i pritur në punësim dhe çështje gjinore**

Si rezultat i zbatimit të kësaj masë, gjatë tri viteve të ardhshme pritet të krijohen mundësi punësimi për rreth 450 persona. Duke qenë se në kuadër të kësaj mase janë planifikuar zbatimi i aktiviteteve që fokusohen gjithashtu në identifikimin e potencialit për zhvillimin e aktiviteteve me potencial relativisht të lartë për punësim të femrave.

### **5. Rreziqet e mundshme**

Disa nga rreziqet kryesore për zbatimin e kësaj masë janë: mungesa e kapitalit financiar të bizneseve për të kapitalizuar potencialin për zhvillim dhe integrim Brenda zingjirëve të vlerës; mungesa e gatishmërisë të të gjithë akterëve relevant për të vepruar në drejtim të njëjtë dhe në të njëjtën kohë drejt kapitalizimit të mundësive të reja për zhvillimin e grupimeve industriale në kuadër të zingjirit të vlerës.

## **Masa e reformës #7: Zhvillimi i produktit turistik në rajone turistike të Kosovës**

### **1. Përshkrimi i masës**

Qëllimi i kësaj mase është nxitja e zhvillimit të produkteve turistike me qëllim të rritjes së vlerës ekonomike të turizmit. Masa synon rritjen e ofertës turistike nëpërmjet identifikimit të produkteve turistike, nxitjes për zhvillimin e produkteve me qëllim të futjes në treg, bashkëpunimit me aktoreve relevant, përdorimit të standardeve turistike dhe përmirësim të infrastrukturës ligjore sipas praktikave evropiane. Masa është vazhdimësi nga PRE e vitit 2017 . Kjo masë ndërlidhet drejtpërdrejtë me Draft Strategjinë e Sektorit Privat 2017-2021 dhe indirekt ndërlidhet me SKZH.

#### **a) Aktivitetet e planifikuar për 2018:**

- 1) Miratimi i koncept dokumentit dhe hartimi i Ligjit mbi Turizmin,
- 2) Identifikimi i standardeve ndërkombëtare për përmirësimin cilësisë së shërbimeve në turizëm dhe hoteleri;
- 3) Hulumtim për produktet në Rajonin Turistik të Anamoravës, që përfshinë identifikimin e produkteve me përparësi zhvillimi dhe informimin e bizneseve për produktet turistike;
- 4) Nxitja e institucioneve dhe organizatave relevante për realizimin e vendosjes së sinjalizimit turistik sipas rregulloreve në fuqi.
- 5) Përkrahja e bizneseve në zhvillimin e turizmit rural edhe agro-turizëm ( në bashkëpunim me MBPZHR )

#### **b) Aktivitetet e planifikuara për 2019**

- 1) Hartimi dhe miratimi i udhëzimeve administrative që dalin nga ligji;

- 2) Vazhdon identifikimi i standardeve ndërkombëtare në turizëm dhe hoteleri dhe adaptimi i tyre;
- 3) Vlerësimi i potencialeve dhe inkurajimi i qasjeve grupore në regjione dhe zona të ndryshme;
- 4) Hulumentimi për zingjirët e vlerës nëpër elementet e turizmit;
- 5) Përkrahja e bizneseve në zhvillimin e turizmit rural edhe agro-turizëm ( në bashkëpunim me MBPZHR )

**c) Aktivitetet e planifikuara për 2020:**

- 1) Vazhdon hartimi i akteve tjera nënligjore që dalin nga ligji i ri i turizmit;
- 2) Organizimi i punëtorive me sektorin privat për inkurajimin në krijimin e kllasterëve, në bashkëpunim me nivelin lokal dhe universitetin;
- 3) Përkrahja në themelimin dhe zhvillimin e kllasterëve në turizëm;
- 4) Përkrahja e bizneseve në zhvillimin e turizmit rural edhe agro-turizëm ( në bashkëpunim me MBPZHR )

**3. Ndikimi i prituri në konkurrueshmëri/arsyetimi i masës**

Identifikimi dhe zhvillimi i produkteve turistike të reja do të ndikon në rritjen e numrit të bizneseve turistike, numrin e të punësuarve në bizneset turistike të cilët ofrojnë shitjen e këtyre produkteve, zgjerimin e ofertës turistike të Kosovës si destinacion, si dhe ngritjen e cilësisë në ofrimin e shërbimeve turistike. Si rrjedhojë e kësaj Kosova pritet të jetë më atraktive për vizitorët gjë që do të rezultojë në rritjen e gjenerimit të hyrave që ndikon direkt në ngritjen e BPV.

**4. Kostoja e vlerësuar e aktiviteteve dhe ndikimi buxhetor**

Ndikimi buxhetor i kësaj mase është rreth 82.000 Euro, ku 30.000 janë të planifikuara nga Buxheti i Kosovës, ndërsa 52.000 Euro nga donatorët. Gjatë vitit **2018** për implementim të aktiviteteve të propozuara nga Buxheti i Kosovës planifikohen 10.000 €, ndërsa nga donatorët 20.000 €. Në vitin **2019** planifikohen 10.000 € nga buxheti i Kosovës ndërsa nga donatorët 16.000. Në vitin **2020** planifikohen 10.000 € nga buxheti i Kosovës ndërsa nga donatorët 16.000€. Buxheti për përkrahjen e bizneseve në zhvillim të turizmit rural nga fondet e MBPZHR janë të parapara 100,000 Euro në baza vjetore.

**5. Ndikimi i pritshëm në punësim dhe çështjet gjinore:**

Rritja e kapaciteteve të turizmit ndikon direkt në rritjen e konsumit të shërbimeve turistike në këto pjesë dhe pjesëmarrje në zinxhirët e vlerave globale dhe rajonale duke ju ofruar ekonomive një mundësi për të shtuar më shumë vlerë në industrinë turistike lokale dhe si rezultat nxit punësimin dhe rritjen e mirëqenies. Zhvillimi i turizmit do të zgjerohet në zonat rurale dhe malore ku synohet rritja e punësimit në këto zona, rritja e bizneseve familjare ku femrat do të kenë mundësi të lehta të punësimit, sidomos në fushën e kulinarisë dhe atrizanteve. Deri në fund të vitit 2020 numri i të punësuarve në fushën e turizmit pritet të rritet rreth 30 %. Ndërsa pjesëmarrja e të punësuarve femra në fushën e turizmit synohet të arrihet deri në vitin 2020 rreth 20% .

**6. Rreziqet e mundshme**

Mungesa e kapaciteteve njerëzore institucionale në fushën e turizmit mund të jetë rrezik në zbatimin e plotë të kësaj mase. Duke qenë se shumë aktivitete ndërlidhen me komunat dhe institucionet tjera ndërlidhëse kjo mund të jetë rrezik nëse nuk shprehin gatishmëri për tu realizuar aktivitetet në tersi.

#### 4.3.4. MJEDISI BIZNESOR DHE ULJA E EKONOMISË JO-FORMALE

##### a. Analiza e pengesave kryesore

**Gjendja aktuale:** Kosova viteve të fundit ka shënuar progres në indikatorët që masin mjedisin e të bërit biznes si ata të Raportit të të Bërit Biznes të Bankës Botërore dhe në Aktin e Biznesit të Vogël të Komisionit Evropian. Raporti i të bërit biznes për vitin 2017 e ngrit Kosovën për katër pozita (nga vendi 64 në vendin e 60), progresi është në indikatorët: fillimi i biznesit, pagimi i tatimeve dhe tregtia përtej kufijve. Duhet të theksohet se krahas progresit në indikatorët e theksuar më lartë, Kosova nuk ka shënuar progres në disa indikatorë të tjerë të rëndësishëm, që përfshinë fuqizimin e kontratave, procedurat e falimentimit, qasja në energji elektrike, marrja e lejeve të ndërtimit dhe mbrojtja e investitorëve të vegjël. Padyshim që nga indikatorët e lartpërmendur Kosova shënoj progres më të madh në hapjen e biznesit duke u gjetur në pozitën e 13-të.

Si shembull, sipas të dhënave të paraqitura në Raportin e Bankës Botërore, fuqizimi i kontratave merr 330 ditë dhe kushton 34.4% të vlerës që përfshinë lënda. Megjithatë, është konsideruar se futja e sistemit të përmbartimit privat ka lehtësuar procesin e fuqizimit të kontratave (dhe njëkohësisht ndihmon në uljen e nivelit të kredive me problem). Një indikatorë tjetër me rëndësi ka të bëjë me procedurat e falimentimit, ku Kosova qëndron në pozitën e 163, dhe sipas të dhënave të raportit, procedurat e falimentimit marrin mesatarisht 2 vite kohë dhe kushtojnë 15% të aseteve të debitorit. Qasja në energji elektrike po ashtu mbetet pa progres, ku Kosova qëndron në pozitën 114, njëkohësisht trajtimi i lejeve të ndërtimit mbetet një indikatorë që është shënuar regres nga pozita 125 ka kaluar në 129.

Në anën tjetër, në shumicën e vendeve të Evropës Juglindore kreditimi për sektorin privat është duke u përmirësuar gradualisht, ndërkohë Kosova me krijimin e Fondi Kosovar për Garanci Kreditorë (FKGK) i cili lëshon garanci kreditorë portofoli për institucionet financiare për të mbuluar deri në 50% të rrezikut për kreditë e mikro-ndërmarrjeve, ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme (NMVM-të), ka lehtësuar barrën e NMVM-ve për të siguruar më shumë financim për rritjen e tyre. Me zvogëlimin e riskut të kredidhënies për NMVM-të, do të inkurajohen institucionet financiare partnere të FKGK-së për të dhënë kredi për më shumë NMVM, për të rritur shumat e kredive për NMVM-të, për të zgjeruar produktet dhe shërbimet e ofruara për NMVM-të, si dhe për të përmirësuar kushtet dhe afatet e atyre kredive. Informaliteti dhe mungesa e transparencës financiare lidhur me fitimet individuale dhe të ardhurat e biznesit, si dhe cilësia e ulët e raportimit financiar (posaçërisht sa i përket segmentit të NVMM-ve) ka rezultuar me një nivel të lartë të kreditimit të kolateralizuar, në vend të analizës së qarkullimit të parasë së gatshme nga bankat.

Ekonomia jo formale mbetet një problem i madh në Kosovë. Analizat e të dhënave nga firmat shfaqin se shkalla e firmave që janë prekur rëndë nga konkurrenca e firmave jo-formale është e lartë. Gjithashtu, niveli i ekonomisë jo-formale mbetet i lartë qoftë në mesin e vendeve me nivel të njëjtë të zhvillimit. Njëkohësisht krahasimi me vendet e rajonit tregon se ky nivel është më i larti në rajon. Vlerësohet se ekonomia joformale qëndron në 39% të BPV-së, duke krijuar konkurrencë të pandershme për bizneset formale, me 41% të kompanive që bëjnë thirrje se konkurrenca joformale paraqet një pengesë shumë të rëndë e të bërit biznes.

**Pengesat strukturore:** Pengesat dhe sfidat themelore janë konkurrenca jolojale; qasja e dobët në financa, veçanërisht për NVM-të; zbatimi i ngadaltë dhe jo konsistent i ligjit tek kontekstet ekonomike; kapaciteti i ulët prodhues dhe si rrjedhojë eksportues; problemet me furnizim stabil

të energjisë elektrike; inspektime të shpeshta, të pakoordinuara dhe të kushtueshme; koordinimi i dobët në mes të institucioneve publike dhe atyre private, veçanërisht institucioneve financiare, në mbledhjen dhe ndarjen e informatave financiare të ndërmarrjeve për të zvogëluar ekonominë joformale; mungesa e punëtorëve me kualifikim profesional.

Shumica e kompanive të vogla përdorin të ardhurat e tyre ose kapitalin e vet për të financuar investimet dhe tregjet e kapitalit përgjithësisht janë të nën-zhvilluara. Këto pengesa përfshijnë fuqizimin e kontratave, pamundësinë e realizimit të vlerës së kolateralit për shkak të mangësive në sistemin e të drejtave pronësore (sa i përket disponueshmërisë dhe besueshmërisë të dokumenteve) dhe mosekzistimin e një tregu sekondar dhe kostot e ndërlidhura me kreditë fillestare për shkak të shkallës së lartë të informalitetit dhe kostos së transaksionit. Praktikant konkurrenca në sektorin jo-formal janë theksuar si një prej pengesave kryesore nga firmat në Hulumtimin e Performancës së Mjedisit Biznesor dhe Ndërmarrjeve (BEEPS).

Të drejtat lidhur me llojet e pronave, duke përfshirë pronat shtetërore, publike dhe komunale si dhe të drejtat e qytetarëve të huaj për të zotëruar pronë në Kosovë, nuk janë qartë të definuar me ligj. Legjislacioni që përcakton të drejtat pronësore duhet të jetë i qasshëm, i saktë dhe i parashikueshëm në aplikimin e tij për të përmbushur standardet themelor të sigurisë ligjore dhe parandalimit të zbatimit arbitrar. Në veçanti, korniza ligjore për të drejtat pronësore në Kosovë akoma bazohet në konceptet e pronës shoqërore të mbetur nga korniza ligjore e të drejtave pronësore të Republikës Federale të Jugosllavisë.

**Ndikimi i pengesave në konkurrueshmëri:** Pengesat e lartcekura e ulin konkurrueshmërinë e ndërmarrjeve kosovare duke ndikuar negativisht në mundësitë dhe kapacitetet e NVM-ve për të siguruar financim për projektet e tyre investive, rritjen e eksportit dhe/ose zëvendësimin e importit, rritjen e punësimit, pamundësinë për të u përfshirë në zinxhirët e vlerave ndërkombëtare, konkurrueshmërisë së jo barabartë në treg, mosbesimin tek institucionet gjyqësore dhe aftësinë e tyre për të zgjidhur kontekstet ekonomike shpejtë, drejtë dhe në mënyrë konsistente. Njëkohësisht, ekonomia joformale ndëshkon ndërmarrjet duke ju pamundësuar tërheqjen e financave dhe partnerëve investiv e tregtar ndërkombëtar duke vazhduar gjithnjë në këtë mënyrë ciklin e financave të dobëta, menaxhimit të dobët, punësimit të ultë dhe, në fund, konkurrueshmërisë së ultë në krahasim me ndërmarrjet në shtetet në rajon, BE dhe në tregjet globale.

Konkurrenca e padrejtë nga ekonomia jo-formale redukton mundësitë për punësim formal dhe krijimin dhe zgjerimin e kompanive të vogla, dhe bizneseve individuale. Kjo kontribuon në punësim të lartë ose punësim të përkohshëm në sektorin joformal dhe mungesë të sigurisë së vendeve të punës. Fuqizimi i ngadalshëm dhe i paqëndrueshëm i kontratave minon besimin tek institucionet shtetërore dhe sigurinë ligjore të qytetarëve.

## **b. Masat e reformës**

### **Masa e reformës #8: Miratimi i politikave të bazuara në të dhëna dhe adresimi i ngarkesave administrative**

#### **1. Përshkrimi i masës**

Në vijim të reformave thelbësore për thjeshtësimin e legjislacionit dhe vendosjen e sistemit të vlerësimit të ndikimit rregullativ, kjo masë ka për qëllim përmirësimin e zhvillimit të politikave dhe legjislacionit të bazuar në të dhëna, dhe proces të mirëfilltë konsultimi. Në këtë drejtim do të fuqizohet sistemi aktual i koncept dokumenteve për përgatitjen propozimeve të politikave dhe legjislative, që eventualisht do të zëvendësohet me një sistem të vlerësimit të ndikimit. ( Udhëzuesi i përditësuar për hartimin e Koncept Dokumenteve është para finalizimit, raundi i

parë i konsultimeve ka përfunduar dhe deri në fund të viti pritet të përfundojë komplet procesi. Në udhëzuesin dhe manualin e ndryshuar janë përfshirë mjetet si Modeli i Kostimit Standard, Testi i konkurrueshmërisë, Testi NVM-ve etj.) Përveç kësaj do të analizohet mundësia për vendosjen e një programi për adresimin e ngarkesave administrative kundrejt një targeti prej 25%. (Hartimi i Koncept dokumentit për analizimin e gjendjes ekzistues dhe hartimin e programit për adresimin e barrës administrative është iniciuar tashmë dhe Qeveria ka miratuar vendimin për themelimin e Grupit Punues). Kjo masë përfshinë edhe thjeshtësimin e licencave dhe lejeve dhe është në harmoni me SKZH dhe Strategjinë e ndryshuar për Rregullim të Mirë 2017-2021.

**a. Aktivitetet për vitin 2018:**

- 1) Hartimi i Koncept Dokumentit për ngarkesat administrative, duke përfshirë edhe përcaktimin e caqeve përkatëse
- 2) Krijimi i njësisë për Rregullim më të Mirë.
- 3) Trajnimi i shërbyesve civil për aplikimin e udhëzimeve dhe mjeteve analitike për vlerësimin ex-ante të politikave dhe për procesin e konsultimeve.
- 4) Trajnimi i trajnerëve në zhvillimin e dokumenteve të politikave sipas udhëzuesve të rinj duke përfshirë ToT për mjetet e reja si Modeli Standard i Kostimit;
- 5) Realizimin e tri vlerësimeve legjislative;
- 6) Finalizimi i kornizës së bazës së të dhënave për vlerësimin e ndikimit më të dhëna për përmirësimin e mëtutjeshëm të vendimmarrjes së bazuar në dëshmi.

**b. Aktivitetet për vitin 2019:**

- 1) Miratimi i Koncept dokumentit për ngarkesat administrative, duke përfshirë edhe përcaktimin e caqeve përkatëse.
- 2) Inicimi i Programit për me uljen e ngarkesës administrative që si synim ka thjeshtësimin, bashkimin apo eliminimin e së paku 10% të licencave dhe lejeve ekzistuese.
- 3) Vazhdimi me trajnimin e mëtejshëm të stafit lidhur me aplikimin e udhëzimeve dhe mjeteve analitike për vlerësimin ex-ante të politikave;
- 4) Kryerja e shtatë vlerësime legjislative.

**c. Aktivitetet për vitin 2020**

- 1) Zbatimi i Programit për uljen e ngarkesës administrative sipas caqeve të përcaktuara.
- 2) Trajnimi i mëtejshëm i stafit lidhur me aplikimin e udhëzimeve dhe mjeteve analitike për vlerësimin ex-ante të politikave;
- 3) Arritjen e caktuar për thjeshtësimin, bashkimin apo eliminimin e së paku 10% të licencave dhe lejeve.

**2. Ndikimi i pritur në konkurrueshmëri/arsyetimi i masës**

Cilësia e politikave dhe legjislacionit do të përmirësohet dhe do të largohen pengesat e panevojshme. Vendosja e modelit standard të kostimit do të nxisë të kuptuarit e ndikimeve të legjislacionit tek bizneset dhe qytetarët. Testi i NVM-ve do të sensibilizoj politikë-bërësit dhe vendimmarrësit për nevojat e veçanta të bizneseve, dhe në kuadër të kësaj posaçërisht mikro ndërmarrjet, që janë dominante në strukturën ekonomike të Kosovës. Testi i konkurrueshmërisë rregullative do të kontribuojë në një mjedis biznesor më konkurrues dhe profil të përmirësuar të



biznesit dhe rregullativës në Kosovë krahasuar me vendet tjera në rajon. Veç kësaj, së paku 10% e licencave dhe lejeve do të thjeshtësohen, bashkohen apo eliminohen deri në 2020..

### **3. Kostoja e vlerësuar e aktiviteteve dhe ndikimi buxhetor**

Për zbatimin e aktiviteteve të masës, janë planifikuar nga €290,000 për secilin vit 2018-2020, përmes përkrahjes së drejtpërdrejt buxhetore dhe 100.000 euro janë planifikuar për ekspertizë secilin vit. Këto fonde janë të siguruar nga projekti i SIDA-së, përmes ndihmës direkte buxhetore dhe ekspertizës.

### **4. Ndikimi i pritur në punësim dhe çështje gjinore**

Përmirësimi i mjedisit biznesor do të kontribuoj në rritje ekonomike duke inkurajuar bizneset fillestare dhe formalizimin e aktiviteteve biznesore. Gjithashtu, futja mjeteve shitesë për analizimin e politikave të fokusuar në rritjen e konkurrueshmërisë shoqërohet me integrimin e vlerësimit të ndikimit gjinor në procesin e zhvillimit të politikave. Kjo do të kontribuon në një kornizë të politikave dhe rregullative që është e orientuar në politika gjinore dhe në pajtueshmëri me agjendën e Kosovës për barazi gjinore.

### **5. Rreziqet potenciale**

Rreziku kryesor është mungesa e alokimit buxhetor për zhvillimin e bazës së të dhënave për vlerësimin e ndikimit. Është e paqartë se çfarë implikime buxhetore do të ketë baza e të dhënave. Kjo çështje do të monitorohet në kuadër të Strategjisë për Rregullim të Mirë 2017-2021 dhe Qeveria do të ndërmerr veprime përkatëse për vendime specifike lidhur me këtë.

## **Masa #9: Sigurimi i të drejtave pronësore duke adresuar informalitetin në sektorin e pronës së paluajtshme**

### **1. Përshkrimi i masës**

Pas reformave të prezantuara në ERP 2016-2018, kjo masë është vazhdim i veprimeve nën këtë për sigurimin e titujve të të drejtave pronësore. Grupi i parë i veprimeve fokusohet në përmirësimin e kornizës aktuale ligjore, sepse legjislacioni aktual i mban konceptet ligjore nga Republika Socialiste Federative të Jugosllavisë të cilat e pengojnë zhvillimin e një tregu të gjallë në mbështetje të rritjes ekonomike.

- Kosova e ka iniciuar hartimin e legjislacionit për t'i konvertuar të drejtat e pronësisë shoqërore mbi tokën urbane për ndërtim dhe qiranë 99-vjeçare në të drejta të pronësisë, me një tarifë të thjeshtë.
- Kosova gjithashtu e ka iniciuar hartimin e legjislacionit për t'i përcaktuar dhe rregulluar të drejtat për pronën jo-private, përfshirë atë shtetërore, publike dhe komunale, si dhe të drejtat e shtetasve të huaj për të blerë dhe për të pasur pronë në pronësi në Kosovë.

Grupi i dytë i veprimeve fokusohet në adresimin e informalitetit në sektorin e tokës, sepse prona në një kontekst ekstralegal është një kapital i vdekur që nuk mund të transaksionohet në tregun e pronës. Informaliteti, sipas Strategjisë Kombëtare të Kosovës për të Drejtat Pronësore, “ndodh kur të drejtat formale në pronë (të drejtat e regjistruara në kadastër) nuk transferohen nga mbajtësi i të drejtave formale përmes veprimit të ligjit. Të drejtat e transferuara në mënyrë joformale ushtrohen *de facto* nga mbajtësi i të drejtave informale dhe përgjithësisht respektohen nga komuniteti, por nuk mund të regjistrohen në kadastër. Si rezultat, të drejtat mbeten të regjistruara në kadastër në emër të bartësit të të drejtave formale që tashmë i ka transferuar të drejtat, e jo nga personi që aktualisht i ushtron të drejtat mbi pronën”.

Mospërputhja që rezultojnë midis të dhënave kadastrale të Kosovës dhe pronësisë joformale të pronës së paluajtshme i kontribuon pasigurisë në mbajtje. Kjo ndërhyrje strategjike synon që t'i përditësojë regjistrat e titujve kadastral të Kosovës duke i adresuar dy burimet kryesore të informalitetit: (1) lëndët e vonuara të trashëgimisë dhe (2) kontratat verbale.

Deri më sot, shumica e veprimeve për t'i adresuar dy burimet kryesore të informalitetit po zbatohen në kohë; megjithatë, masat specifike kërkojnë vëmendje të vazhdueshme nga vendimmarrësit e lartë.

- Për t'i trajtuar lëndët e vonuara të trashëgimisë (1), “Pakoja e trashëgimisë” - ndryshimi i Ligjit për trashëgiminë, ndryshimi i Ligjit për procedurën jokontestimore dhe Ligji i ri për noterinë - e kaloi leximin e parë në Kuvendin e Kosovës.
- Për t'i adresuar kontratat verbale (2), Zyra e Kryeministrit është në procesin e detajimit të politikës më efektive. ZKM-ja duhet ta nisë hartimin e Koncept Dokumentit i cili do ta identifikonte procedurën më efektive ligjore për njohjen dhe regjistrimin e transaksioneve të bëra gojarisht.
- Trajtimi i të dyja burimeve të informalitetit gjithashtu kërkon harmonizimin e procedurave të regjistrimit kadastral. Ministria e Mjedisit dhe e Planifikimit Hapësinor duhet ta përmirësojë procesin e finalizimit të amendamenteve të Ligjit për Kadastër.

Me zbatimin e kësaj mase, korniza legjislativë do t'i plotësonte kërkesat e ekonomisë së tregut të lirë. Përveç kësaj, vendosja e procedurave administrative efikase dhe me kosto të ulët për njohjen ligjore të të drejtave informale do t'i nxiste qytetarët që t'i siguronin titujt e tyre të së drejtës pronësore.

#### **a. Aktivitetet e planifikuara në vitin 2018**

*Sigurimi i të drejtave në pronë duke e forcuar kornizën ligjore*

- 1) Finalizimi dhe miratimi i Koncept dokumentit për ndryshimin e Ligjit për Pronësinë dhe të Drejtat tjera Sendore (MD);
- 2) Finalizimi dhe miratimi i Koncept dokumentit për Ligjin e ri për Pronën Publike (MD);
- 3) Finalizimi dhe miratimi i Koncept dokumentit për Ligjin e ri për Transformimin e të Drejtave të Përdorimit të Pronës së Paluajtshme Shoqërore (MD);
- 4) Finalizimi dhe miratimi i Projektligjit për tokën urbane ndërtimore (MD/MMPH).

*Sigurimi i të drejtave në pronë, duke e adresuar informalitetin në sektorin e pronës së paluajtshme*

- 5) Miratimi i “Pakos së Trashëgimisë” – Ligji për Trashëgiminë, Ligji për Procedurën Jokontestimore, Ligji për Noterinë (Kuvendi);
- 6) Hartimi dhe miratimi i Koncept dokumentit për ndryshimin e Ligjit për Procedurën Kontestimore (MD);
- 7) Hartimi dhe miratimi i Koncept dokumentit për procedurën më efektive ligjore për njohjen dhe regjistrimin e shitjeve të bëra përmes kontratave verbale (ZKM).

*Sigurimi i të drejtave në pronë duke e nxitur regjistrimin e titujve për të drejtën pronësore*

- 8) Finalizimi dhe miratimi i ndryshimeve të Ligjit për Kadastrën, duke nxitur regjistrimin e të drejtave pronësore në kadastër duke i thjeshtuar procedurat e regjistrimit dhe duke i hequr pengesat (MMPH);

- 9) Shfuqizimi i të gjitha tarifave komunale për transferimin e pronësisë që janë në kundërshtim me UA 08/2014 për tarifën për shërbimet e regjistrimit të pasurisë së paluajtshme (MMPH/AKK);
- 10) Organizimi i fushatave vetëdijesuese lidhur me rëndësinë e formalizimit dhe regjistrimit të të drejtave pronësore në regjistrin kadastral (ZKM, MD, MMPH).

#### **b. Aktivitetet e planifikuara në vitin 2019**

*Sigurimi i të drejtave në pronë duke e forcuar kornizën ligjore*

- 1) Miratimi i ndryshimeve të Ligjit për Pronësinë dhe të Drejtat tjera Sendore (MD);
- 2) Miratimi i Ligjit të ri për Pronën Publike (MD);
- 3) Miratimi i Ligjit të ri për Transformimin e të Drejtave të Përdorimit të Pronës së Paluajtshme Shoqërore;
- 4) Miratimi i Ligjit të ri për tokën urbane ndërtimore.

*Sigurimi i të drejtave në pronë, duke e adresuar informalitetin në sektorin e pronës së paluajtshme*

- 5) Zbatimi i “Pakos së trashëgimisë”, hartimi i akteve të nevojshme nënligjore dhe ndërtimi i Portalit Informativ për të Drejtat Pronësore për njoftimin efektiv të palëve që e kanë ndjekur procesin e duhur, siç përcaktohet me ligj (MD);
- 6) Finalizimi dhe miratimi i ndryshimeve të Ligjit për Procedurën Kontestimore (MD);
- 7) Ndryshimi i trupit të ligjeve për t’i lëshuar udhë procedurës më efektive ligjore për njohjen dhe regjistrimin e shitjeve të bëra përmes kontratave verbale (ZKM/MD);

*Sigurimi i të drejtave në pronë duke e nxitur regjistrimin e titujve për të drejtën pronësore*

- 8) Zbatimi i procedurave të thjeshtuara pas miratimit të Ligjit për Kadastrën (MMPH)
- 9) Organizimi i fushatave vetëdijesuese lidhur me rëndësinë e formalizimit dhe regjistrimit të të drejtave pronësore në regjistrin kadastral (ZKM, MD, MMPH)

#### **c. Aktivitetet e planifikuara në vitin 2020**

*Sigurimi i të drejtave në pronë duke e forcuar kornizën ligjore*

- 1) Zbatimi i Ligjit për pronësinë dhe të drejtat tjera sendore dhe përditësimi i kadastrës në përputhje me rrethanat (MD);
- 2) Zbatimi i Ligjit për Pronën Publike dhe përditësimi i kadastrës në përputhje me rrethanat (MD);
- 3) Zbatimi i Ligjit të ri për Transformimin e të Drejtave të Përdorimit të Pronës së Paluajtshme Shoqërore dhe përditësimi i kadastrës në përputhje me rrethanat (MD/AKK);
- 4) Zbatimi i Ligjit për Tokën urbane ndërtimore dhe përditësimi i kadastrës në përputhje me rrethanat (MD/AKK).

*Sigurimi i të drejtave në pronë, duke e adresuar informalitetin në sektorin e pronës së paluajtshme*

- 5) Monitorimi i zbatimit të “Pakos së trashëgimisë”, duke u fokusuar në praktikën noteriale në procesin e zbatimit (MD);
- 6) Miratimi i ndryshimeve të Ligjit për Procedurën Kontestimore që e mundëson procedurën e harmonizuar për njohjen dhe regjistrimin e shitjeve të bëra përmes kontratave verbale (MD);

- 7) Me kornizën ligjore në fuqi, e cila ia hap rrugën procedurës më efektive ligjore për njohjen dhe regjistrimin e shitjeve të bëra përmes kontratave verbale, institucioni përgjegjës i caktuar me ligj e zbaton ligjin (të përcaktohet)

*Sigurimi i të drejtave në pronë duke e nxitur regjistrimin e titujve për të drejtën pronësore*

- 8) Vazhdimi i zbatimit të procedurave të thjeshtuara pas miratimit të Ligjit për Kadastrën nëpër të gjitha komunat e Kosovës (MMPH)
- 9) Organizimi i fushatave vetëdijesuese lidhur me rëndësinë e formalizimit dhe regjistrimit të të drejtave pronësore në regjistrin kadastral (ZKM, MD, MMPH).

## **2. Ndikimi i pritshëm në konkurrueshmëri/arsyetimi i masës**

Të drejtat e sigurta pronësore janë në qendër të kërkesave thelbësore për një ekonomi të gjallë të tregut. Kjo masë ndikon në intensitetin dhe lojalitetin në konkurrencë. Dispozitat e qarta ligjore i nxisin investimet e huaja dhe lokale. Të dhënat e përditësuara dhe lehtësisht të qasshme kadastrale e mbështesin zhvillimin e tregjeve dinamike të tokës, duke i bërë të disponueshme informatat ligjore dhe ekonomike për investorët e huaj. Të drejtat e sigurta në pronë, të regjistruara në kadastrë, gjithashtu e zbllokojnë qasjen në mundësi të financimit për qytetarët të cilët nuk ishin në gjendje që ta shfrytëzonin kapitalin e tyre ekstralegal. Vendosja e një procedure efektive ligjore për ta trajtuar informalitetin në shkallë të gjerë do të kontribuonte edhe në uljen e numrit të lëndëve të pazgjdhura nëpër gjykata, duke kontribuar në përmbushjen e kërkesave të *acquis* në fushën e gjyqësorit dhe të drejtave themelore.

## **3. Kostoja e parashikuar e aktiviteteve dhe ndikimi mbi buxhet**

Kostoja totale për zbatimin e kësaj mase është 2,661,800 €, ku 84,500 Euro mbulohen nga Buxheti i Kosovës, dhe 2,577,300 Euro nga pjesëmarrja e partnerëve të zhvillimit (USAID dhe KE). Zbërthimi sipas viteve sipas planifikimit është 1,245,850 Euro për vitin 2017 dhe 1,415,950 Euro për vitin 2018. Ky vlerësim bazohet në koston e miratuar nga Qeveria e Kosovës për zbatimin e Objektivit të Dytë të Strategjisë Kombëtare për të Drejtat Pronësore.

## **4. Ndikimi i pritshëm në punësim dhe në çështjet gjinore**

Pasiguria e të drejtave pronësore pengon rritjen ekonomike, i prekë të drejtat e njeriut dhe e dobëson situatën e komuniteteve të marginalizuara. Informaliteti i gjerë në sektorin e pronës e bën edhe më të vështirë për gratë dhe vajzat që t'i gëzojnë të drejta të barabarta pronësore dhe e dëmton pavarësinë e tyre ekonomike.

## **5. Rreziqet potenciale**

Zbatimi efektiv i Masës kërkon vëmendje të qëndrueshme dhe të vazhdueshme të politikanëve të lartë. Ciklet e shkurtra zgjedhore të Kosovës mund ta ngadalësojnë procesin e zbatimit. Duke pasur parasysh shkallën e çështjes në fjalë, Qeveria duhet të demonstrojë vullnet politik duke ndarë buxhet shtesë, nëse është e nevojshme në të ardhmen.

## **Masa e reformës #10: Rritja e efikasitetit në gjyqësor në zgjidhjen e rasteve**

### **1. Përshkrimi i masës:**

Kjo masë synon të përmirësoj efikasitetin e gjyqësorit në trajtimin e kontesteve ekonomike duke reduktuar numrin e rasteve të grumbulluara përmes zbatimit të sistemit të menaxhimit të rasteve SMIL. Pasi projekti i SMIL është projekt disa vjeçare, përfitimet konkrete nga përdorimi i SMIL do të mund të vërehen një periudhë kohore afat mesme. Pasi aktualisht projekti është ende në fazën e zhvillimit të tij.

KGJK është në fazën e zhvillimit të sistemit të SMIL, e cila do të zgjasë edhe gjatë vitit 2018, ndërsa vetëm nga fillimi i vitit 2019 sistemi do të mund të vihet në zbatim në mënyrë të duhur. Efektet konkrete të përdorimit të sistemit nuk mund të vërehen menjëherë, por këto efekte do të mund të vërehen pas një periudhe kohore të përdorimit të sistemit, e cila mund të jetë një deri në dy vjeçare.

Pas vënies në zbatim të SMIL (Sistemit për Menaxhimin Informativ të Lëndëve) në gjykata për trajtimin e kontesteve ekonomike, përdorimi i sistemit do të ketë ndikim të madh pozitivë në krijimin e një mjedisi të sigurt për investime në të ardhmen dhe veprimtarinë e bizneseve. Aspektet e ndikimit të zbatimit të SMIL-it në zhvillimin e një mjedisi të shëndosh ekonomik dhe konkurrencë të lirë do të arrihen duke:

- Duke trajtuar me kohë dhe duke shkurtuar kohë zgjatjen e zgjidhjes së kontesteve ekonomike në mes bizneseve.
- Reduktuar numrin e lëndëve të vjetra të pazgjidhura ekonomike.
- Përmes funksioneve si; numri unik i lëndës, shpërndarja automatike e lëndëve, evidentimi veprimeve të ndërmarra, sistemi i njoftimit dhe monitorimit të procesit të rrjedhës së lëndës përmes SMIL, siguron transparencën dhe llogaridhënien në zgjidhjen e lëndëve ekonomike.
- Ofron informata dhe raporte statistikore të sakta për lëndët ekonomike në proces, vendimet, gjyqësore, masat e marra dhe veprimtaritë e papërgjegjshme të bizneseve.

Deri më tani janë arritur rezultate të konsiderueshme në zbatimin e projektit të SMIL. Është përgatitur dhe vënë në funksion qendra e re e te dhënave, si dhe është zhvilluar dhe pilotuar në gjykatën pilote Sistemi Elektronik i Menaxhimit të Lëndëve SMIL. Deri në fund të vitit 2017 SMIL për lëmine penale do të jetë gati, dhe me këtë rast do të ketë funksione të reja si; numri unik i lëndës, shpërndarja automatike e lëndëve si dhe raportet të dizajnuara me indikatorë të rinj sipas rekomandimeve të CEPEJ. Këto funksione do të ndikojnë në rritjen e efikasitetit, transparencës si dhe monitorimit të punës së gjykatave. Gjatë vitit 2018, do të zhvillohet SMIL për lëndët kontestimore, ekonomike, lëndët administrative, shërbimet administrative të gjykatave dhe jo kontestimore. Procesi i trajnimit dhe vënies në zbatim të SMIL do të filloj gjatë vitit 2018 dhe të vazhdoj të zgjerohet në të gjitha gjykata dhe të gjitha lëmit vetëm gjatë vitit 2019.

Fokusi në përmirësimin e efikasitetit të gjyqësorit duhet të jetë në zvogëlimin e numrit të lëndëve për kundërvajtje përmes stimulimeve dhe marrëveshjeve të shpejta në gjykatë, rritje të përkohshme në punësimin e fuqisë punëtore shtesë për të zgjidhur rastet, përfshirë këtu forcimin e kapaciteteve të Departamentit Administrativ përkatësisht Divizioni Fiskal të Gjykatës Themelore Prishtinë, përfshirë fushat e tatimeve dhe doganave, me qëllim të zvogëlimit të rasteve të grumbulluara. Kjo masë është vazhdimësi e PRE 2016-2018 dhe bazohet në SKZH dhe ERA.

#### **a) Aktivitetet e planifikuara për vitin 2018**

- 1) Rekrutimi 42 bashkëpunëtorëve profesional për të trajtuar rastet e grumbulluara në fushën civile dhe penale me qëllim të arritjes së caktuar prej 30% deri në fund të vitit 2018;
- 2) Kryerja e analizës për rritjen e numrit të gjyqtarëve dhe bashkëpunëtorëve profesional në kuadër të Divizionit Fiskal; Është finalizuar draft analiza për numrin e nevojshëm të gjyqtarëve në Divizionin Fiskal, pra sipas peshimit të lendeve, që pritet miratimi nga anëtarët e Këshillit Gjyqësor, dhe zbatimi.
- 3) Përfundimi i fazës së parë të zhvillimit të Sistemit për Menaxhimin e Rasteve

- 4) Organizimi dhe mbajtja e trajnimeve me qellim të vënies në zbatim të sistemit në gjykata.
- 5) Zgjerimi i funksionimit të SMIL në pesë regjionet përkatëse sipas planit.

#### **b) Aktivitetet e planifikuara për vitin 2019**

- 1) Zbatimi i synimit prej 20-30% të reduktimit të rasteve të vjetra; Do të behet monitorimi i lendeve të pazgjdhura në periudha tremujore dhe do të raportohet se a është në rritje apo zvogëlim numri i lendeve të vjetra. Duke pasur parasysh se lëndë e vjetër konsiderohet çdo lëndë që është pranuar në gjykatë dhe është me e vjetër se 24 muaj, kjo na obligon që ky proces të jetë i vazhdueshëm dhe ti njoftojmë gjykatat se sa është duke u zvogëluar-rritur numri i lende të vjetra, për arsye që të ndërmarrin masa.
- 2) Rekrutimi i gjyqtarëve sipas vlerësimit të nevojave, reduktimin e lëndëve në divizionin fiskal; Do të behet matja e kohëzgjatjes së procedurës në periudha të caktuara sipas formulës së CEPEJ-it, dhe do të bëhet plotësimi i gjyqtarëve sipas nevojës.
- 3) Vazhdimi i trajnimeve dhe përkrahjes për përdorues të sistemit të SMIL për vënien në zbatim të SMIL-it. Vetëm gjatë vitit 2019 do të mund të gjenerohen pasqyra dhe statistika për përdorimin e SMIL dhe lëndëve që procedohen përmes SMIL.

#### **c) Aktivitetet planifikuara për vitin 2020**

- 1) Për të arritur cakun e 0% të lëndëve të vjetra deri në vitin 2021, do të vazhdohen në rritjen e numrit të mëtutjeshëm të gjyqtarëve në Divizionin Fiskal të Gjykatës Themelore Prishtinë në përputhje me vlerësimin.
- 2) Gjatë vitit 2020, pritet që projekti të jetë zgjeruar në të gjitha gjykatat dhe që të gjithë përdoruesit e SMIL të jenë të trajnuar deri në atë kohë dhe që sistemi të ketë filluar të përdoret për procedimin e të gjitha lëndëve përmes SMIL.

### **2. Ndikimi i pritur në konkurrueshmëri/arsyetimi i masës**

Ndikimi i reformave në efikasitetin gjyqësor është i tërthortë në rritjen ekonomike, konkurrues mërinë, ndikim në IHD. Kursimet kohore nga zvogëlimi i kohës dhe kostos së vendosjes së rasteve janë të mëdha. Përveç qasjes së shpejtë në drejtësi dhe, tani e tutje, përmirësimin e sundimit të ligjit, që mund të tërheqë investime të reja, ndikimet e drejtpërdrejta në zvogëlimin e kohës së vendosjes është vlerë për ata që kërkojnë drejtësi në gjykata. Për të përcaktuar vlerën monetare të kursimeve kohore, janë analizuar çmimet e larta të arbitrazhit. Vlera e një dite të kursyer është 8.1 € përcaktuar si kostoja margjinale e gjykimeve/arbitrazhit pjesëtuar me kursimet kohore margjinale. Duke përdorur këtë parametër, vendosja e shpejtë për një rast kursen 2.5 mijë euro dhe kur e shumëzojmë këtë me numrin e përgjithshëm të rasteve të ardhura, vlera e përgjithshme e kursyer për shoqërinë është 140 milionë euro.

### **3. Kostoja e vlerësuar e aktiviteteve dhe ndikimi buxhetor**

Aktiviteti për synimin e zero lëndëve të vjetruara do të ketë ndikim buxhetor në shumën rreth 700,000 Euro për dy (2) vitet e ardhshme. Kjo ndërlidhet me pagesën e pagave për 50 këshilltarë profesional të gjyqtarëve me një pagë mujore prej 550€ (550 x 5% (kontributi pensional) + 80 (shitesa)=635.00 € (paga bruto) 635x50x24=762,000 € (Kostojo e bruto pagave per 24 muaj) për të mbështetur vendosjen për 90 mijë raste të mbetura civile dhe penale brenda 2 viteve. Për më tepër gjatë vitit 2018 dhe 2019, ndikimi neto i drejtpërdrejt në buxhet do të jetë 350,000€ Euro ku 330,000€ kanë ndikim të drejtpërdrejtë në të ardhurat buxhetore (paga) dhe 20,000 kanë ndikim në shpenzimet buxhetor (shpenzime opsionale). Kostoja për kapacitetet në Divizioni Fiskal do të mund të bëhet pas përfundimit të vlerësimit të nevojave, që pritet të përfundohet në tremujorin e parë të vitit 2018. Kostoja për SMIL për periudhën Janar 2014 – Qershor 2018 është

6,700,000. Nga buxheti i Kosovës/KGJK për vitet 2018, 2019 dhe 2020 pritet të sigurojë mjete në shumë 200,000 EURO. Këto mjete do të jenë të dedikuara për blerjen e pajisjeve të TI për gjykata.

#### **4. Ndikimi i pritur në punësim dhe çështje gjinore**

Edhe pse masa është fokusuar në konteste ligjore ekonomike, me zbatimin e saj në këtë fushë, opsionet për reduktimin e lëndëve të grumbulluara dhe futja e SMIL mund të zgjerohet në fusha të tjera sistemit gjyqësor. Reduktimi i kohës së zgjidhjes së lëndëve dhe rritja e efikasitetit të gjykatave dhe sigurisë ligjore do të jetë dobishme për secilin që kërkon drejtësi në gjykata.

#### **5. Rreziqet e mundshme**

Rreziqet kryesore ndërlidhen me vullnetin e akterëve të ndryshëm brenda sistemit gjyqësor dhe pritet për zbatimin e reformave.

### **Masa #11: Reforma e përgjithshme e inspektimeve**

#### **1. Përshkrimi i masës**

Qëllimi i kësaj masë është ndërmarrja e reformave të përgjithshme të sistemit të inspektimeve me qëllim të përmirësimit të efikasitetit dhe koordinimit të sistemit të inspektimeve shtetërore. Në kuadër të kësaj planifikohet të ndërmerret një reformë e përgjithshme e inspektimeve, kjo reformë kërkon amandamentim të kornizës legjislative duke e amandamentuar legjislacionin, modifikuar kornizën e organizimit funksional dhe ngritje të kapaciteteve të personelit. Kjo masë është në përputhje me Strategjinë Kombëtare për Zhvillim 2016-2021.

##### **a. Aktivitetet e planifikuara për 2018**

- 1) Miratimi i një ligji të harmonizuar lidhur me inspektimet i cili do të vendos themelet e një qasje të inspektimit të bazuar në rrezik.
- 2) Vlerësimi i të gjitha inspektimeve që bëhen sot, i pasuar me eliminimin e aktiviteteve të panevojshme ose shkrirjen e aktiviteteve inspektuese aty ku ka hapësirë.

##### **b. Aktivitetet e planifikuara për 2019**

- 1) Krijimi i një mekanizmi koordinues mes trupave inspektues në mënyrë që të sigurohet koordinimi më i mirë i procedurave inspektuese dhe një sistem më efektiv i mbikëqyrjes, duke e përfshirë këtu krijimin e një sistemi informativ për shkëmbimin e informatave ndërmjet inspektorateve.
- 2) Amandamentimi i legjislacionit horizontal duke lejuar dhe rregulluar reformën e inspektimeve
- 3) Miratimi i strukturës organizative që zbaton konceptin e ri organizativ të inspektimeve

##### **c. Aktivitetet e planifikuara për 2020**

- 1) Ngritje e kapaciteteve njerëzore, që nënkupton trajnimin e inspektorëve dhe zyrtarëve tjerë relevant duke i përgatitë për zbatimin e plot të konceptit të ri të inspektimeve.

#### **2. Ndikimi i pritur në konkurrueshmëri /arsyetimi i masës**

Krijimi i sistemit të unifikuar i cili siguron, koordinim ndërinstitucional të qëndrueshëm, mbikëqyrje efikase dhe transparencë të plotë gjatë ushtrimit të mbikëqyrjes dhe llogaridhënies me rastin e zbatimit të kompetencave dhe përgjegjësiive ligjore nga ana e autoriteteve



inspektuese. Ky mision pritet të përmirësoj konkurrueshmërinë duke lehtësuar ambientin e të bërit biznes duke e zvogëluar barrën mbikëqyrëse për bizneset, një kontroll më efektive zvogëlon informalitetin duke e favorizuar biznesin dhe prodhimin cilësor dhe të rregulluar.

### **3. Kostoja e vlerësuar e aktiviteteve dhe ndikimi buxhetor**

Kostoja e përafërt e zbatimit është 4,567,700 EUR, kjo kosto është marr nga udhëzuesi i zbatimit të Strategjisë Kombëtare për Zhvillim.

### **4. Ndikimi i pritur në punësim dhe çështje gjinore**

Masa e propozuar nuk ka ndikim të drejtpërdrejt në punësim, mirëpo e përmirëson efektivitetin administrativ sa i përket inspektimeve dhe zvogëlon barrierën e kontrollit që ushtrohet ndaj bizneseve.

### **5. Rreziqet potenciale**

Reforma parasheh amandamentimin e një numri të madh të akteve juridike kjo kërkon kohë dhe ndryshimet eventuale në legjislativ mund ta ngadalësojnë procesin, ndryshimet parashohin po ashtu kosto buxhetore kështu që mund të kemi vështirësi t'i sigurojmë mjetet. Gjithashtu ndryshimi në strukturë kërkon kapacitete administrative për të qenë në gjendje të i zbatojnë konceptet e reja, mund të hasim në mungesë të këtyre kapaciteteve dhe vullnetit po ashtu.

## **4.3.5. HULUMTIMI DHE ZHVILLIMI, INOVACIONI (RDI) DHE EKONOMIA DIGJITALE**

### **a. Analiza e pengesave kryesore**

**Gjendja aktuale:** Bazuar në të dhënat në dispozicion, Kosova shpenzon 0,01% të PBB-së në hulumtim dhe inovacion (4.7 mil. në vit nga buxheti i shtetit dhe burimet tjera për shkencë dhe hulumtim). Ndërsa në Ligjin për Veprimtari Kërkimore Shkencore 04/L 135, Qeveria e Kosovës duhet të alokojë 0.7% apo 11 milionë Euro të buxhetit vjetor, por për shkak të mungesës së mjeteve buxhetore për këtë kategori brenda një viti kemi një shumë prej 510000 Euro në DSHT, për të gjitha programet që mbulon DSHT. Sipas të dhënave të DSHT (MASHT), numri i të punësuarve në R&D është 833,3 punësuar në një milion banorë; kemi 32 patenta të miratuar nga zyra e patentave në MTI më 2016, ndërsa nuk kemi asnjë të miratuar nga zyrat evropiane të patentave. E vetmja infrastrukturë shkencore e vendit janë laboratorët e institucioneve kërkimore shkencore. Universitetet nuk kanë infrastrukturë të përshtatshme për krijimin e inkubatorëve, start-ups, etj. STIKK ka ndihmuar me vendosjen e 30 ndërmarrjeve të vogla (start-ups) në fushën e IT, por ato nuk mund të konsiderohen si veprimtari që kanë të bëjnë me hulumtime. MASHT ofron grante për institucione hulumtuese shkencore të cilat kushtëzohen nga elementi i inovacionit. Me projekt-Ligjin për Inovacion dhe TDT, janë përcaktuar shumë qartë të gjitha elementet e përbashkëta mes institucioneve që kanë edhe komponentin inovativ, p.sh. MTI, MZHE, IAL, rolin e OJQ-ve që kanë fokus primar zhvillimin e komponentës inovative etj. Qeveria e Kosovës në fund të vitit 2017 ka themeluar edhe Ministrinë e Inovacionit dhe Ndërmarrësisë. Mungesa e informimit të duhur për rëndësinë e zhvillimit dhe përkrahjen e Inovacionit dhe Ndërmarrësisë për rritjen e zhvillimit ekonomik në Kosovë. Për këtë arsye iniciativat inovative dhe NVM-të të cilat kanë për qëllim zhvillimin e produkteve apo aktiviteteve inovative nuk kanë shprehur interesim për absorbim të ndihmave përmes 'vaucherëve' dhe përkrahjeve tjera institucionale. Kosova ka katër institucione kërkimore shkencore të përfshirë si partnerë në projektet e Horizontit 2020. Pozita e Kosovës në kuadër të këtij programi kornizë nuk lejon që institucionet e Kosovës të jenë bartëse dhe kjo zvogëlon

mundësinë e përfitimit nga ky program, edhe pse tashmë Kosova ka nënshkruar marrëveshjen me BE-në për të marr pjesë në programet e BE-së. Projektet e zhvilluara deri më tani në institucionet e hulumtimeve shkencore janë përqendruar në punime shkencore, ndërsa komercializimi i veprimtarisë kërkimore-shkencore nuk ka treguar ndonjë zhvillim. Institucionet hulumtuese shkencore janë të orientuara më shumë në mësimdhënie dhe hulumtim bazik.

**Ekonomia dixhitale** - Rrjetet fikse të telekomunikimeve janë të përhapura gjerësisht në zonat urbane. Penetrimi i telefonisë fikse për banor ka rënë nën 3%, si pasojë e përdorimit të teknologjive të reja. Penetrimi i telefonisë mobile tani ka arritur në 109.1% të popullsisë dhe vlerësohet se përdorues të internetit përmes rrjetit 3G dhe 4G janë 63% të banorëve; penetrimi i internetit me qasje fikse vlerësohet të jetë mbi 83% të familjeve. Me hyrjen në fuqi (nëntor 2012) të Ligjit nr.04/L-109 për Komunikimet Elektronike është hequr regjimi i licencimit dhe është vendosur regjimi i autorizimit të përgjithshëm për përfshirje në aktivitete të komunikimeve elektronike. Sipas ARKEP, investimet në infrastrukturën e telekomunikuese gjatë vitit 2015 kanë qenë afër 52 mil. € ose 0.9 % e BPV së përgjithshme, ndërsa gjatë vitit 2016 rreth 30 mil. € ose 0.5 % e BPV së përgjithshme të Kosovës. Përdorimi i gjithmbarshëm i TIK-ut në industri është ende i kufizuar dhe përfitimet e saj konkurruese nuk janë kuptuar siç duhet nga shumë firma, veçanërisht nga NMVM-të (Micro, Small & Medium Enterprises). Në lidhjet brezëgjere, fokusi duhet të jetë në zonat e pambuluara për të përmirësuar pozitën e Kosovës në krahasim me vendet e rajonit (më 2016, shkalla e penetrimit të në nivel vendi ishte 13% e popullsisë, të përqendruara kryesisht në qytete). MZHE në bashkëpunim me BB është duke zhvilluar programin për Ekonominë Dixhitale të Kosovës – KODE (eng. Kosovo Digital Economy). Komponentët e KODE bazohen në projektet që do të zhvillojnë infrastrukturën ndërlidhëse brezëgjere në viset e pambuluara, kapitalin njerëzor dhe bizneset dixhitale për të futur Kosovën në ekonominë dixhitale të së ardhmes. Planifikohet që deri në mes të 2018 të mund të fillohet me zbatimin e këtij programi. Më 2017 me mbështetjen e USAID dhe të projektit zviceran Sëiss Eye të Helvetas Sëiss Intercooperation ka vazhduar zbatimin e projektit "Gratë në Punë Online" në katër komuna të Kosovës, ku janë duke u trajnuar gjithsej 260 gra për shkathtësitë e nevojshme për të gjetur punë në platformat ndërkombëtare online, shkathtësi teknike (si: Kodim) dhe shkathtësi të buta (eng. Soft). Në nivel të kompanive të sektorit të TIK ka nevojë për ngritje kapacitetesh me fokus në aplikimin e standardeve për ofrimin e shërbimeve që kanë të bëjnë me softuer dhe aplikacione të reja. Është e nevojshme tejkalmi i boshllëqeve ekzistuese ndërmjet edukimit dhe punësimit, si dhe zgjerimi i mundësive për krijim të vendeve të punëve dixhitale, me fokus të veçantë tek të rinjtë, gratë dhe personat me nevoja të veçanta. Vlerësohet se në sektorin e TIK-ut janë të punësuar më pakë se 2000 punëtorë, apo më pak se 1% nga numri total i të punësuarve. Nga 571 biznese të regjistruara me TIK-un si aktivitet parësor, vetëm rreth 120 prej tyre konsiderohen biznese me produkt shërbime të fushës së TIK, ndërsa të tjerat janë biznese shitëse e servisuere të harduerit. Me funksionalizimin e plotë të Ministrisë së Inovacionit dhe Ndërmarrësisë do të rritet buxheti për përkrahjen e NVM-ve apo bizneseve që veprimtari kryesore kanë produktet dhe shërbimet e TIK-ut.

**Pengesat strukturore:** Pengesa kryesore është mungesa e kornizës ligjore dhe të politikave për mbështetje të hulumtimeve dhe zhvillimit (R&D). Nuk ka plane qeveritare për të stimuluar NVM-të për të bashkëpunuar me nivelin akademik dhe drejt inovacionit dhe nuk ka bashkëpunim të mjaftueshëm ndër-ministror; ka mungesë informacioni dhe vetëdijesimi lidhur me inovacionin; aktivitete dhe mbështetje të fragmentuara; infrastrukturë e pamjaftueshme e butë (p.sh. ekspertë/konsulentë për RDI) dhe infrastrukturë të fortë (p.sh. laboratorë, pajisje). Mungesa e shtrirjes së infrastrukturës së internetit brezëgjere ndikon negativisht në produktivitetin dhe konkurrueshmërinë globale të kompanive, dhe ulë mundësitë për vetë-

punësim, punë nga distanca, të mësuarit dixhital, dhe tregtimin dixhital. Shpërndarja e infrastrukturës së TIK-ut në Kosovë është relativisht e pa balancuar, ku zonat rurale, shumë lagje të qyteteve, shkollat, bibliotekat, shëndetësia, dhe institucione tjera qeveritare pësojnë nga mungesa e qasjes në infrastrukturën brezëgjërë. Raportet hulumtuese kanë treguar se ka vështirësi në sigurimin e kuadrove të reja me aftësi të nevojshme të fushës së TIK. Po ashtu edhe mungesa e përkrahjes financiare nga institucionet dhe vetëdijësimi për rëndësinë e zhvillimit të NVM-ve dhe aktiviteteve Inovative për fushën e TIK-ut.

**Ndikimi i pengesave strukturore:** Mungesa e investimeve në fushën e inovacionit (sidomos mungesa e investimeve private) do të kontribuojë në uljen e aftësisë së konkurrueshmërisë së NVM-ve dhe ekonomisë së vendit, duke rezultuar me reduktimin e mundësive të NVM-ve dhe ekonomisë për krijimin e produkteve të reja dhe shërbimeve, si dhe mos-hapjen e tregut, si dhe ndikon që norma e punësimit të jetë për 15% më e ulët në krahasim me situatën nëse NVM-të do të ishin ndërmarrje inovative. Mospjesëmarrja në programet e Horizont 2020 për shkak se Kosova ka pozitën e anëtarit vëzhgues pengon ndërmarrjet për bashkëpunim në fushën e rritjes së mençur. Po ashtu, mungesa e bashkëpunimit ndërmjet sektorit privat, sektorit publik dhe IAL pengon transferimin efektiv të njohurive duke rezultuar edhe në humbjen e mundësisë për zhvillim ekonomik. Mungesa e infrastrukturës brezëgjërë ndikon negativisht në ambientin e përshtatshëm për zhvillimin e inovacionit, modeleve të reja të biznesit, produkteve dhe shërbimeve të reja dhe të përmirësuara duke zvogëluar konkurrencën dhe fleksibilitetin në ekonomi, qasjen në tregjet ndërkombëtare, produktivitetin dhe dinamizmin ekonomik, por edhe duke ulur edhe konkurrencën e tregut të produktit në shumë sektorë, veçanërisht në shërbime. Gjithashtu kjo ndikon negativisht edhe në nivelin arsimor të popullsisë, kualitetin dhe qasjen në shërbimet e institucioneve shëndetësore dhe administrative. Ofrimi i një force të kualifikuar për punë do të ndihmonte rritjen e sektorit të TIK-ut, rritjen e konkurrencës dhe shtimin e të hyrave për ekonominë e vendit.

## **b. Planet e reformave prioritare**

### **Masa e reformës #12: Përmirësimi i mjedisit për Inovacion dhe Ndërmarrësi**

#### **1. Përshkrimi i masës**

Kjo masë synon që të krijoj një bazë të mirë ligjore në fushën e hulumtimit dhe kërkimit shkencor, inovacionit në vend. Kjo do të arrihet duke përmirësuar kornizën strategjike dhe ligjore, ku gjatë vitit 2017 do të miratohet Ligji për Inovacion dhe Transfer të Dijes dhe Teknologji, i cili do të ndihmojë në krijimin e kornizave ligjore të bashkëveprimit të komunitetit akademik dhe atij industrial derisa Programi Kombëtar i Shkencës do të përcaktojë rrugët e zhvillimit shkencor të vendit drejt standardeve evropiane; do të ndërmerret rishikimi dhe miratimi i draftit të Strategjisë së Inovacionit. Ministria e re e Inovacionit dhe Ndërmarrësisë në fillim të vitit 2018 do të miratojë Ligjin për Inovacion dhe Ndërmarrësi dhe poashtu, do të punojë në hartimin dhe miratimin e legjislacionit sekondar që rrjedhë nga Ligji i ri për Inovacion dhe Ndërmarrësi, duke përfshirë edhe krijimin e Këshillit Shtetëror të Inovacionit dhe Ndërmarrësisë dhe mekanizmave ndërministror në fushën e inovacionit. Edhe gjatë vitit 2019 do të vazhdojnë me aktivitetet kryesor që përfshijnë funksionalizimin e Këshillit Shtetëror të Inovacionit dhe Ndërmarrësisë dhe mekanizmave ndërministror në fushën e inovacionit. Gjithashtu do të bëhen përpjekje që të rriten niveli i pjesëmarrjes së ISH të vendit në programet dhe projektet evropiane dhe rajonale sidomos në Horizon 2020. Fokusi do të jetë në financimin e projekteve të vogla shkencore, financimin e mobiliteteve të shkencëtarëve, në financimin e publikimeve në revista me IF dhe botimeve në vend, shpërndarjen e 'vouchereve' të

inovacionit. Gjatë tri viteve të ardhshme do të vazhdohet me ofrimin e përkrahjes përmes financimit të mesatarisht 10 projekteve të vogla që synojnë përkrahjen e institucioneve kërkimore shkencore; 20 vaucher të inovacionit për NVM; 50 mobilitete afatshkurtra për shkencëtarë; 20 grante për studentë të doktoratës në 50 universitete më të mira dhe dhënia e shpërblimit 'Shkencëtar i vitit' dhe 'Shkencëtar i ri i vitit'. Kjo masë ndërlidhet me SKZH, ERA, PKZMSA dhe KASH. Themelimi i Ministrisë së Inovacionit dhe Ndërmarrësisë do të ndikojë në fuqizimin e ndërmarrësisë dhe Inovacionit. Në këtë kontekst përveç krijimit të mekanizmave institucional për koordinim të aktiviteteve në mes të shkencës, sektorit privat dhe politik bërjes, do të ndërmerren edhe iniciativa për promovim të inovacionit, ngritjen e kapaciteteve në sektorin publik dhe në sektorin privat përmes programeve trajnuese dhe konsulencave, krijimi i fondeve për përkrahje të sektorëve zhvillimorë (me fokus gratë dhe të rinjët) dhe mbështetja e NVM-ve për tu ballafaquar me presionin e konkurrencës në tregjet e rajonit dhe BE-së.

**a. Aktivitetet e planifikuara për 2018:**

- 1) Hartimi dhe miratimi Ligjit për Inovacion dhe TDT, si dhe akteve tjera nënligjore që rrjedhin më pastaj nga ky ligj;
- 2) Hartimi dhe Miratimi i Ligjit për Inovacion dhe Ndërmarrësi (MIN) dhe Strategjisë së Inovacionit;
- 3) Hartimi i infrastrukturës ligjore sekondare bazuar në Ligjin për Inovacion dhe Ndërmarrësi (MIN);
- 4) Zhvillimi i inkubatorëve të biznesit dhe të paktën i 2 qendrave të ndryshme inovative;
- 5) Funksionalizimi i Këshillit Shtetëror për Inovacion dhe Ndërmarrësi;
- 6) Mbështetja direkte financiare e NVM dhe e iniciativave private me qëllim të licencimit, patentimit, certifikimit të produkteve inovative.

**b. Aktivitetet e planifikuara për 2019:**

- 1) Kompletimi i kornizës ligjore sekondare për inovacion dhe ndërmarrësi;
- 2) Hartimi i infrastrukturës ligjore sekondare bazuar në Ligjin për Inovacion dhe TDT;
- 3) Vazhdimi i zhvillimit të inkubatorëve të biznesit dhe të paktën i 2 qendrave të ndryshme inovative;
- 4) Zhvillimi i ndërmarrësisë përmes programeve të trajnimit/ konsulencës;
- 5) Furnizimi me pajisje laboratorike për zhvillim të koncepteve inovative për universitete dhe shkolla të mesme profesionale;
- 6) Vazhdimi i mbështetjes direkte financiare për NVM dhe iniciativave private me qëllim të licencimit, patentimit, certifikimit të produkteve inovative;
- 7) Zbatimi i reformës sipas Kornizës Nacionale të Kualifikimeve "Tripple Helix" (forcimi i bashkëpunimit: Universitet-Qeveri- Tregu i Punës);

**c. Aktivitetet e planifikuara për 2020:**

- 1) Krijimi i rrjetit për R&D i Kosovës me Diasporën;
- 2) Vazhdimi i mbështetjes direkte financiare për NVM dhe iniciativave private me qëllim të licencimit, patentimit, certifikimit të produkteve inovative;
- 3) Zhvillimi i ndërmarrësisë përmes programeve të trajnimit/ konsulencës;

**2. Ndikimi i pritshëm në konkurrueshmëri/arsyetimi i masës**

Zbatimi i kësaj mase do t'i kontribuoj ngritjes dhe zhvillimit të veprimtarisë Inovative dhe Ndërmarrësisë në Kosovë. Dukshëm përmirëson infrastrukturën ligjore në vend. Me buxhetin

aktual dhe me mundësitë që krijohen nga një buxhet i tillë ndikimi i mundshëm i vendit në konkurrueshmëri do të jetë tejet simbolik. Pa një buxhet me të theksuar dhe pa kapacitete konkurruese në programet ndërkombëtare, nuk mund të presim që brenda kësaj periudhe të ketë efekte të dukshme. (MIN) Në masë të theksuar do të rritet përkrahja aktivitetëve Inovative, në kuadër të NVM-ve dhe iniciativave private të inovacionit, si në aspektin e subvencionimit të drejtpërdrejtë po ashtu, edhe me përkrahje përmes trajnimeve, konsulencave dhe promovimit të produktit, prodhimit apo shërbimit të caktuar për plasim në tregun vendor, të rajonit dhe në vendet e BE-se.

### **3. Kostoja e vlerësuar e aktivitetëve dhe ndikimi buxhetor**

Ministria e Inovacionit dhe Ndërmarrësisë për realizimin e objektivave dhe aktivitetëve të parapara në masën e reformës 14 sipas PRE 2018-2020 parasheh implementimin e buxhetit nga granti qeveritar: nga **kategoria subvencione dhe transfere** për çdo vit nga 5,150,000 €, gjithsej 15,450,000 € për tri vite nga kjo kategori. Nga kategoria e **shpenzimeve kapitale** MIN, ka planifikuar buxhet 1,500,000 € për një vit, për tri vite 4,500,000 €. Ndërsa për realizimin e aktivitetëve të lartpërmendura MIN parasheh përkrahje financiare nga **grantet e donatorëve** të ndryshëm si zyra e BE-se, BERZH, Ambasadat e ndryshme me mision në Kosovë, UNDP, etj, në vlerë rreth 7,000,000 € për një vit dhe 21,000,000€ për tri vite. Të gjitha këto përkrahje dhe investimet në projekte e aktivitete konkrete për inovacion dhe ndërmarrësi, përkrahje me ekspertizë, fushata vetëdijesuese, promovim të prodhimit, marketing për eksport, granteve per start-up, rritje të produktit, prodhimit apo shërbimit, organizimi i konferencave, etj.

### **4. Ndikimi pritshëm në punësim dhe çështje gjinore**

Përmes krijimit të inkubatorëve të biznesit, krijimin e qendrave inovative, themelimit të Këshillit Shtetëror për Inovacion, do të mundësoj që të ketë efekt domino edhe në politika sociale sepse pastaj përmes këtyre aktivitetëve, të rinjtë do të kenë mundësi të adresojnë ideve të tyre në rezultate konkrete duke e sfiduar dijen e tyre nëpër qendrat publike inovative, ku më pastaj do të mundë të jenë të gatshëm të plasojnë produktin tyre në treg. Siç e cekëm edhe në aspektin e çështjeve sociale me kapacitete aktuale, ndikimi do të jetë simbolik. Por, nëse do të aplikoheshin dispozitat ligjore në lidhje me buxhetin, atëherë kjo masë do të ndikonte në zhvillimin e sektorit të hulumtimit dhe inovacionit në kuptimin e rritjes së aftësisë së institucioneve dhe NVM për të punësuar staf të ri që do të ndikonte në rritjen e proporcioni të punësimit të hulumtuesve karshi numrit të përgjithshëm të të punësuarve dhe numrin e hulumtuesve të punësuar me proporcionin e popullsinë (sipas OECD).

### **5. Rreziqet e mundshme**

Mungesa e buxhetit dhe e mundësive financiare do të ndikojë në mënyrë automatike në prapambetjen dhe mos-zhvillimin e sektorit dhe në mungesën e aftësisë konkurruese edhe në tregun e mallrave e shërbimeve, por edhe në konkurrencën ndërkombëtare shkencore inovative. Rrezik tjetër është edhe mungesa e buxhetit dhe mosmiratimi i Strategjisë Kombëtare të Inovacioneve.

## **Masa e reformës #13: Shtrirja e infrastrukturës përkatëse të rrjetave dhe shërbimeve të TIK-ut për zhvillim socio-ekonomik**

### **1. Përshkrimi i masës**

Masa është vazhdimësi nga PRE 2017-2019 dhe ka për qëllim zgjerimin e qasjes dhe përdorimit të TIK-ut përmes shtrirjes së infrastrukturës brezëgjere në viset e pambuluara, forcimit të

kapitalit njerëzor dhe mbështetjes së bizneseve dixhitale, si dhe dixhitalizimit të bizneseve tjera. MZHE në bashkëpunim me Bankën Botërore janë duke e zhvilluar Programin për Ekonominë Dixhitale të Kosovës- KODE (ang. Kosovo Digital Economy Program), i cili përfshinë aktivitetet kryesore të kësaj mase. Planifikohet që deri në mes të vitit 2018 do të mund të fillohet me zbatimin e këtij programi. Rekomandimet kryesore nga dy dokumentet strategjike “Agjenda Dixhitale për Kosovën 2013-2020” (mars 2013) dhe “Strategjia e Kosovës për TI” (dhjetor 2015) të miratuara nga QeK, janë që në afat sa më të shkurtër kohor Qeveria të jetësojë politika të reja për të siguruar ambient biznesi të favorshëm për rritje të sektorit të TIK nga aspekti infrastrukturor me fokus viset rurale, shkollat, bibliotekat, institucionet shëndetësore dhe gjithashtu të miratoj politika të reja edukative për të krijuar kuadro të afta për fuqinë e re punëtore të TIK. Komponenta e parë e Programit KODE ka hyrë në Listën e Projekteve Prioritare në kuadër të Klauzolës së Investimeve (gusht 2016). Gjatë vitit 2017 janë përgatitur ToR për pilotet për shtrirjen e infrastrukturës brezëgjere në 4 lloje, që do të realizohen në vitin 2018, si pjesë e programit KODE. MZHE dhe Ministria e Financave janë duke punuar në vazhdimësi me BB në finalizimin e dokumenteve të nevojshme deri në mes të 2018 për të arritur marrëveshjen për kredinë që do të përfshijë investimet gjatë viteve të ardhshme për shtrirjen e infrastrukturës brezëgjere.

**a. Aktivitetet e planifikuara për 2018**

- 1) Realizimi i Pilot Projektit për shtrirjen e infrastrukturës brezëgjere që do të përfshijë katër apo më shumë lloje (zona rurale) – (MZHE);
- 2) Finalizimi i marrëveshjes me Bankën Botërore (BB) për kredinë që përfshinë investimet gjatë viteve të ardhshme për realizimin e Programit KODE – (MZHE, MF, Kuvendi, BB);
- 3) Adaptimi dhe funksionalizimi i parkut teknologjik për nevoja të bizneseve të TIK – (MZHE, MTI, MIN).

**b. Aktivitetet e planifikuara për 2019**

- 1) Shtrirja e Infrastrukturës brezëgjere në vise të pambuluara – (MZHE, BB);
- 2) Zhvillimi i Resurseve Njerëzore për Ekonominë Dixhitale dhe mbështetje për bizneset dixhitale – (MZHE, IPA2017);

**c. Aktivitetet e planifikuara për 2020:**

- 1) Shtrirja e Infrastrukturës brezëgjere në vise të pambuluara – (MZHE, BB).
- 2) Zhvillimi i Resurseve Njerëzore për Ekonominë Dixhitale dhe Mbështetja për bizneset dixhitale – (MZHE, IPA2017);
- 3) Dixhitalizimi i bizneseve tradicionale dhe ngritja e përdorimit të teknologjive të TIK në sektorin privat – (MZHE, IPA2019).

**2. Ndikimi i pritshëm në konkurrueshmëri/arsyetimi i masës**

Studimi i BB11 arrin në përfundim që rritja e penetrimit fiks brezëgjere prej 10% do të përcillet me një rritje prej 1.21% të GDP-së në ekonominë e zhvilluara dhe 1.38% të GDP-së në ekonominë në zhvillim. Krijimi i kushteve të përshtatshme përmes shtrirjes së infrastrukturës përkatëse të rrjetave dhe mundësitit të shërbimeve brezëgjera do të mundësoj përmirësimin e qasjes në tregje ndërkombëtare, zhvillim të modeleve të reja të biznesit, duke i lejuar njerëzit dhe kompanitë të punojnë pavarësisht lokacionit dhe me orar fleksibil, dhe në përgjithësi

<sup>11</sup> [Eksplorimi i lidhjes ndërmjet infrastrukturës brezëgjere dhe rritjes ekonomike](#)



përshpejtimin e procedurave dhe proceseve, duke rritur dinamizmin ekonomik dhe duke përmirësuar konkurrueshmërinë, përmirësim i tregut të punës dhe mjedisin e biznesit.

### **3. Kostoja e vlerësuar e aktiviteteve dhe ndikimi buxhetor**

1) Shtrirja e Infrastrukturës brezgjere me shpejtësi të lartë - 37 Milion Euro të shpërndarë gjatë viteve 2018 - 7M, 2019 - 10M, 2020 - 10M, 2021 - 10M (hua - BB); Zhvillimi i Resurseve Njerëzore për Ekonominë Dixhitale dhe mbështetja për bizneset dixhitale - 3 Milion Euro të shpërndarë në mënyrë lineare gjatë viteve 2018-2021 (donacion - IPA 2017); (3) Dixhitalizimi i bizneseve tradicionale dhe ngritja e përdorimit të teknologjive të TIK në sektorin privat - 4.5 Milion Euro, e shpërndarë në mënyrë lineare gjatë viteve 2020-2023 (donacion - IPA 2019).

### **4. Ndikimi i pritur në punësim dhe çështje gjinore**

Masa e propozuar mundëson përmirësimin e nivelit arsimor të popullsisë, fuqizon kualitetin e ofruar në institucione shëndetësore dhe ofrimin e shërbimeve administrative më të mira dhe më të qasshme, duke zgjeruar mundësitë e punëve dixhitale, me fokus të veçantë tek të rinjtë, gratë dhe personat me aftësi të kufizuara. Sipas disa anketimeve<sup>12</sup> infrastruktura brezgjere (broadband-i) është vlerësuar si një mundësues kryesor i punës fleksibile, në më shumë se  $\frac{3}{4}$  e bizneseve të anketuara (78%). Vlerësohet se një e treta e kompanive të vogla (33%) dhe pothuajse gjysma e bizneseve individuale tregtare (48%) kanë filluar të krijojnë një ekuilibër më të mirë punë-jetë, duke shpenzuar një pjesë të madhe të orarit të tyre të punës larg nga zyra. Si rezultat direkt i komponentës së dytë të Programit KODE është planifikuar krijimi i 400 vendeve të reja të punës në bizneset e softuerit të TI-së, si dhe janë planifikuar trajnime në TIK të 1440 personave, të cilët potencialisht mund të konsiderohen vende të reja të punës (të punësuar apo vetë-punësuar).

### **5. Rreziqet e mundshme**

Si rreziqe të mundshme për zbatimin e aktiviteteve të planifikuara mund të konsiderohen vonesat në procesin e aprovimit të marrëveshjes për kredi nga Banka Botërore, si dhe vonesat eventuale në realizimin e projekteve të IPA-së. Për këtë qëllim është punuar dhe do të vazhdohet me promovimin e idesë dhe arsyeshmërisë së saj. Si rrezik tjetër i mundshëm janë edhe kapacitetet e kufizuara absorbuese në mesin e fuqisë punëtore potenciale të TIK dhe bizneseve të TIK. Si aktivitet lehtësues është planifikuar shqyrtimi i hollësishëm, në fazën e hershme të zbatimit të aktivitetit, të fuqisë punëtore potenciale të TIK dhe bizneseve ekzistuese të TIK në lidhje me kriteret për pranim në aktivitet, duke përdorur mjetet më efikase të TIK-ut për testimin dhe vlerësimin e kandidatëve potencialë.

#### **4.3.6. REFORMAT LIDHUR ME TREGTINË**

##### **a. Analiza e pengesave kryesore**

**Gjendja aktuale:** Gjatë gjashtë muajve të parë të vitit 2017 tregtia e mallrave regjistruan një vlerë prej 1 miliard e 575 milionë euro, që është një rritje prej 125 milionë euro në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar. Në vitin 2016 tregtia e mallrave regjistruan një vlerë prej 3 miliard euro, që është një rritje prej 139 milionë euro në krahasim me vitin e kaluar. Mallrat e eksportuara në këtë periudhë arritën në 309 milionë euro, një rënie prej 4.5%. Në këtë periudhë, tregtia e jashtme e Kosovës përbënë 90% të importeve dhe eksporteve 10%. Struktura e partnerëve mbetet kryesisht e njëjtë, për eksportet dhe importet, respektivisht. Gjatë dhjetë viteve

---

<sup>12</sup> <http://businessclub.bt.com/stateofthenation.pdf>



të fundit, Kosova ka qenë eksportuese, mesatarisht, rreth 40 për qind të prodhimit të saj në vendet e BE. Tregu i BE-së është ndjekur nga vendet fqinje, të cilat përbëjnë mesatarisht 37 për qind të totalit të eksporteve, gjatë periudhës 2005-2016.

Tregtia rajonale ka shënuar rritje sidomos pas shpalljes së pavarësisë në vitin 2008, bizneset kosovare kanë filluar të lëvizin më shumë në tregjet e tjera, veçanërisht BE-së dhe vendeve si Kina dhe India, ku kërkesa për burime natyrore me bazë është më e madhe. Mungesa e diversifikimit të produktit është veçanërisht akute kur bëhet fjalë për eksportet e Kosovës në tregjet e vendeve të zhvilluara (të BE-së, EFTA) me Indeks Herfindahl-Hirschman e 0.52 dhe 0.6. Nga ana tjetër, eksportet në CEFTA-s janë më të larmishme me 0.248 Indeksi HH.

Pasluftës Kosova ka bërë hapa të rëndësishëm në liberalizimin e ekonomisë së saj, sidomos tregtinë. Një hap i madh është anëtarësimi në CEFTA. Përveç kësaj, Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit ka hyrë në fuqi në vitin 2016.

Në nivel rajonal, Kosova është pjesëmarrëse në reformat e lehtësimit të tregtisë përmes mekanizmave të CEFTA-s. Agjenda e lehtësimit të tregtisë të vendeve të CEFTAs është e lidhur me Marrëveshjen e OBT për Lehtësimin e Tregtisë. Sipas raportit të vetë-vlerësimit që Kosova e ka bërë në bazë të Marrëveshjes së OBT-së, kërkohen masa të menjëhershme për një numër çështjesh, duke përfshirë: shkëmbimin e informacionit, kontrollit pas zhdoganimit, menaxhimin e rrezikut, procedurat e para-mbërritjes, pagesa elektronike, procedurat e njoftimit, procedurat e konsultimit, tarifa dhe ngarkesa mbi importet dhe eksportet, operatorët e autorizuar dhe fusha të tjera.

Eksporti i shërbimeve, përbën një pjesë të konsiderueshme të eksporteve të Kosovës dhe janë përcaktues i rëndësishëm i konkurrencës së ardhshme të Kosovës. Prandaj, heqja e barrierave tregtare për zhvillimin e sektorit të shërbimeve është vendimtare.

**Pengesat strukturore:** Bazuar në indikatorin e Bankës Botërore për tregtinë ndërmjet kufijve, rajoni i CEFTA-së është vlerësuar me 72.6, që është e ngjashme me Azinë Lindore dhe vendet e Paqësorit dhe Amerikës Latine dhe Karaibe, dhe shumë më keq se OECD, që është vlerësuar me 86.1. Për rajonin e CEFTAs, rezultatet e dobëta ndërlidhen me numrin e dokumenteve të kërkuara për import dhe eksport, që është dyfish më e madhe se mesatarja e kërkesës në vendet e OECD-së. Krahas koston të lartë të importit, koha që kërkohet për deklarimin e mallrave përmes doganave në vendet e CEFTA-së është 30 % më e lartë se sa vendet me të ardhura të larta të OECD-së.

Rangimi i përgjithshëm për këtë indikator e vendos Kosovën në pozitën e 51 nga 189 vende. Kosova dhe vende të tjera të CEFTA-së kërkojnë më tepër dokumente për import dhe eksport dhe kostoja e importit dhe eksportit për një kontejner të thjeshtë është më e lartë. Për shembull, Kosova dhe Serbia (krahasuar me vendet e CEFTA-së) kanë koston më të lartë mesatare për import dhe eksport, edhe pse gjatë dy viteve të fundit Kosova ka reduktuar në masë të madhe koston e importit.

Përveç reduktimit të shpenzimeve procedurale, certifikimi dhe cilësia e produktit është një tjetër pengesë e rëndësishme të eksportit dhe zëvendësimin e importit. Në këtë drejtim eliminimi i barrierave të natyrës teknike në tregti është po aq e rëndësishme për lehtësimin e tregtisë. Në mënyrë të ngjashme, Kosova ka identifikuar barrierat logjistike dhe kufitare si një nga pengesat më të mëdha për një qarkullim më të madh të mallrave në mes të partnerëve rajonal, por edhe për një integrim më të thellë me pjesën tjetër të botës.

**Ndikimi i pengesave strukturore:** Pengesat dhe kostoja e lartë e tregtimit ndërmjet kufijve redukton nivelin e eksporteve të Kosovës dhe rrit koston e importeve, që ndikon si pjesën më të

madhe të prodhuesve kosovar që shfrytëzojnë materiale nga importi, si dhe konsumatorët që shfrytëzojnë mallrat e importuara. Edhe me më rëndësi, reduktimi i pengesave kufitare procedurale, cilësore dhe logjistike për të eksportuar do të kontribuonte në rritjen e nivelit shumë të ulët të eksportit.

Sektori i shërbimeve është një komponent i rëndësishëm i ekonomisë së çdo vendi. Ai jep një kontribut të drejtpërdrejtë dhe të rëndësishëm në BPV dhe krijimin e vendeve të punës, dhe siguron inpute të rëndësishme për pjesën tjetër të ekonomisë, duke ndikuar kështu në klimën e përgjithshme të investimeve, që është një përcaktues thelbësor i rritjes dhe zhvillimit ekonomik.

Shërbimet janë inpute kryesore për shumicën e bizneseve të tjera, p.sh. Shërbimet e infrastrukturës si energjia, telekomunikacioni dhe transporti. Shërbime financiare që lehtësojnë transaksionet dhe sigurojnë qasje në financa për investime. Shërbimet shëndetësore dhe arsimore të cilat kontribuojnë në një forcë pune të shëndetshme dhe të trajnuar mirë. Shërbimet ligjore dhe ato kontabël të cilat janë pjesë e kornizës institucionale të nevojshme për të mbështetur një ekonomi të shëndetshme tregu. Këta sektorë të shërbimeve janë pjesë kyçe e klimës së investimeve dhe mund të kenë një ndikim më të madh në ecurinë e përgjithshme të biznesit dhe në nivelin e investimeve, dhe kështu rritjen dhe produktivitetin në ekonomi.

## **b. lanet e reformave prioritare**

### **Masa 14: Lehtësimi i tregtisë përmes rritjes së efikasitetit për kosto të transaksioneve tregtare ndërkombëtare**

#### **1. Përshkrimi i masës**

Kjo masë është vazhdimësi e PRE 2017-2019, dhe ka për qëllim të adresojë dhe reduktoj këto barrierë, posaçërisht përmes thjeshtimit dhe standardizimit të të gjitha formaliteteve dhe procedurave në kufi, që pritet të reduktojnë shpenzimet ndërkufitare dhe kohën. Aktivitetet e parapara për vitin 2017 janë zbatuar dhe këto aktivitete që kanë qenë në vazhdimësi po ashtu kanë filluar të zbatohen dhe pritet të përfundohen në vitet vijuese.

#### **a. Aktivitetet e planifikuara për 2018**

- 1) Ndërtimi i një platforme për identifikimin e kërkesave për bashkimin e sistemeve të institucioneve kryesore në kuadër të Dritares së Vetme Kombëtare; me këtë duhet të kërkohet një asistencë dhe përvojë ndërkombëtare nga një vend i BE-së në ndërtimin e një dokumenti – platforme që përfshinë të gjitha kërkesat dhe nevojat për ndërtimin dhe zhvillimin e sistemeve nga institucionet, ministrinë përkatëse, agjencionet që do të duhej të jenë pjesë e konceptit të dritares së vetme kombëtare.
- 2) Rregullimi i tarifave për shfrytëzim të terminaleve doganore përmes zhvillimi të procedurave me Ministrinë e Financave dhe Ministrinë e Infrastrukturës; të ndërtohet dhe zhvillohet UA për menaxhimin e Terminaleve Doganore;
- 3) Zhvillimi i Legjislacionit nga MZHE për nënshkrimin digjital;
- 4) Përgatitja e platformës, procedurave dhe kërkesës për aderim në NCTS (MF);
- 5) Zbatimi i sistemit për menaxhimin e kontratës (ECM);

#### **b. Aktivitetet e planifikuara për 2019**

- 1) Ndërtimi dhe zhvillimi i sistemeve të institucioneve kryesore në kuadër të Dritares së Vetme Kombëtare, përmes platformës së krijuar nga ASHI-MAP;

- 2) Avancimi i doganave pa letra përmes përdorimit të teknologjisë dhe platformës për nënshkrim digjital;
- 3) Aderimi në Konventën e Përbashkët Tranzite;
- 4) Zhvillimi dhe ndërtimi i sistemeve dhe databazave nga Agjencionet e përfshira në shkëmbimin e informatave në nivel nacional dhe regjional për zbatimin e SEED+;

### **c. Aktivitetet e planifikuara për 2020**

- 1) Finalizimi i vendosjes së Dritares së Vetme Kombëtare;
- 2) Finalizimi i shkëmbimit të informatave nga agjencionet e përfshira në SEED+;

## **2. Ndikimi i pritur në konkurrueshmëri /arsyetimi i masës**

Analizat tregojnë se në shumë vende, në nivelin makro reduktimi i kohës për tregti vetëm për një ditë mund të rrit aktivitetin tregtar në më shumë se 5%. Në nivelin e firmave, eksportuesit në vendet në zhvillim që kanë agjenci më efikase të doganave prodhojnë produkte më të mira dhe më të larmishme, si dhe rrisin eksportet. Sikurse është theksuar nga Forumi Ekonomik Botëror (2013) përfitimi i drejtpërdrejt nga eliminimi i barrierave të zingjirit të furnizimit është ulja e kostos për kompanitë komerciale dhe si rrjedhojë çmime më të ulëta për konsumatorët dhe bizneset që importojnë materiale të shfrytëzuara në aktivitetet e tyre prodhuese. Reduktimi i kostos së importit do të ishte me rëndësi të madhe për Kosovën, duke qenë se sektori prodhues i vendit është kryesisht i bazuar në inpute të importit. OECD ka vlerësuar se reformat në lehtësimin e tregtisë mund të reduktojnë koston e tregtisë deri në 15.5%. Sipas OECD-së, lehtësimi tregtar është i ndërlidhur transaksione më të lehta, efikase për koston, më të shpejta dhe me efektive, në këtë mënyrë lehtëson qarkullimin tregtar. Përveç eksporteve dhe importeve më të lehta të mallrave dhe shërbimeve, masat e lehtësimit tregtar gjithashtu shtojnë atraktivitetin e një vendi për investime të huaja direkte.

## **3. Kostoja e vlerësuar e aktiviteteve dhe ndikimi buxhetor**

Burimet e financimit për këtë masë do të jenë nga buxheti i Kosovës dhe partnerët zhvillimor BB, IFC, dhe IPA (të cilat pritet të konfirmohen gjatë vitit 2018). Nga buxheti i Kosovës 10,000€ janë alokuar për secilin vit për periudhën 2018-2020. Për NCTS duhet fillimisht të procedohet me kërkesë nga Ministria e Financave. Pas pranimi të konventës atëherë fillohet me procedura për krijimin e bazës ligjore dhe sistemit. Shuma e përafërt për të filluar me zbatimin e sistemit NCTS është nga 1.5 Milion Euro deri në 2.2 Milion Euro. (Çmimet janë referente nga Dogana e Shqipërisë dhe ajo e Maqedonisë). Pjesa e SEED Plus do të vazhdohet për vite me radhe ku do të avancohet edhe me shume se nga ajo që është paraparë fillimisht.

## **4. Ndikimi i pritur në punësim dhe çështje gjinore**

Me këtë masë në synojmë të rrisim investimet në ngritjen e kapaciteteve njerëzore dhe institucionale, si dhe krijimin e vendeve të punës (bazuar në studime, përmirësimet për lehtësimin e tregtisë mund të rezultojnë në përfitime globale me vende të reja të punës deri në 21 milion, me vendet në zhvillim duke përfituar mbi 18 milionë vende të reja pune dhe vendet e zhvilluara duke rritur fuqinë e tyre punëtore për 3 milion veta).

## **5. Rreziqet potenciale**

Rreziqet e ndërlidhura me zbatimin e masës përfshijnë bashkëpunimin ndërmjet agjencive, vonesat në zbatimin e legjislacionit, mungesa e mbështetjes financiare si dhe mungesa e stafit profesional. Një pengesë e asociuar me reforma të tjera është procesi i shkrirjes së administratës tatimore dhe doganës, që si proces mund të shkaktoj vonesa në zbatimin e aktiviteteve të kësaj mase.

## **Masa #15: Zhvillimi i mëtutjeshëm i infrastrukturës së cilësisë dhe fuqizimi i rolit të autoriteteve për mbikëqyrjen e tregut me fokus produktet e ndërtimit**

### **1. Përshkrimi i masës**

Zhvillimi i mëtutjeshëm i infrastrukturës së cilësisë (Standardizimi, Akreditimi, Metrologjia dhe Vlerësimi i Konformitetit-Rregullat Teknike) duke përafuar legjislacionin vendor me atë të BE-së *acquis* dhe implementimin e tij si bazë për fuqizimin dhe koordinimin e sistemit ndër-institucional me bizneset dhe palët tjera të interesit, si dhe anëtarësimin e tyre në organizatat evropiane dhe ndërkombëtare. Objektivi i përgjithshëm për zhvillimin e mëtejshëm të Infrastrukturës së Cilësisë dhe Mbikëqyrjes së Tregut është përafrimi dhe implementimi i legjislacionit të BE-së me qëllim të: rritjes së sigurisë dhe cilësisë së produkteve të ndërtimit dhe të shërbimeve të ofruara në tregun vendor si dhe integritimit në tregun e BE-së dhe vendeve tjera; eliminimit të barrierave teknike në tregti, mbikëqyrjes efektive të tregut nga autoritetet e mbikëqyrjes së tregut.

Me këtë objektiv synohet zvogëlimi i disbalancit tregtar për produktet e ndërtimit i cili është import mbi rreth 300 milion euro/vit dhe eksport mbi rreth 20 milion euro/vit<sup>13</sup>, vlera këto për periudhën 2014-2016, duke siguruar mbështetje për sektorin e prodhimit të produkteve ndërtimore. Kjo do të arrihet duke identifikuar grupet e caktuara të produkteve ndërtimore, të cilat e mbulojnë tregun vendor e që mund të jenë konkurrencte për eksport.

Miratimi i ligjeve të planifikuara për vitin 2017: Ligji për Standardizim; Ligji për Produkte të Ndërtimit; Ligji për Kërkesa Teknike për Produkte dhe Vlerësim të Konformitetit nuk është realizuar për shkak të vonësave në konstituimin e institucioneve qendrore dhe si të tilla janë në fazën finale të procedimit për miratim.

#### **a. Aktivitetet e planifikuara për 2018**

- 1) Miratimi i pakos ligjore në lidhje me infrastrukturën e cilësisë: Ligji për standardizim, ligji për produkte të ndërtimit, ligji për metrologji dhe ligji për Kërkesa Teknike për Produkte dhe Vlerësim të Konformitetit.
- 2) Miratimi i akteve nënligjore për zbatimin e ligjeve nën aktivitetin 1.
- 3) Adoptimi i standardeve të reja duke i dhënë prioritet standardeve të harmonizuara për produktet e ndërtimit;
- 4) Nënshkrimi i marrëveshjes multilaterale me Korporatën Evropiane të Akreditimit për laboratorët testues;
- 5) Ngritja e sistemit të menaxhimit të cilësisë për laboratorët e metrologjisë;
- 6) Promovimi i infrastrukturës së cilësisë duke ofruar asistencë specifike teknike për prodhuesit e produkteve ndërtimore.

#### **b. Aktivitetet e planifikuara për 2019**

- 1) Implementimi i Ligjit për Produktet e Ndërtimit, akteve nënligjore në lidhje me sistemin për vlerësimin dhe verifikimin e qëndrueshmërisë së performancës (AVCP) të produkteve të ndërtimit.
- 2) Themelimi i Pikës së Kontaktit për produktet e ndërtimit e cila do ofroj informatat për palët e interesit në lidhje me dispozitat rregullatore në fuqi.

<sup>13</sup> Të dhënat e siguruar nga Agjencia e Statistikave.

- 3) Rritje e numrit të trupave për vlerësim të konformitetit të akredituar (trupave certifikuese dhe inspektuese) për fushën e produkteve të ndërtimit.
- 4) Përmirësimi i mbikëqyrjes së tregut për të kontrolluar jokoformitetet e produkteve të ndërtimit të vëna në dispozicion të tregut.
- 5) Promovimi i infrastrukturës së cilësisë duke ofruar asistencë specifike teknike për prodhuesit e produkteve ndërtimore.
- 6) Identifikimi, shfuqizimi dhe adoptimi i standardeve në fushën e produkteve të ndërtimit duke iu dhënë prioritet standardeve të harmonizuara (hEN) dhe standardeve tjera mbështetëse të cilat janë të nevojshme për testim/kalibrim që janë të rëndësishme se njëjtë me standardet e harmonizuara.
- 7) Anëtarësimi i AKS-së dhe AMK-së në organizatat evropiane dhe ndërkombëtare relevante.
- 8) Hartimi dhe zbatimi i programeve sektoriale për mbikëqyrjen e tregut dhe fuqizimi rolit të Trupit për Koordinimin e Mbikëqyrjes së Tregut në lidhje me implementimin e legjislacionit teknik për fusha të caktuara të produkteve.

#### **c. Aktivitetet e planifikuara për 2020**

- 1) Zbatimi i programit sektorial për Mbikëqyrjen e Tregut, në lidhje me implementimin e legjislacionit teknik për produktet e ndërtimit.
- 2) Promovimi i infrastrukturës së cilësisë duke ofruar asistencë specifike teknike për prodhuesit e produkteve ndërtimore.
- 3) Zgjerimi i skemave të akreditimit sipas kërkesave të reja duke përfshirë edhe ato të rregullave teknike.
- 4) Zgjerimi i fushave të metrologjisë (themelimi i laboratorëve sipas kërkesave të tregut).
- 9) Identifikimi, shfuqizimi dhe adoptimi i standardeve në fushën e produkteve të ndërtimit duke iu dhënë prioritet standardeve të harmonizuara (hEN) dhe standardeve tjera mbështetëse të cilat janë të nevojshme për testim/kalibrim që janë të rëndësishme se njëjtë me standardet e harmonizuara.

#### **2. Ndikimi i pritur në konkurrueshmëri/arsyetimi i masës**

Sistem rregullator i qëndrueshëm i cili iu mundëson prodhuesve vendor që duke përmirësuar sigurinë dhe cilësinë e produkteve ndërtimore të jenë konkurrues me produktet të cilat kanë shenjën CE, vendosje në treg e produkteve të certifikuara të nivelit të njëjtë me produktet e vendeve të Bashkimit Evropian. Ky sistem do të siguron ngritje të aftësive konkurruese të bizneseve duke iu mundësuar qasjen e tyre në tregjet ndërkombëtare dhe në zvogëlimin e disbalancit tregtar për produktet e ndërtimit.

#### **3. Kostoja e vlerësuar e aktiviteteve dhe ndikimi buxhetor**

Buxheti për realizimin e aktiviteteve të vitit 2018 është: 136,866.66 nga BKK, ndërsa nga donatorët buxheti për vitin 2018 është 150,000.00 Euro.

Buxheti për realizimin e aktiviteteve të vitit 2019 është: 156.866.00 nga BKK, ndërsa nga donatorët buxheti për vitin 2019 është 200,000.00 Euro.

Buxheti për realizimin e aktiviteteve të vitit 2020 është: 136.866.66 nga BKK, ndërsa nga donatorët buxheti për vitin 2019 është 150,000.00 Euro.

#### **4. Ndikimi i pritur në punësim dhe çështje gjinore**

Zhvillimi i mëtejshëm i Infrastrukturës së Cilësisë përveç ndikimit të drejtpërdrejtë në ekonomi përmes rritjes së konkurrueshmërisë së bizneseve dhe rrjedhimisht integritit tregtar, pritet të ketë edhe ndikim më të gjerë në shoqëri përmes nxitjes së investimeve në sektorin privat, hapjen e vendeve të reja të punës si dhe nxitjen e bizneseve që të zbatojnë standardet për të arritur sigurinë dhe cilësinë e produkteve ndërtimore dhe shërbimeve të palët e interesit.

## **5. Rreziqet e mundshme**

Rreziqet e mundshme për realizimin e kësaj mase mund të jenë të natyrës së anëtarësimit në organizatat evropiane dhe ndërkombëtare si dhe mungesa e stafit.

### **4.3.7. ARSIMI DHE SHKATHTËSITË**

#### **a. Analiza e pengesave strukturore**

**Gjendja aktuale:** Gjatë viteve të fundit është arritur një progres në zhvillimin e shkathtësive, përmirësimin e cilësisë dhe qasjes në arsim. Në vitin 2016-2017 përfshirja në arsimin parashkollor (3-5 vjeç) ka qenë 33.9 %, para-fillor (5vjeç)-87.6 %, fillor 96.2 %, arsimin e mesëm të ulët 93.3 %, arsimin e mesëm të lartë 88.1%. Kurrikula e bazuar në kompetenca (kurrikula lëndore), ka filluar të zbatohet në të gjitha shkollat me fillimin e vitit të ri shkollor 2017/2018 për klasën përgatitore (0), klasat 1, 6 dhe 10. Në gjashtë mujorin e parë të këtij viti janë hartuar kurrikulat lëndore për klasat 2, 7, 11 dhe me fillimin e vitit shkollor 2017/18 ka filluar zbatimi në 72 shkolla pilot. MASHT ka filluar procesin e ndërtimit të kopshteve të reja që ndikon në rritjen e gjithëpërfshirjes. Ekipet për parandalim dhe reagim ndaj braktisjes dhe mos-regjistrimit në arsimin e obliguar janë themeluar në nivel shkollash dhe komunash.

Sipas sistemit të paralajmërimit të braktisjes - Modul i Veçante në SMIA - që nga janari deri në qershor 2017 janë raportuar 49 raste të fëmijëve në rrezik të braktisjes së shkollimit të cilat po i trajtojnë shkollat me mekanizmat e krijuar për parandalim dhe reagim ndaj braktisjes. Në këtë vit shkollor i kemi deri më tani i kemi vetëm 2 raste. Në total kemi 51 raste prej se funksionon sistemi.

Në testin e maturës në afatin e qershorit kalueshmëria ka qenë 83.5% për 23660 nxënës, ndërsa në afatin e gushtit ishte 50% ku kanë hyrë 3750 nxënës, ndërsa rezultati i arritshmërisë së klasës së nëntë ka qenë 58%. Pas pjesëmarrjes së Kosovës në PISA në vitin 2015 për herë të parë, (pozita e 69 nga 72 vende) në vitin 2017 është mbajtur faza pilot dhe janë duke u zhvilluar përgatitjet për fazën finale të PISA 2018. Deri tani janë licencuar me licencë të karrierës 95 % e mësimitdhënësve të kualifikuar. Zhvillime pozitive janë arritur në programet e avancimit dhe rikualifikimit të mësimitdhënësve, mirëpo nevojitet të bëhet zbatimi i vlerësimit të performancës së mësimitdhënësve. Rreth 50% e nxënësve të arsimin të mesëm të lartë zgjedhin një nga profilet e arsimin profesional, ku kjo përfshirje është e krahasueshme me nivelin e vendeve në rajon.

Ndërlidhja e tregut të punës me AAP nuk është në nivelin e kënaqshëm për shkak të mungesës së kapaciteteve dhe bashkëpunimit ndërinstitucional për të siguruar qasje të njëjtë drejt hartimit të politikave qeveritare. Nuk ka bashkëpunim të mirëfilltë të akterëve relevantë në AL, AAP, mësimit tërëjetësor, duke përfshirë këtu edhe politikat e tregut të punës, ndërmarrjen dhe përfshirjen sociale. MASHT ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me ndërmarrje dhe këto ndërmarrje kanë dhënë kontribut për ofrimin e mundësive për praktike profesionale dhe mundësi punësimi për ata që tregojnë aftësi dhe shkathtësi të mjaftueshme. Deri më tani janë përfunduar 25 profile për nivelin III dhe IV të KKK-së dhe dy profile të nivelit V, të cilat janë plotësisht të bazuara në kërkesat e tregut të punës. Për këto profile janë hartuar standardet, zhvilluar plan programet, blerë pajisjet dhe janë hartuar materialet mësimore. Risi këtë vit shkollor është fillimi i zbatimit të Nivelit V për dy profile sipas KKK-së. Është duke u hartuar Korniza

Bërthamë e veçantë për AAP dhe janë rirregulluar sektorët bazuar në ISCED-F dhe në harmoni me të gjitha dokumentet zyrtare në kuadër të Reformave Evropiane. Gjatë vitit shkollor 2017-2018 kjo Kornizë Bërthamë do të prezantohet në të gjitha shkollat e AAP dhe në vitin 2018-2019 do kompletohen të gjitha shkollat me programe të reja dhe të adaptuara në bazë të standardeve të profesionit dhe tregut të punës.

Është rritur përfshirja në arsimin e lartë në vitet e fundit dhe shifrat aktuale e rendisin Kosovën në mesin e vendeve rajonale me më shumë studentë për 100.000 banorë. Përpjesëtimi mësimdhënës/student është përkeqësuar ndjeshëm dhe kjo paraqet një tregues kuantitativ të cilësisë në arsimin e lartë në Kosovë. Numri i programeve të studimit ka shënuar rritje domethënëse në institucionet e arsimit të lartë në Kosovë. Duhet të rishikohen programet ekzistuese të studimeve në IAL për të reflektuar kërkesat e tregut e punës. Sfidë mbetet mungesa e programeve ndërdisiplinore të studimit. Oferta aktuale arsimore nuk është në tërësi në harmoni me nevojat e tregut të punës dhe nevojat për shkathtësi në sektorët strategjik qeveritar.

**Pengesat strukturore:** Përfshirja e ulët fëmijëve në arsimin parashkollor, që vjen si rezultat i mungesës së infrastrukturës fizike, mos-financimit të duhur, rregullimi dhe licencimi i institucioneve private, zhvillimi profesional i edukatorëve dhe zhvillimi i instrumenteve kombëtare për përcaktimin e cilësisë së arsimit parashkollor janë sfida të cilat po ndikojnë në tërë sistemin e arsimit. Në arsimin e obliguar pengesat lidhen me përfshirjen e nxënësve, cilësinë, kjo është e evidente tek grupet e marginalizuara, komunitetit rom, ashkali dhe egjiptianë dhe e nxënësve me aftësi të kufizuara. Zhvillimi i shkathtësive për shumicën e fushave përkatëse profesionale, sipas hulumtimeve nuk korrespondojnë me kërkesat dhe shkaktojnë efekte negative në zhvillimin ekonomik të vendit. Pengesat që mund të hasen gjatë implementimit të reformave vazhdojnë të mbesin trajnimi i mësimdhënësve në fushën pedagogjike, kualifikimi i instruktorëve, bashkëpunimi me bizneset për praktikë profesionale, pajisja e shkollave me infrastrukturë të TI. Pengesa të tjera përfshijnë numrin e vogël të standardeve të profesionit; mekanizmat dhe praktika e sigurimit të cilësisë ende mbeten të pazhvilluar; zhvillimi i mësimdhënësve sipas kriterëve dhe standardeve të kornizës strategjike për ZHPM dhe lidhja e gradave me sistemin e pagesave.

**Ndikimi i pengesave strukturore:** Përfshirja në arsimin parashkollor dhe në parafillor ndikon në rritjen e rezultateve arsimore në të gjitha nivelet e shkollimit. Njëkohësisht rritja e përfshirjes mundëson pjesëmarrjen e femrave në tregun e punës. Në përgjithësi, mospërputhja e arsimit me tregun e punës ndikon në zvogëlimin e investimeve dhe pengon zhvillimin ekonomik të vendit, si dhe në rritjen e papunësisë dhe të varfërisë dhe në shpenzimin e panevojshëm të buxhetit. Cilësia e mësimdhënies është thelbësore për përgatitjen e një fuqie punëtore të aftë për tregun e punës. Si rrjedhojë në aspektin afatgjatë pengesat e paraqitura ndikojnë në shkathtësitë e fuqisë punëtore.

## **b. Planet e reformave prioritare**

### **Masa e reformës 16: Harmonizimi i ofertës dhe kërkesës së tregut të punës përmes hartimit të standardeve të profesionit dhe rishikimit të kurrikulave**

#### **1. Përshkrimi i masës**

Objektivi kryesor i kësaj mase është harmonizimi i arsimit dhe aftësimin me kërkesat e tregut të punës. Në mënyrë që të adresohet burimi i problemit sa i përket boshllëkut ekzistues të shkathtësive të fuqisë punëtore dhe lidhjes së tregut të punës me arsimin dhe aftësimin profesional është bërë një analizë e detajuar e profileve që ofrohen në shkollat e AAP. Prandaj hartimi i standardeve të profesionit si urë lidhëse mes tregut të punës dhe arsimit profesional



është prioritet i MASHT që më tej të vazhdohet me rishikimin e kurrikulave për arsim dhe aftësim profesional dhe ofrimin e kushteve për të implementuar këto kurrikula me qëllim që sistemi aktual të mund të ofrojë studentëve shkathësi relevante dhe të kërkuara në tregun e punës. Gjate vitit 2018-2019 synojmë që krahas rishikimit të kurrikulave edhe të pajisim profilet prioritare me punëtori dhe material mësimore. Kjo masë ndërlidhet me SKZh, PSAK, PZMSA, KASH, ERA, dhe me dokumente tjera relevante të cilat kanë të bëjnë në ngritjen e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies. Kjo masë është vazhdimësi e PRE 2016 dhe 2017.

**a. Aktivitetet e planifikuara për 2018:**

- 1) Hartimi i 25 standardeve të profesionit të cilat verifikohen nga AKK;
- 2) Rishikimi i 20 kurrikulave të AAP dhe trajnimi i 40 trajnerëve dhe mësimdhënësve bazuar në kurrikulën bërthamë nga MASHT, MPMS;
- 3) Rishikimi i formulës së financimit specifike për arsim dhe aftësim profesional bazuar në koston për sektor dhe profil;

**a. Aktivitetet e planifikuara për 2019:**

- 1) Hartimi i 25 standardeve të profesioni dhe verifikimi i tyre;
- 2) Trajnimi i 40 i instruktorëve/trajnerë dhe mësimdhënësve bazuar në kurrikulën e re nga MASHT, MPMS;
- 3) Hartimi dhe pilotimi i formulës së financimit specifike për AAP bazuar në koston për profil;
- 4) Hartimi i materialeve mësimore bazuar në kurrikulën e re;
- 5) Pajisja e 10 shkollave profesionale me pajisje adekuate për profilet prioritare pas analizës së gjendjes;

**b. Aktivitetet e planifikuara për 2020:**

- 1) Hartimi dhe rishikimi i standardeve të reja të profesioni dhe verifikimi i tyre sipas nevojës dhe kërkesës së tregut të punës;
- 2) Trajnimi i 40 i instruktorëve/trajnerëve dhe mësimdhënësve bazuar në kurrikulën bërthamë nga MASHT, MPMS;
- 3) Implementimi i formulës së financimit specifike për arsim dhe aftësim profesional bazuar në koston për sektor dhe profil;
- 4) Hartimi i materialeve mësimore bazuar në kurrikulën e re sipas nevojës dhe kërkesës së tregut të punës;
- 5) Pajisja e 10 shkollave profesionale me pajisje adekuate për profilet prioritare pas analizës së gjendjes

**2. Ndikimi i pritshëm në konkurrueshmëri/arsyetimi i masës**

Zbatimi i kësaj mase do të kontribuoj në zhvillimin e fuqisë punëtore me të aftë dhe më produktive, do të krijoj mundësi për vetëpunësimin dhe punësimin, nxit inovacionin dhe rrit cilësinë dhe efikasitetin e produkteve dhe ndërmarrjeve dhe njëkohësisht edhe zhvillimin e industrisë.

**3. Kostoja e vlerësuar e aktiviteteve dhe ndikimi buxhetor**

Në kuadër të vlerës prej € 275,000 për vitin 2018 përfshinë (€15,000-AKK, €15,000 –MPMS, €145,000 –AAPARR) në vitin 2019 vlera prej €225,000, përfshinë (€15,000-AKK, €15,000–MPMS, €195,000–AAPARR), në vitin 2020 vlera prej €225,000, përfshinë (€15,000-AKK,

€15,000 –MPMS, €195,000 –AAPAGRR). Pjesa tjetër e aktiviteteve pritet të mbështetet nga donatorët. Donatorët do të përkrahin nga tetori 2017 deri shtator 2018 me 700000 euro, përfshirë edhe një pjesë të pajisjeve, rishikimin e formulës së financimit, standardet dhe kurrikulat për shkollat e përzgjedhura në bazë të hulumtimit.

#### **4. Ndikimi pritshëm në punësim dhe çështje gjinore**

Kjo masë në aspektin afatgjatë rrit cilësinë në sistemin arsimor, mundësinë e punësimit, përmirëson cilësinë e fuqisë punëtore, kontribuon në rritjen e investimeve dhe zhvillimin ekonomik. Duke përfshirë bizneset në politika të arsimit dhe aftësimin profesional rrisim vetëdijësimin e tyre për nevojën dhe rëndësinë e punëtoreve të kualifikuar në vendin e punës.

#### **5. Rreziqet e mundshme**

Numri i madh i profileve, 140 për rishikim dhe procedurat e prokurimit dhe angazhimit të eksperteve për implementimin e aktiviteteve të parapara dhe sigurimi aksidental (për praktikën profesionale në AAP).

### **Masa e reformës #17: Reforma në Arsimin Parauniversitar nëpërmjet zhvillimit dhe zbatimit të kurrikulave, ZHPM dhe sigurimi i cilësisë nëpërmjet monitorimit dhe vlerësimit dhe gjithëpërfshirja**

#### **1. Përshkrimi i masës**

Objektivi kryesor i kësaj mase është zhvillimi dhe zbatimi i Kurrikulës së bazuar në kompetenca, përmirësimi i sistemit për zhvillim profesional të mësimdhënësve dhe vlerësim të performancës së mësimdhënësve, përmes sistemit të licencimit në të gjitha shkollat e Republikës së Kosovës. Kjo masë ndërlihet me drejtpërsëdrejti me prioritetet e Qeverisë, Kornizën Strategjike të BE-së 2020, SKZh, PSAK, PZMSA KASH si dhe me të gjitha dokumentet relevante të cilat kanë të bëjnë me ngritjen e cilësisë së mësimdhënies dhe mësim nxënies. Rritja e gjithëpërfshirjes dhe parandalimi i braktisjes është proces i cili kërkon mobilizimin e të gjithë mekanizmave si: qeverisjes qendrore, lokale dhe institucionet arsimore.

##### **a. Aktivitetet e planifikuara për 2018:**

- 1) Zbatimi i programeve për klasat 0, 1, 2, 6, 7, 11; përgjegjëse MASHT, DKA, shkolla dhe zhvillimi i programeve mësimore për klasat 3, 8, 12; përgjegjës MASHT
- 2) Monitorimi i zbatimit të Kurrikulës së re nga niveli i shkollës, DKA-ve dhe niveli qendror - MASHT.
- 3) Pilotimi i Kurrikulës bërthamë për edukim në fëmijërinë e hershme mosha 0 – 5 vjeç në 7 institucione parashkollore, si dhe ndërtimi i 8 objekteve për institucionet parashkollore;
- 4) Zhvillimi i bazës së të dhënave për licencim, sipas skemës së re të integritimit të të dhënave në sistemin e SMIA;
- 5) Vlerësimi i performancës së mësimdhënësve (5 %) sipas gradimit në sistemin e licencimit.;
- 6) Trajnimi i 9000 mësimdhënësve për zbatimin e kurrikulës bërthamë për klasat, parafillor (0) 1, 6, 10 për vitin shkollor 2018/2019 në arsimin e përgjithshëm dhe profesional;
- 7) Vlerësimi i nxënësve për nivelin 5,9 dhe 12 dhe publikimi i rezultateve; vlerësimi i nxënësve për nivelin 5, testi i nivelit/, 9 testi i arritshmërisë dhe 12 testi i maturës, si dhe publikimi i rezultateve.

- 8) Përkrahja e nxënësve dhe studentëve të komuniteteve rom, ashkalinj dhe egjiptian me bursa; hartimi i instrumenteve për shkollat dhe ekipet vlerësuese pedagogjike në komuna për nxënësit me aftësi të kufizuara bazuar në ICF (International classification of functioning children & youth); Përcjellja e shkollave për zbatimin e legjislacionit për riatdhesim; Fuqizimi i mekanizmave për parandalimin dhe reagimin ndaj braktisjes dhe mos-regjistrimit të nxënësve në arsimin para-universitar; Krijimi i mekanizmave për identifikimin dhe mbështetjen e fëmijëve me dhunti të veçanta

**b. Aktivitetet e planifikuara për 2019:**

- 1) Zbatimi i programeve për klasat 0,1,2,3,7,8 10,11,12 (MASHT, DKA, shkolla); Zhvillimi i programeve të klasave 4, 5, 9; (MASHT); Hartimi i programeve mësimore për klasat 4, 9 (MASHT);
- 2) Monitorimi i zbatimit të Kurrikulës së re nga niveli i shkollës, DKA-ve dhe niveli qendror (MASHT) Zbatimi i fazës hyrëse për mësimdhënësit fillestar (faza induktive), para fillimit të karrierës;
- 3) Vazhdim i pilotimit të kurrikulës për edukimin në fëmijërinë e hershme dhe rishikimi i kurrikulës bërthamë pas pilotimit në 7 institucione (MASHT, UNIFEF); Ndërtimi i 2 objekteve për institucionet parashkollore;
- 4) Vazhdimi i ripërtëritjes së licencave dhe gradimi për mësimdhënësit në kuadër të procesit të licencimit;
- 5) Lidhja me sistemin e pagave sipas formulës së financimit;
- 6) Trajnimi i 6000 mësimdhënësve për zbatimin e kurrikulës bërthamë për klasat, parafillor (përgatitor), 1, 6, 10 në arsimin e përgjithshëm dhe profesional dhe zbatimin e kornizës strategjike për zhvillimin e mësimdhënësve në nivelin e shkollave, DKA-ve dhe MASHT; Vlerësimi i performancës së mësimdhënësve (5 %) sipas gradimit në sistemin e licencimit. zhvillimi i bazës së të dhënave për licencim, sipas skemës së re të integritit të dhënave
- 7) Vlerësimi i nxënësve për nivelin 5, testi i nivelit/, 9 testi i arritshmërisë dhe 12 testi i maturës, si dhe publikimi i rezultateve.
- 8) Përkrahja e nxënësve dhe studentëve të komuniteteve rom, ashkalinj dhe egjiptian me bursa me bursa (MASHT me donatorë); pilotimi i instrumenteve sipas ICF (International classification of functioning children & youth) për nxënësit me aftësi të kufizuara në shtatë komuna dhe 14 shkolla; përcjellja e shkollave për zbatimin e legjislacionit për të riatdhesuarit, mbështetja e shkollave për parandalim të braktisjes dhe mos-regjistrimit të nxënësve në arsimin para-universitar; vazhdimi i trajnimeve për mësimdhënësit dhe psikologë lidhur me fëmijët me dhunti të veçanta.

**c. Aktivitetet e planifikuara për 2020:**

- 1) Rishikimi i programeve të klasave 4, 9; (MASHT); Hartimi i programeve mësimore për klasën e 5 (MASHT)
- 2) Zbatimi i kurrikulës bërthamë për edukim në fëmijërinë e hershme mosha 0 – 5 vjeç në të gjitha institucionet parashkollore; Ndërtimi i 1 objekti për institucionet parashkollore;
- 3) Trajnimi i 3000 mësimdhënësve për zbatimin e kurrikulës bërthamë për klasat, parafillor, 1, 6, 10 në arsimin e përgjithshëm dhe profesional;

- 4) Vlerësimi i performancës së mësimdhënësve (15 %) sipas gradimit në sistemin e licencimit;
- 5) Rifreskimi i katalogut të trajnimeve sipas kriterëve të përcaktuara në Kornizën strategjike për zhvillimin e mësimdhënësve;
- 6) Mbikëqyrja dhe vlerësimi i zbatimit të procesit të licencimit të mësimdhënësve.
- 7) Vlerësimi i nxënësve për nivelin 5, testi i nivelit/, 9 testi i arritshmërisë dhe 12 testi i maturës, si dhe publikimi i rezultateve.
- 8) Gjithëpërfshirja në arsimin parauniversitar; përkrahja e nxënësve dhe studentëve të komuniteteve rom, ashkalinj dhe egjiptian me bursa; trajnimi i mësimdhënësve për ICF dhe ekipet vlerësuese për zbatimin e instrumentit dhe përdorimi në nivel vendi; Përcjellja e shkollave për zbatimin e legjislacionit për të riatdhësuarit; përcjellja vazhdueshme e situatës së braktisjes në vend në komuna dhe në shkolla; mbështetja e nxënësve me dhunti të veçanta me bursa dhe bashkëpunimi me organizata vendore dhe ndërkombëtare;

## **2. Ndikimi i pritshëm në konkurrueshmëri/arsyetimi i masës**

Kjo masë ndikon në përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe nxënies, në përgatitjen e nxënësve për jetë. Masa gjithashtu ndikon në rritjen e investimeve dhe në zhvillimin ekonomik duke u mbështetur në zbatimin e Kurrikulës bazuar në kompetenca. Gjithashtu përmirëson rritjen e përfshirjes në arsimin para-universitar, që ndikon edhe në cilësinë në arsim dhe në minimizimin e pabarazive në shoqëri, luftimin e diskriminimit, shmangien e marginalizimit dhe të përjashtimit, si dhe sigurimin e mirëqenies për të gjithë.

## **3. Kostoja e vlerësuar e aktiviteteve dhe ndikimi buxhetor**

Kostoja e planifikuar për aktivitete e paraqitura në masën Zhvillimi dhe zbatimi i Kurrikulës bazuar në kompetenca, mbështetur në resurse mësimore cilësore është planifikuar në draft buxhet për vitin 2018, për realizimin e aktiviteteve për vitin 2018 janë planifikuar 300.000 Euro nga buxheti i Kosovës për zbatim të kurrikulës. Për realizimin e aktiviteteve për vitin 2018 për përmirësimi i sistemit të karrierës për mësimdhënës është e planifikuar €700,000 nga Buxheti i Kosovës. Kurrikula bërthamë për edukimin parashkollor 39000 + 39000+ 39000 (vitet 2018-2019-2020 nga MASHT dhe nga donatorët 45000 për vitet 2018 dhe 2019; 2)Ndërtimi i objekteve për institucionet parashkollore - 5,358,168.40 nga BK dhe 4,000,000.00 nga donatorët; 3) Hartimi i instrumentit të ICF – 20,000,00 për vitet 2018-2019 nga BK dhe donatorët; Trajnimi i mësimdhënësve për arsim gjithëpërfshirës: 53,000.00 euro për vitet 2018-2019 nga BK dhe donatorët.

## **4. Ndikimi pritshëm në punësim dhe çështje gjinore**

Kjo masë në aspektin afatgjatë ndikon zbatimin e reformës dhe në ngritjen e cilësisë së arsimit në tërë territorin e Kosovës. Kjo masë në aspektin afatgjatë rrit mundësitë e avancimit të mësimdhënësve pa dallime gjinore punësim dhe cilësinë e zbatimit të reformës në sistemit arsimor, i cili do të përmirësojë cilësinë e fuqisë punëtore dhe kontribuojë në rritjen e investimeve dhe zhvillim ekonomik për 40 % të mësimdhënësve të trajnuar për këtë qëllim ose të graduar duke u bazuar në planifikimin e buxhetit për pagat nga punëdhënësi apo DKA-ja. Gjithashtu në aspektin afatgjatë rrit përfshirjen më të madhe në arsimin para-universitar, mundësinë e punësimit, çështjet gjinore, fuqisë punëtore, rritjen e investimeve dhe zhvillimin ekonomik. Arsimi, përveç që përmirëson mirëqenien e shoqërisë, është mjet për parandalimin e varfërisë, për mbrojtjen e fëmijëve nga puna eksploatuese, dhe për integrimin e personave me aftësi të

kufizuara në shoqëri, minimizimin e pabarazive në shoqëri, luftimin e diskriminimit, shmangien e marginalizimit dhe të përjashtimit, si dhe sigurimin e mirëqenies për të gjithë pjesëtarët e shoqërisë.

## **5. Rreziqet e mundshme**

Mos qëndrueshmëria deri në përfundim të ciklit të reformës, mos mobilizimi i mekanizmave për zbatim të Kurrikulës si MASHT, DKA, Shkollë, Prind, kapacitete të kufizuara për zbatim në nivel komunal, koordinimi në nivel qendror dhe lokal.

## **Masa e reformës #18: Ngritja e cilësisë dhe konkurrueshmërisë në Arsimin e Lartë**

### **1. Përshkrimi i masës**

Përmes kësaj mase do të nxitet konkurrueshmëria ndërmjet IAL. Sistemi potencial i rankimit do të jetë një mjet i qartë i vendim-marrjes, do të përmirësojë transparencën në IAL dhe do ta bëjë raportimin më kuptimplotë për universitetet. Një sistem i rankimit i projektuar mirë përmirëson punësueshmërinë e të rinjve. Rankimi mund të përdoret si mjet objektiv për zhvillimin dhe implementimin e politikave duke përfshirë financimin e bazuar në cilësi. Gjithashtu, do të avancohen/ zhvillohen mekanizmat për sigurimin e cilësisë në arsimin e lartë, SMIAL pas pilotimit të bërë më 2017 do të jetë plotësisht funksional dhe të dhënat nga ky sistem do të shfrytëzohen për politikëbërje në arsimit, programet e studimit të arsimit të lartë janë në përputhje me kërkesat e tregut të punës dhe shërbimet për orientim në karrierë janë funksionale. Kjo masë ndërlikohet me SKZH, PSAK, ERA, PKZMSA dhe KASH.

#### **a. Aktivitetet e planifikuara për 2018**

- 1) Rishikimi dhe kompletimi i infrastrukturës ligjore të arsimit të lartë;
- 2) Funksionalizimi i Sistemit të Menaxhimit të Informatave në Arsimin e Lartë, MASHT dhe AKA, IAL publike dhe private;
- 3) Inicimi i procesit të zhvillimit të sistemit të rankimit për IAL (formimi i njësive për menaxhimin e sistemit të rankimit);
- 4) Rritja e pjesëmarrjes në programet ndërkombëtare për arsim të lartë dhe kërkime shkencore.

#### **b. Aktivitetet e planifikuara për 2019**

- 1) Zbatimi i infrastrukturës ligjore të arsimit të lartë;
- 2) Funksionalizimi i Sistemit të Menaxhimit të Informatave në Arsimin e Lartë, MASHT dhe AKA, IAL publike dhe private dhe OJQ;
- 3) Vazhdimi i zhvillimit të mekanizmave të cilësisë në arsimin e lartë;
- 4) Zhvillimi i formulës së financimit të institucioneve publike të arsimit të lartë;
- 5) Rritja e pjesëmarrjes në programet ndërkombëtare për arsim të lartë dhe kërkime shkencore.

#### **c. Aktivitetet e planifikuara për 2020**

- 1) Vazhdimi i funksionalizimit të plotë të Sistemit të Menaxhimit të Informatave në Arsimin e Lartë - MASHT dhe AKA, IAL publike dhe private dhe OJQ;
- 2) Vazhdimi i zhvillimit të mekanizmave të cilësisë në arsimin e lartë;
- 3) Rritja e pjesëmarrjes në programet ndërkombëtare për arsim të lartë dhe kërkime shkencore.

### **2. Ndikimi i pritshëm në konkurrueshmëri/arsyetimi i masës**

Zbatimi i kësaj mase do t'i kontribuoj ngritjes së cilësisë, rritjes së konkurrueshmërisë dhe rritjes së transparencës në IAL. Përmirëson qasjen publike ndaj informacionit objektiv për punësueshmërisë në vend ndërkombëtarizimin e arsimit të lartë, rritjen e konkurrueshmërisë dhe rritjen e transparencës, në përmirësimin e qasjes publike ndaj informacionit objektiv për punësueshmërisë në vend dhe mund të përdoret si mjet vendimmarrës për politika institucionale, duke e përfshirë financimin e bazuar në cilësi. Gjithashtu, të gjitha këto veprime kontribuojnë në përafrimin e arsimit të lartë në sferën Evropiane të AL.

### **3. Kostoja e vlerësuar e aktiviteteve dhe ndikimi buxhetor**

Për zhvillimin e mekanizmave të cilësisë në arsimin e lartë (formimi i njësive për menaxhimin e sistemit të rankimit) për vitin 2018- 41800 Euro (donatorët); 2019 - 27, 550.00 Euro; 2020 - 152,840.00 Euro; 2,000.00 Euro për SMIAL nga BK për 2018, 2019 dhe 2020. Buxheti i bursave; CEEPUS 20,000 për çdo vit (2018/2019/2020) për programin e mobilitetit, Programi Fulbright për studime në SHBA nga BK nga 300,000 EUR për çdo vit (2018/2019/2020) – Programi i Bursave të Sheffield nga BK, nga 298,478.00 Euro për çdo vit (2018/2019/2020), Programi ERASMUS + nga BK nga 50,000 (2018/2019/2020)

### **4. Ndikimi i pritur në punësim dhe çështje gjinore**

Fokusi kryesor është krijimi i sistemit për analizën e tregut të punës në nivel nacional, rajonal dhe lokal për krijimin e mekanizmave për një parashikim të shkathtësive sektoriale, në bazë të sondazheve të punëdhënësve dhe punëmarrësve, për tu plotësuar kërkesën aktuale për ofrues të arsimit të lartë, për ata që diplomojnë dhe për pjesëmarrësit në tregun e punës. Informatat e mbledhura për tregun e punës duhet të përfshijnë mekanizmat për të vlerësuar qasjen, pjesëmarrjen dhe përfaqësimin e femrave dhe meshkujve në tregun e punës, si dhe masat e mundshme që mund të ndërmerren për të zbutur çfarëdo mospërputhje

### **5. Rreziqet e mundshme**

Mospunësueshmëria e të diplomuarve për shkak të problemeve strukturore ekonomike të sektorit publik dhe privat në Kosovë.

## **4.3.8 PUNËSIMI DHE TREGU I PUNËS**

### **a. Analiza e pengesave kryesore**

**Gjendja aktuale:** Të dhënat e Anketës së Fuqisë Punëtore (AFP) për vitin 2016 tregojnë se me gjithë pjesëmarrjen e ulët në tregun e punës në vitin 2016 norma e papunësisë në Kosovë ishte 27.5%<sup>14</sup>. Për femrat (31.8%) në krahasim me meshkujt (26.2%). Përgjatë vitit 2016, nga totali i popullsisë në moshë pune 28.0% ishin të punësuar. Shkalla e punësimin ishte më e lartë për meshkuj se sa për femra: 43.0 % të meshkujve në moshë pune ishin të punësuar krahasuar me 12.7 % të femrave po ashtu në moshë pune. Krahasuar me AFP-së 2015 në Kosovë, kemi rritje të shkallë së punësimin me 2.8 %, ku kjo rritje të meshkujt ishte 4.3 % përderisa të femrat është 1.2%. Me gjithë indikacionet për përmirësim të treguesve të punësimin dhe papunësisë në bazë të dhënave për vitin 2016<sup>15</sup>, papunësia mbetet sfida kryesore ekonomike e sociale në vend, dhe situata në tregun e punës është posaçërisht e vështirë për gratë dhe të rinjtë. Kështu, bazuar në rezultatet e AFP 2016, treguesit e tregut të punës për gratë kosovare janë shumë më të ulëta në krahasim me ato të vendeve të rajonit dhe të BE-së . Gratë kanë pjesëmarrje më se tri herë më të

<sup>14</sup> Agjencia e Statistikave të Kosovës, Rezultatet e anketës së fuqisë punëtore 2016 në Kosovë, publikuar me dt.15.05.2017.

<sup>15</sup> Sipas AFP, norma e papunësisë ishte 27.7 në tremujorin e parë (TM1) dhe 26.2 në tremujorin e dytë (TM2), ndërsa norma e punësimin 25.5 dhe 27.9, respektivisht. Agjencia e Statistikave të Kosovës, Anketa e fuqisë punëtore TM1 2016, 2017; dhe Anketa e fuqisë punëtore TM2 2016, 2017.

ulët në tregun e punës, dhe kanë normë më të lartë të papunësisë.<sup>16</sup> Dallimet gjinore në punësim dhe pjesëmarrje në tregun e punës reflektojnë dallimet në nivel të arsimimit dhe përvojës së punës (që janë pjesërisht të lidhura me njëra-tjetrën), dhe normat shoqërore e stereotipet gjinore për rolin e gruas në familje<sup>17</sup>.

Shkalla e pasivitetit është 61.3% (përqindja e popullsisë që nuk bën pjesë në fuqinë punëtore) me shkallën më të lartë në mesin e femrave (81.4%), ndërsa 42.7% për meshkuj.<sup>18</sup> Niveli i të punësuarve në punë të paqëndrueshme, personat që janë të vetëpunësuar dhe nuk kanë punonjës si dhe ata që punojnë pa pagesë në një biznes familjar është 22.9%, kryesisht mbetet e njëjtë me vitin paraprak (22.8% në vitin 2015). Sektorët kryesorë të punësimin janë prodhimi, tregtia, arsimit dhe ndërtimtaria.

Papunësia tek të rinjtë në vitin 2015, ka rënë në 57,7%, ku në bazë të AFP 2016, papunësia për grup moshën 15-24 qëndroi në 52.4%. Pjesa e të rinjve joaktivë që nuk janë të punësuar ose duke ndjekur shkollim/trajnim (NEET) është ulur gjatë viteve të fundit (31.1% në vitin 2016, tek femrat është 34.2%, ndërsa te meshkujt është 26.5%, 28.3% në vitin 2015, nga 35.3 në vitin 2013), që në një masë reflekton ngritjen e pjesëmarrjes në arsim të lartë me hapjen e universiteteve të reja publike dhe ofruesve privatë të arsimit të lartë.<sup>19</sup> Rezultatet e dobëta të punësimin tek të rinjtë vijnë si pasojë e shumë faktorëve: (i) cilësisë së arsimit në të gjitha nivelet dhe mospërputhjes së programeve arsimore me kërkesat e tregut, (ii) mungesës e punës praktike në shkollë dhe ndërmarrje, që është posaçërisht e rëndësishme në rastin e arsimit profesional, (iii) informatave të kufizuara mbi kërkesat e tregut të punës, (iv) mungesës së këshillimit dhe orientimit në karrierë<sup>20</sup>, dhe (v) mungesës së përvojës së punës dhe kontakteve (rrjetëzimit) me punëdhënës potencialë, që lidhet edhe me mungesën e punës praktike të lartcekur, të cilat e bëjnë të vështirë tranzicionin nga shkolla në punë.

Shkalla e papunësisë për personat me arsim të lartë është 15.6% në vitin 2012, krahasuar me 44.6% për ata me arsim fillor, 28% për të diplomuarit e shkollave të mesme profesionale dhe 38.8% për ata me arsim të mesëm të përgjithshëm. Personat me arsim të mesëm profesional kanë më shumë gjasa të jenë të punësuar në sektorin privat sesa në sektorin publik, dhe e kundërta është për ata që kanë përfunduar arsimin e lartë (34.8% e të diplomuarve në arsimin e mesëm profesional janë të punësuar në sektorin publik, krahasuar me një mesatare prej 47.6 % për ata me arsim të lartë).

**Pengesat dhe problemet kryesore strukturore:** Në përgjithësi, norma e lartë e popullsisë joaktive është një pengesë serioze në shfrytëzimin e burimeve potenciale njerëzore për rritje ekonomike dhe fuqizimin e konkurrueshmërisë. Kjo është si pasojë e kërkesës së ulët për punë për shkak të zhvillimit të ulët ekonomik; mospërshtatja e nevojave të tregut me shkathtësitë e ofruara nga sistemi formal dhe profesional i edukimit; mos-zhvillimi adekuat i sistemit të aftësimin profesional, duke përfshirë integrimin e mësimin me punë, mospërputhje e përmbajtjes së kurrikulave me nevojat e tregut; norma e ulët e pjesëmarrjes në fuqi punëtore (41.6% në vitin 2014); pjesëmarrje për femrat është edhe më e ulët (21.4%);

<sup>16</sup> Instituti Demokracia për Zhvillim, Kosto e patriarkatit, 2015.

<sup>17</sup> Banka Botërore, Hendeku Gjinor në Arsim, Shëndetësi dhe Mundësit Ekonomike, Njësinë e Menaxhimit Ekonomik dhe Reduktimin e Varfërisë e Bankës Botërore, Raporti Nr. 75930-KV, 2015

<sup>18</sup> Agjencia e Statistikave të Kosovës, Rezultatet e anketës së fuqisë punëtore 2016 në Kosovë, publikuar me dt.15.05.2017.

<sup>19</sup> Agjencia e Statistikave të Kosovës, Rezultatet e anketës së fuqisë punëtore 2015 në Kosovë, 2016.

<sup>20</sup> Sfidat e paraqitura në lidhje me sistemin arsimor reflektojnë edhe Planin Strategjik për Arsimin në Kosovë 2017-2021 dhe Strategjinë e Edukimit dhe Orientimit në Karrierë 2015-2019 nga MASHT.



Ekziston një nivel i konsiderueshëm i remitencave, ku disa sipas studimeve (p.sh. anketa e UNDP për remitencat) nënvizojnë se ato në mënyrë potenciale dekurajojnë pjesëmarrjen në tregun e punës. Sa i përket shërbimeve të punësimit, sfidat kryesore konsistojnë në mungesë të stafit dhe kapaciteteve në zyrat e punësimit – Mesatarja kosovare e shkallës së stafit në raport me punëkërkuarët është 11106 punëkërkuarë për një këshilltar.

**Ndikimi i pengesave strukturore:** Ekzistenca e informalitetit në sektorin e punësimit ndikon në mungesë të mbrojtjes së punëtorëve, në përgjithësi. Kapacitetet e dobëta të shërbimeve të punësimit pamundësojnë lidhjen efektive të punëkërkuarëve me punëdhënësit, ofrimin e trajnimeve dhe lehtësirave të tjera të punësimit. Mospërshtatja ndërmjet shkathtësive dhe tregut të punës ka ndikim të konsiderueshëm negativ në konkurrueshmëri dhe rritje ekonomike, në veçanti për faktin se prodhon fuqi punëtore jo-adekuate që drejtpërdrejt ndikon në cilësinë dhe sasinë e investimeve në ekonomi. Gjithashtu, nëse mospërshtatja është e lartë mund të ketë papunësi strukturore. Shkalla e lartë e papunësisë strukturore (të rinjve) rezulton në barrë për financat publike, varësi të lartë të të rinjve në skema mbështetëse, që ndikon në potencialin e rritjes ekonomike afatgjatë.

## **b. Planet e reformave prioritare**

### **Masa e reformës #19: Rritja e qasjes së të rinjve dhe grave në tregun e punës përmes ofrimit të shërbimeve cilësore të punësimit, masave aktive të punësimit dhe ndërmarrësisë**

#### **1. Përshkrimi i masës**

Kjo masë siguron vazhdimin e reformave të ndërmarrura në vitet e kaluara, lidhur me përmirësimin e kapaciteteve të shërbimeve publike të punësimit. Masa synon përmirësimin e shërbimeve për punëkërkuarët, të papunët dhe punëdhënësit. Prioritet kryesor i kësaj mase është funksionalizimi i plotë i Agjencisë së Punësimit të Republikës së Kosovës, si dhe ofrimi i shërbimeve cilësore për ndërmjetësim në punësim dhe aftësim profesional si dhe zgjerimin e masave aktive në tregun e punës si: punë publike, subvencionim i pagave, vetëpunësim, promovim i ndërmarrësisë, praktika në punë apo trajnime në punë. Kjo masë është në përputhje me SKZH-në, KASH dhe PKZMSA-së.

#### **a. Aktivitetet e planifikuara për 2018**

- 1) Realizimi i një studimi, për identifikimin e sektorëve (në nivel lokal) me potencial për punësimin e të rinjve (EUR 4000, donatorët);
- 2) Funksionalizimi i plotë i APRK-së (përfshi plotësimin me staf, përmirësimin e infrastrukturës fizike;
- 3) Ngritja e kapaciteteve të mëtutjeshme të APRK për të dizajnuar, zbatuar, monitoruar dhe vlerësuar masat aktive të tregut të punës –
- 4) Implementimi i masave aktive të tregut të punës për grupet në fokus (rritja e ndërmjetësimeve në MATP për 11% si dhe zhvillimi dhe implementimi i programit të vetëpunësimit dhe ndërmarrësisë
- 5) Modernizimi i programeve dhe shërbimeve të ofruara të aftësimin profesional, përfshirë: ri-validimi i profileve aktuale, zhvillimi i 5 standardeve të reja, 5 kurrikula dhe 5 paketa mësimore, akreditimi i 7 Qendrave të Aftësimin Profesional për njohjen e mësimin paraprak, furnizimin e kabinetëve me pajisje moderne, ngritja e kapaciteteve dhe zgjerimi i shërbimeve cilësore në aftësimin profesional, duke u fokusuar tek grupet në fokus;

- 6) Zhvillimi i modulit për ofrimin e shërbimeve për migracionin të punësimit, si dhe modulit për orientim në karrierë në kuadër të SITP-se;
- 7) Mbështetja e nismave për punë vullnetare, me kontribut në punësimin e të rinjve
- 8) Praktika në punë për të sapo diplomuarit nga arsimi i lartë (KIESA),

**b. Aktivitetet e planifikuara për 2019**

- 1) Funkcionalizimi i plotë i APRK-së (përfshi plotësimin me staf, përmirësimin e infrastrukturës fizike –
- 2) Ngritja e kapaciteteve të mëtutjeshme të MPMS dhe APRK për të dizajnuar, të zbatuar, monitoruar dhe vlerësuar masat aktive të tregut të punës;
- 3) Validimi i profileve, zhvillimi i 15 standardeve, 15 kurrikula dhe 15 paketa mësimore;
- 4) Implementimi i masave aktive të tregut të punës për grupet në fokus (rritja e ndërmjetësimeve në MATP për 13% si dhe zhvillimi dhe implementimi i programit të vetëpunësimit dhe ndërmarrësisë;
- 5) Mbështetja e nismave për punë vullnetare, me kontribut në punësimin e të rinjve (MKRS);
- 6) Praktika në punë për të sapo-diplomuarit nga arsimi i lartë (KIESA),

**c. Aktivitetet e planifikuara për 2020**

- 1) Validimi i profileve, zhvillimi i 10 standardeve, 10 kurrikula dhe 10 paketa mësimore;
- 2) Zgjerimi dhe implementimi i masave aktive të tregut të punës për grupet në fokus; Ngritja e mëtejme e kapaciteteve dhe zgjerimi i shërbimeve cilësore në aftësim profesional, duke u fokusuar tek grupet e marginalizuara;
- 3) Mbështetja e nismave për punë vullnetare, me kontribut në punësimin e të rinjve (MKRS);
- 4) Praktika në punë për të sapo diplomuarit nga arsimi i lartë (KIESA);

**2. Kostoja e vlerësuar e aktiviteteve dhe ndikimi buxhetor**

**2018: 1)** Realizimi i një studimi, për identifikimin e sektorëve (në nivel lokal) me potencial për punësimin e të rinjve (EUR 4000, donatoret);

2) Funkcionalizimi i plotë i APRK-së (përfshi plotësimin me staf, përmirësimin e infrastrukturës fizike - 1.097 000 EUR; 3) Ngritja e kapaciteteve të mëtutjeshme të APRK për të dizajnuar, zbatuar, monitoruar dhe vlerësuar masat aktive të tregut të punës – 500, 000 EUR

4) Implementimi i masave aktive të tregut të punës për grupet në fokus (rritja e ndërmjetësimeve në MATP për 11% si dhe zhvillimi dhe implementimi i programit të vetëpunësimit dhe ndërmarrësisë – per 2018 është 2,391,600 BK dhe 2,422,100 Donatoret

5) Modernizimi i programeve dhe shërbimeve të ofruara të aftësimin profesional, përfshirë: ri-validimi i profileve aktuale, zhvillimi i 5 standardeve të reja, 5 kurrikula dhe 5 paketa mësimore, akreditimi i 7 Qendrave të Aftësimin Profesional për njohjen e mësimin paraprak, furnizimin e kabineteve me pajisje moderne, ngritja e kapaciteteve dhe zgjerimi i shërbimeve cilësore në aftësim profesional, duke u fokusuar tek grupet në fokus- 600,000 EUR nga donatoret dhe 50,000 nga BK; 6) Zhvillimi i modulit për ofrimin e shërbimeve për migracionin të punësimit, si dhe modulit për orientim në karrierë në kuadër të SITP-se – 100 000 nga Donatorët; 7)

Mbështetja e nismave për punë vullnetare, me kontribut në punësimin e të rinjve - (MKRS 10,000 EUR dhe 20,000EUR Donatorët); 8) Praktika në punë për të sapo diplomuarit nga arsimi i lartë (KIESA 31, 200 EUR)

### **Kostoja e vlerësuar e aktiviteteve për vitin 2019**

1) Funkcionalizimi i plotë i APRK-së (përfshi plotësimin me staf, përmirësimin e infrastrukturës fizike - 1.097 000; 2) Ngritja e kapaciteteve të mëtutjeshme të MPMS dhe APRK për të dizajnuar, të zbatuar, monitoruar dhe vlerësuar masat aktive të tregut të punës – 500, 000 nga donatorët; 3) Validimi i profileve, zhvillimi i 15 standardeve, 15 kurrikula dhe 15 paketa mësimore 50, 000 EUR nga donatorët dhe 50,000 nga BK; 4) Implementimi i masave aktive të tregut të punës për grupet në fokus (rritja e ndërmjetësimeve në MATP për 13% si dhe zhvillimi dhe implementimi i programit të vetëpunësimit dhe ndërmarrësisë –2,391,600 nga BK, dhe 2,421,000 nga Donatorët; 5) Modernizimi i programeve dhe shërbimeve të ofruara të aftësisimit profesional, përfshirë: ri-validimi i profileve aktuale, zhvillimi i 5 standardeve të reja, 5 kurrikula dhe 5 paketa mësimore, akreditimi i 7 Qendrave të Aftësisimit Profesional për njohjen e mësimin paraprak, furnizimin e kabineteve me pajisje moderne, ngritja e kapaciteteve dhe zgjerimi i shërbimeve cilësore në aftësim profesional - 500,000 nga donatorët dhe 50,000 nga BK; 6) Mbështetja e nismave për punë vullnetare, me kontribut në punësimin e të rinjve (MKRS 10,000 EUR; Donatorët 20,000EUR); 7) Praktika në punë për të sapo-diplomuarit nga arsimi i lartë (KIESA 31,200 EUR);

### **Kostoja e vlerësuar e aktiviteteve për vitin 2020**

1) Validimi i profileve, zhvillimi i 10 standardeve, 10 kurrikula dhe 10 paketa mësimore 500, 000 EUR nga donatorët dhe 50,000 nga BK; 2) Zgjerimi dhe implementimi i masave aktive të tregut të punës për grupet në fokus; Ngritja e mëtejme e kapaciteteve dhe zgjerimi i shërbimeve cilësore në aftësim profesional, duke u fokusuar tek grupet e marginalizuara; (2,391,600 EUR nga BK dhe 2,421,000 nga Donatorët); 3) Validimi i profileve, zhvillimi i 10 standardeve, 10 kurrikula dhe 10 paketa mësimore - 400 000 nga donatorët dhe 50,000 nga BK; 4) Mbështetja e nismave për punë vullnetare, me kontribut në punësimin e të rinjve (MKRS. 20,000 EUR , Donatorët 15,000 EUR); 5) Praktika në punë për të sapo diplomuarit nga arsimi i lartë (KIESA, 31,200 EUR);

### **3. Ndikimi i pritshëm në konkurrueshmëri/arsyetimi i masës**

Ngritja e kapaciteteve të Shërbimeve publike të punësimit pritet të përmirësojë shërbimet të cilat do të rrisin punësimin e punëkërkuësve. Kjo masë ka për qëllim rritjen e qasjes në tregun e punës si dhe mundësive për punësim të qëndrueshëm përmes një game të zgjeruar të Masave të ndryshme aktive të punësimit që fokusojnë rinjtë, gratë, njerëzit me aftësi të kufizuara, grupet minoritare, por edhe individët që kanë për qëllim të krijojnë bizneset e tyre.

### **4. Ndikimi i pritshëm në punësim dhe çështje gjinore**

Ngritja e kapaciteteve të Shërbimeve publike të punësimit pritet të përmirësojë shërbimet të cilat do të rrisin punësimin e punëkërkuësve. Kjo masë ka për qëllim rritjen e qasjes në tregun e punës si dhe mundësive për punësim të qëndrueshëm përmes një game të zgjeruar të Masave të ndryshme aktive të punësimit që fokusojnë rinjtë, gratë, njerëzit me aftësi të kufizuara, grupet minoritare, por edhe individët që kanë për qëllim të krijojnë bizneset e tyre. Kjo masë fokusohet në zgjerimin e mundësive për punësim veçanërisht për grupet e cenueshme, si dhe synon gjithashtu të reduktojë varësinë nga skemat sociale. Ndikim tjetër pozitiv është aktivizimi i fuqisë punëtore e cila është pasive për shkak të papunësisë dhe njëkohësisht përfiton asistencë

sociale. Përfituesit e skemave sociale, do të përfshihen në masat aktive të punësimit, dhe përfitojnë nga këto skema, duke u rikyqur në tregun e punës.

#### **4.3.9. PËRFSHIRJA SOCIALE, ULJA E VARFËRISË DHE MUNDËSITË E MUNDËSITË E BARABARTA**

##### **a. Analiza e pengesave kryesore**

**Gjendja aktuale:** Sipas Anketës së Buxhetit të Ekonomive Familjare (ABEF) të vitit 2015, vlerësohet se 17.6% e popullsisë së Kosovës jeton nën kufirin e varfërisë (21.1 % në vitin 2014), me 1.82 euro në ditë dhe se 5.2 % e popullsisë jeton nën kufirin e varfërisë së skajshme.<sup>21</sup> Grupet më të prekura nga varfëria paraqiten familjet që banojnë në vendbanimet rurale (73%), familjet që burim kryesor të të ardhurave kanë ndihmën sociale (70.7) dhe familjet me më shumë anëtarë (39.1%).<sup>22</sup>

Bruto prodhimi në Kosovë arrin rreth 3,300 Euro, me të cilin Kosova mbetet një nga vendet më të varfra në Evropë. Burimi më i rëndësishëm i të hyrave të ekonomive familjare sipas ABEF 2016, janë pagat nga sektori privat dhe ai publik, pastaj pensionet, të hyrat nga biznesi vetanak, si dhe remitencat, të cilat kanë pasur një rënie për 1%, krahasuar me vitin 2015. Konsumi për ekonomi familjare gjatë vitit 2016 në Kosovë ka qenë 7.539 euro, si dhe për kokë banori 1.460 Euro, një rritje e lehtë prej 0.5 % në krahasim me vitin 2015.

Përfshirja e femrave në ekonomi dhe në sfera të tjera është e ulët. Në postet udhëheqëse femrat përbëjnë 19.89% në nivelin qendror dhe 19.7% në nivelin lokal, 14.36% e femrave e përbëjnë administratën publike, ku 12% janë nga radhët e minoriteteve, pjesëmarrja e femrave në tregun e punës është 21.4%, si dhe një përfshirje e ulët e femrave vërehet edhe në vijueshmërinë e nivelit të arsimit të mesëm dhe atë superior.

Bazuar në të dhënat e Anketës së Grupimeve të Treguesve të Shumëfishtë (MICS 2013-2014), del që në Kosovë 11% e fëmijëve të moshës 5-17 vjeç janë të angazhuar në punë (17% e fëmijëve janë të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian).<sup>23</sup>

Sipas rezultateve të anketës me qytetare, 86% e pacienteve janë duke paguar për barna, 59,5% për bashkëpagesa, 33,4% kanë paguar për materiale mjekësore, 31,9% për konsultime (duke përfshirë edhe sektorin privat), 17,3% për çështje të tjera dhe 10% kanë paguar për ushqim. Në përgjithësi, 88,4% e të gjithë pacienteve të cilët kërkojnë përkujdesje në institucione shëndetësore kanë paguar nga xhepi. Supozohet se pothuajse 1/3 e popullatës nuk kanë qasje të lehtë në kujdesin shëndetësor, ose kanë vetëm qasje të kufizuar për shkak të mungesës së parave, ndërkaq, 18% e popullatës nuk kërkon shërbime edhe në rast të sëmundjes, për shkak ekonomike. Për shërbimet specifike me theks të veçantë për shërbimet e kardiologjisë dhe kardiokirurgjisë qytetarët drejtohen tek vendet fqinje për marrjen e këtyre shërbimeve, dhe sipas vlerësimit shpenzohen rreth 80 milion euro në këtë drejtim.

**Pengesat dhe problemet kryesore strukturore:** Numri i qytetarëve dhe i familjeve që kanë nevojë për mbrojtje sociale, kujdes shëndetësor dhe shërbime tjera të kësaj natyre vazhdon të mbetet i lartë. Edhe përkundër faktit se në vitin 2017 janë bërë përpjekje për fillimin e mbledhjes së premiumeve për sigurime shëndetësore, me qëllim të plotësimit të kornizës ligjore si dhe

<sup>21</sup>Banka Botërore/ASK (Prill 2017) "Varfëria në konsum në Republikën e Kosovës në periudhën 2012-2015"; Shih: <http://ask.rks-gov.net/media/3186/stat-e-varferise-2012-2015.pdf>

<sup>22</sup>Banka Botërore/ASK (Prill 2017) "Varfëria në konsum në Republikën e Kosovës në periudhën 2012-2015"; Shih: <http://ask.rks-gov.net/media/3186/stat-e-varferise-2012-2015.pdf>

<sup>23</sup><http://ask.rks-gov.net/sq/agjencia-e-statistikave-te-kosoves/add-ne-es/treguesit-kryesore-te-anketes-se-grupimeve-te-treguesve-te-shumefishte-e-njohur-si-mics>

funksionalizimit të mëtutjeshëm të Fondit të Sigurimeve shëndetësore është shtyrë procesi i mbledhjes së premieeve me vendim të Qeverisë Nr.07/148 e datës 30.06.2017.

Sfida në vete mbeten mirëmbajtja dhe avancimi i një sistemi të mbrojtjes sociale dhe i kujdesit shëndetësor, mos-sinkronizimi i mjaftueshëm i politikave të përkrahjes sociale, pengesa për të adresuar çështjet e përjashtimit social dhe gjithë-përfshirjes. Sistemi i mbrojtjes sociale, në kombinim me politikat e tjera në nivel Ministrie dhe Qeverie, duhet të përmirësojë më mirë targetimin e grave dhe vajzave në nevojë, të personave me aftësi të kufizuar, duke përfshirë edhe komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian, të papunët afatgjatë dhe grupet e tjera të rrezikuara.

**Ndikimi i pengesave në konkurrueshmëri:** Pabarazia në të ardhura, në arsim, shëndetësi dhe punësim janë faktorë me rëndësi për rritje ekonomike dhe zhvillim. Duke u bazuar në pengesat e identifikuar, pabarazitë në të ardhura minojnë performancën e ekonomisë në periudhën afatgjatë. Kjo ndërlikohet me dy aspekte: pabarazitë e nivelit të lartë pengojnë rritjen ekonomike dhe gjithashtu ndikon në rezultatin e arsimit, ku si rrjedhojë mund të ndikojë në përgjithësi në kapitalin njerëzor të vendit. Niveli i lartë i varfërisë rrit faturën e sistemit të mirëqenies, kurse sistemi joefikas i shëndetësisë ndikon negativisht në perspektivën e rritjes ekonomike në mënyrë indirekte përmes shpenzimeve të larta që jo domosdoshmërisht përkthehen në rezultate të pritura.

## **b. Planet e reformave prioritare**

### **Masa e reformës #20: Përmirësimi i shërbimeve shëndetësore dhe sociale**

#### **1. Përshkrimi i masës**

Kjo masë ka qenë edhe pjesë e PRE 2017, por aktivitetet e saj kanë hasur në vështirësi zbatimi prandaj janë bartur më tej këtë vit. Është shtyrë procesi i mbledhjes së premieeve me vendim të Qeverisë Nr.07/148 e datës 30.06.2017. Mosmiratimi i legjislacionit të nevojshëm për zbatimin e ligjit të sigurimeve shëndetësore ka ndikuar në mos përcaktimin e kategorive që do të lirohen nga pagesa e sigurimit shëndetësor, po ashtu është shtyrë ndryshimi i Ligjit për Financat e Pushtetit lokal, me qëllim që të përfshijë formulën dhe Grantin Specifik për Shërbime Sociale. Edhe përkundër vonesave, kjo masë është në proces të zbatimit dhe mbetet prioritare. Synim i masës së propozuar është fuqizimi i sistemit të mbrojtjes sociale përmes përmirësimit të shërbimeve shëndetësore dhe sociale. Qëllimi i masës është funksionalizimi i mëtutjeshëm i infrastrukturës institucionale për krijimin e fondit të sigurimeve shëndetësore, duke përfshirë lirin nga pagesa e sigurimit shëndetësor për grupet e targetuara në pajtim me Ligjin e Sigurimeve Shëndetësore. Fokusi do të vihet edhe në sigurimin e shërbimeve konsultative të specialisteve në të gjitha Qendrat Kryesore të Mjekësisë Familjare për të siguruar qasje më të mirë në këto shërbime të gjithë qytetarëve të Kosovës, ofrimin e kujdesit shëndetësor shtëpiak, ofrimin e shërbimeve shëndetësore kardio-kirurgjike si dhe shërbimeve shëndetësore në institucionet shkollore dhe parashkollore. Më tej, kjo masë fokusohet në përcaktimin e sistemit të qëndrueshëm për financimin e shërbimeve sociale dhe përafrimin e legjislacionit nga fusha e politikave sociale me *Acquis* të BE-së. Në këtë drejtim, MPMS ofron mbështetje të projekteve të OJQ-ve të licencuara nga MPMS-ja si dhe me fondet e BE-së.

**a. Aktivitetet e planifikuara për 2018:** 1) Shtrirja e Platformës së Sistemit të Informimit të Fondit të Sigurimeve Shëndetësore; 2) Fuqizimi i kapaciteteve administrative në Fondin e Sigurimeve shëndetësore përmes punësimit të 24 zyrtarëve; 3) Aplikimi i ofrimit të shërbimeve shëndetësore në shtëpi dhe miratimi i pakos bazike të shërbimeve shëndetësore; 4) Fuqizimi i kapaciteteve për ofrimin e shërbimeve kardilogjike dhe kardiokirurgjike; 5) Hartimi i kornizës ligjore dhe operative për fillimin e zbatimit të Testit të Varfërisë të kategorive sociale, për lirim nga pagesa e premieeve për Sigurime Shëndetësore; 6) Përgatitja e studimit dhe analizës për

rishikimin e Skemës së Ndhmës Sociale; 7) Hartimi i koncept dokumentit për rregullimin e fushës së shërbimeve sociale; 8) Dizajnimi i formulës së financimit (granti specifik) dhe kriterëve për alokimin e buxheteve për shërbime sociale nga komunat; 9) hartimi i kornizës ligjore sekondare dhe operative për zhvillimin e ndërmarrësisë sociale; 10) angazhimi i përfituesve në programet trajnimit dhe punësimit;

**b. Aktivitetet e planifikuara për 2019:** 1) Funkcionalizimi i fondit të sigurimeve shëndetësore; 2) Vazhdimi i ofrimit të shërbimeve shëndetësore kardio-kirurgjike; 3) Ofrimi i shërbimeve shëndetësore në institucionet parashkollore dhe shkollore; 4) Fillimi i mbledhjes së premieeve nga të punësuarit në sektorin publik; 5) Ekzekutimi i pagesave për shërbimet e sigurimit shëndetësor për individët e siguar (vazhdon çdo vit); 6) Fillimin i zbatimit të Testit të Varfërisë të kategorive sociale, për lirim nga pagesa e premieeve për Sigurime Shëndetësore; 7) Hartimi dhe harmonizimi i legjislacionit për shërbime social dhe familjare me standardet evropiane; 8) Ngritja e kapaciteteve të komunave për zbatimin e formulës së re të granteve për shërbimet sociale; 9) Mbështetja e OJQ-ve dhe ndërmarrjeve sociale për ofrimin e shërbimeve social; 10) Krijimi i partneriteteve lokale për ofrimin e shërbimeve sociale.

**c. Aktivitetet e planifikuara për 2020:** 1) Ofrimi i shërbimeve konsultative në Kujdesin Parësor shëndetësor; 2) Ekzekutimi i pagesave për shërbimet e sigurimit shëndetësor për individët e siguar (vazhdon çdo vit); 3) Ofrimi i shërbimeve shëndetësore në institucionet parashkollore dhe shkollore; 4) Zbatimi i Testit të Varfërisë të kategorive sociale, për lirim nga pagesa e premieeve për Sigurime Shëndetësore; 5) Funkcionalizimi i skemës së granteve për financimin e projekteve nga sektori joqeveritar dhe ndërmarrjet sociale; 6) Zbatimi i programit të vetëpunësimit dhe trajnimeve profesionale për kategoritë sociale; 7) Ndërtimi i qendrave rezidenciale dhe ditore për ofrimin e shërbimeve sociale dhe familjare.

## **2. Ndikimi i pritshëm në konkurrueshmëri/arsyetimi i masës**

Pabarazitë në të ardhura, arsim, shëndetësi dhe punësim janë faktorë të rëndësishëm për rritjen dhe zhvillimin ekonomik. Bazuar në pengesat e identifikuara, pabarazitë në të ardhura dëmtojnë ecurinë e ekonomisë në periudhën afatgjatë. Niveli i lartë i varfërisë rrit koston e sistemit të mirëqenies, ndërkohë që sistemi joefikas shëndetësor ndikon negativisht në perspektivat e rritjes indirekte përmes shpenzimeve të larta që domosdoshmërisht nuk përkthehen në rezultatet e pritura.

## **3. Kostoja e planifikuar për aktivitetet gjatë vitit 2018:**

1) Shtirja e Platformës së Sistemit të Informimit të Fondit të Sigurimeve Shëndetësore - 583,942 Euro; 2) Fuqizimi i kapaciteteve administrative në Fondin e Sigurimeve shëndetësore përmes punësimit të 24 zyrtarëve - 382,000 Euro; 3) Aplikimi i ofrimit të shërbimeve shëndetësore në shtëpi 2018= EUR 130,000 dhe Miratimi i pakos bazike të shërbimeve shëndetësore (2018 - 10,000); 4) Fuqizimi i kapaciteteve për ofrimin e shërbimeve kardiologjike dhe kardiokirurgjike (2018 = 2.120,000); 5) Hartimi i kornizës ligjore dhe operative për fillimin e zbatimit të Testit të Varfërisë të kategorive sociale, për lirim nga pagesa e premieeve për Sigurime Shëndetësore - 1,000,000 Euro; 6) Përgatitja e studimit dhe analizës për rishikimin e Skemës së Ndhmës Sociale- 30,000 nga donatorët; 7) Hartimi i koncept dokumentit për rregullimin e fushës së shërbimeve sociale – 30,000 Euro nga donatoret; 8) Dizajnimi i formulës së financimit (granti specifik) dhe kriterëve për alokimin e buxheteve për shërbime sociale nga komunat – 20,000 nga donatoret; 9) Hartimi i kornizës ligjore sekondare dhe operative për zhvillimin e ndërmarrësisë sociale- 50,000 donatorët; 10) Angazhimi i përfituesve në programet trajnimit dhe punësimit – 500, 000 BK dhe 500, 000 donatorët;.

**Kostoja e planifikuar për aktivitetet gjatë vitit 2019:** Funkcionalizimi i fondit të sigurimeve shëndetësore; (2019 = 213,405 BK); 2) Ofrimi i shërbimeve shëndetësore në institucionet parashkollore dhe shkollore (2019 = 500,000 BK) dhe fillimi i mbledhjes së premieeve nga të punësuarit në sektorin publik; 3) Ekzekutimi i pagesave për shërbimet e sigurimit shëndetësor për individët e siguruar (vazhdon çdo vit) (2019 = 60,000,000 BK); 4) Fillimi i zbatimit të Testit të Varfërisë të kategorive sociale, për lirim nga pagesa e premieeve për Sigurime Shëndetësore 10,000,000 BK; 5) Hartimi dhe harmonizimi i legjislacionit për shërbime social dhe familjare me standardet evropiane – 50,000 nga donatorët; 6) Ngritja e kapaciteteve të komunave për zbatimin e formulës së re të granteve për shërbimet sociale – 45,000 nga donatorët; 7) Mbështetja e OJQ-ve dhe ndërmarrjeve sociale për ofrimin e shërbimeve sociale - 1,000,000 nga donatorët; 8) Krijimi i partneriteteve lokale për ofrimin e shërbimeve sociale - 25,000 nga donatore.

**Kostoja e planifikuar për aktivitetet gjatë vitit 2020:** 1) Ofrimi i shërbimeve konsultative në Kujdesin Parësor shëndetësor = 500,000); 2) Ekzekutimi i pagesave për shërbimet e sigurimit shëndetësor për individët e siguruar (vazhdon çdo vit) (2020 = 60,000,000 BK); 3) Ofrimi i shërbimeve shëndetësore në institucionet parashkollore dhe shkollore (2020 = 500,000); 4) Zbatimi i Testit të Varfërisë të kategorive sociale, për lirim nga pagesa e premieeve për Sigurime Shëndetësore 10,000,000 BK; 5) Funkcionalizimi i skemës së granteve për financimin e projekteve nga sektori joqeveritar dhe ndërmarrjet sociale – 500,000 BK, 500,000 nga donatorët; 6) Zbatimi i programit të vetëpunësimit dhe trajnimeve profesionale për kategoritë sociale 500,000 BK, 500,000 nga donatorët; 7) Ndërtimi i qendrave rezidenciale dhe ditore për ofrimin e shërbimeve sociale dhe familjare 500,000 BK.

**4. Ndikimi i pritur në punësim dhe çështje gjinore:** Në përgjithësi, masa pritet të ketë ndikim pozitiv në mirëqenien sociale si dhe përmirësimin e performancës së tregut të punës dhe konkurrueshmërisë. Kjo masë kjo do të ndikojë në qasje gjithëpërfshirëse përmes mbulimit të shërbimeve nga lista e shërbimeve të kujdesit shëndetësor për të gjitha kategoritë, sociale dhe gjinore, me një kosto të përballeshme. Po ashtu, ndikon në përmirësimin e shërbimeve sociale posaçërisht për grupet e marginalizuara, si dhe personat me nevoja të veçanta, pakicat si dhe në barazinë gjinore.

**5. Rreziqet potenciale:** Vonesat e mundshme në miratimin e plotësim-ndryshimit të Ligjit për Financat Lokale; vonesat eventuale në plotësim ndryshimin e legjislacionit të nevojshëm, pamundësia në punësimin e stafit në fondin e sigurimeve shëndetësore për shkak të masave kufizuese nga MF në lidhje me punësimet në sektorin publik. Të gjitha këto rreziqe do të mund të ndikonin në shtyrjen e vendimit për mbledhjen e premieeve sipas Ligjit për Sigurimin Shëndetësor, Nr. 04/L-249.